



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:213634

Datë: 26.12.2023

Numri i dokumentit: 05123361

PS.nr.40/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI SPECIAL, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarja Violeta Namani-Hajra –kryetare e trupit gjykues, gjyqtarët Suzana Çerkini dhe Vesel Ismaili si anëtarë të trupit gjykues, me zyrtaren ligjore Ardita Mustafa, në çështjen penale kundër të pandehurve M.M., F.M., G.N., V.H., A.R., O.E., F.B., Rr.B., Q.M., M.K., S.B., A.Q. dhe A.H. për veprën penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par.3 lidhur me par .2 të KPRK-së, lidhur me veprën penale në formë të pjesëmarrjes ose organizimit të grupit kriminal të organizuar nga neni 283 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, PPS.nr.20/17, të datës 23.09.2021, të ri cilësuar me datë 13.10.2023, në fjalën përfundimtare nga Prokurorja e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor në prezencën e palëve në procedurë gjykata me datë 18.10.2023, mori dhe shpalli publikisht dhe përpiloi me datë **16.11.2023** këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të pandehurve:

1. M.M., i biri i S. dhe Q., e gjinisë K., i lindur me datë ..., në P., ku edhe jeton rruga "...", nr. ..., i martuar, baba i pesë fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i papunë, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

2. F. M., i biri i S. dhe Q., e gjinisë K., i lindur me datë ..., në Gj., me vendbanim në P., rruga "...", nr. ..., i pamartuar, ka të kryer shkollën e mesme, i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal ..., Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

3. G.N., i biri i V. dhe F., e gjinisë M., i lindur me datë ..., në P., me vendbanim në rrugën "...", nr. ..., në P., i martuar, baba i dy fëmijëve, ka të kryer fakultetin ekonomik, punon kamerier, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

4. V.H., i biri i S. dhe X., e gjinisë Sh., i lindur me datë ..., në I., me vendbanim në fshatin ..., Komuna e I., i martuar, baba i dy fëmijëve, ka të kryer fakultetin e edukatës fizike, punon si kamerier, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

5. A.R., i biri i H. dhe N., e gjinisë M., i lindur me datë ..., në B., me vendbanim në rrugën "...", nr. ... , në P., i martuar, baba i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

6. F. B., i biri i Sh. dhe N., e gjinisë Z., i lindur me datë ..., në P., ku edhe jeton rruga "...", i martuar, baba i katër fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës.

7. RR.B., i biri i S. dhe nënës F., e gjinisë B., i lindur me datë ..., në V., me vendbanim në rrugën "...", nr. ..., në F.K., i martuar, baba i pesë fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme ekonomike, i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës .

8. Q.M., i biri i N. dhe N., e gjinisë S., i lindur me datë ..., në M., me vendbanim në rrugën "... nr. ...", në P., i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, punon si kamarier, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës .

9. M. K., i biri i A. dhe nënës Z., e gjinisë J., i lindur me datë ... ne P., ku edhe jeton në rrugën "...", P., i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës.

10. S.B., i biri i U. dhe nënës Z., i gjinisë Z., i lindur me datë ..., në fshatin ..., Komuna S., tani me vendbanim në ..., Komuna e D., i martuar, baba i katër fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës.

11. A.Q., i biri i F. dhe S., e gjinisë G., i lindur me datë ..., në P., ku edhe jeton në rrugën "...", nr. ...", i martuar, baba i një fëmije, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës.

12. A. H., i biri i S. dhe F., e gjinisë Sh., i lindur me datë ..., në Gj., ku edhe jeton në rrugën "...", nr. ..., i martuar, baba i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, veteran i luftës së ..., i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës.

13. O.E., i biri i A. dhe nënës Sh., i gjinisë H., i lindur me datë ..., në fshatin ... Komuna e P., ku edhe jeton përkohësisht, ndërsa me vendbanim të përhershëm në SHBA, i martuar, baba i dy

fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme-ndërtimtari, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

I. Të pandehurit M.M. F.M. dhe G.N., në bazë të nenit 364 par 1 të KPP-së,

JANË FAJTORË

I. Sepse deri në muajin tetor të vitit 2016, të pandehurit M.M., F.M. dhe G.N., në bashkëkryerje dhe vazhdimësi me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo të tjerët kanë marrë pjesë në organizimin e lojërave të fatit në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për lojërat e fatit nr.04/L-080, në atë mënyrë që i pandehuri Shp. R. (*është në arrati*), fillimisht kishte siguruar licencë për ushtrimin e kësaj veprimtarie në gjithë Kosovën, nën firmën “...” e pastaj aksionet ia kishte bartur të pandehurit F.M., i cili të njëjtën firmë e kishte regjistruar në ARBK nën firmën “...” dhe “...”, ashtu që të pandehurit F.M., M.M. dhe G.N., në bashkëkryerje dhe vazhdimësi kanë shpërnda aparate në lokacionet e lojërave të fatit që nuk kishin licenca dhe leje për ushtrimin e veprimtarisë të tillë, i kanë furnizuar me aparate me numra serik të falsifikuara të duplikuara dhe treplifikuara, aparate pa numra serik, aparate të ndryshme të lojërave të fatit si: “Kajot”, “Apex”, “Merkur”, si dhe aparate të tjera të “lojërave me qen”, “KENO”, roleta, ndërkaq gjatë kontrollit nga ana e policisë, Doganës dhe ATK-së, këto aparate janë konfiskuar, nga e cila veprimtari kanë përfituar dobi pasurore në mënyrë të kundërligjshme në shumë prej 15 337,63 €,

II. I pandehuri F.M., deri me datën 29.09.2016, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo të tjerët kanë marrë pjesë në organizimin e lojërave të fatit në mënyrë të kundërligjshme, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për lojërat e fatit nr.04/L-080, ashtu që në cilësinë e pronarit të bizneseve “...“ dhe ”...”, në bashkëkryerje dhe vazhdimësi me të pandehurit M.M., G.N. kanë vepruar edhe në lokalin “...”, në rrugën “...”, në P., ku nuk kishte leje pune nga organet kompetente, gjatë kontrollit të këtij lokali nga personat zyrtar janë gjetur dhe konfiskuar tetë (8) aparate të lojërave të fatit të markës Merkur me numra serik 3145400241, 3145400215, 3145400158, 3145400154, 3145400314, 3145400213, 3145400306, 3145400212, katër (4) të markës Kajot me numra serik S.N.103, S.N.545, dy (2) aparate të markës ACT me numra serik 90890210, 90890188, dy aparate APEX me numër 80790141, 80790127, një (1) DVR me numër serik 2F00966PAPL45YT,

III. I pandehuri G.N. deri me datën 29.09.2016, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo të tjerët kanë marrë pjesë në organizimin e lojërave të fatit në mënyrë të kundërligjshme, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për lojërat e fatit nr.04/L-080, ashtu që në cilësinë e menaxherit të bizneseve “...“ dhe ”... 1”, në bashkëkryerje dhe vazhdimësi me të pandehurit e lartcekur ka vepruar në lokalin “...”, në rrugën “...”, pn, në P., nuk kishte leje të punës nga organet kompetente për të ushtruar një veprimtari të tillë, gjatë kontrollit të këtij lokali me datën 21.04.2016, janë gjetur dhe konfiskuar katër (4) aparate të lojërave të fatit si: aparat APEX me nr, serik 8079139, aparat ACT me numër serik 90890216, aparat MERKUR me numër serik 2009401, aparat KAJOT me numër serik 00390103, DVR i kamerave 1GOIE4FPALC05T5, shtëpizë HP (Race) CZC5171CMQ, shtëpizë (Keno) CZC5171DOV,

printer të tiketave Keno-Race B85B19C14116, Kopje Licence nr. 28/2015 dhe Certifikatë e regjistrimit të biznesit me nr. 70591472,

IV. I pandehuri G.N. deri me datën 21.04.2016, në cilësinë e menaxherit me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo të tjerët kanë marrë pjesë në organizimin e lojërave të fatit në mënyrë të kundërligjshme, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për lojërat e fatit nr.04/L-080, ashtu që në lokalin pa mbishkrim në rrugën "...", te ..., në P., nuk kishte leje të punës nga organet kompetente, gjatë kontrollit janë gjetur dhe konfiskuar: katër (4) aparate të lojërave të fatit si: aparat APEX X10 D1 me nr, serik 01907-11759, aparat ACT X10 D2 me numër serik 90890288, aparat MERKUR X10 D3 LfT me numër serik 2009402, aparat APEX X10 D4 me numër serik 11009-14429 DVR i kamerave X10 D5 1GO1E4FPALX36U0, njëmbëdhjetë (11) letra bixhozi dhe gurë për lojëra, kontratë me kompaninë e sigurimeve kobra,

-Me këtë në bashkëkryerje dhe vazhdimësi kanë kryere veprën penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par.2 lidhur me nenin 31 dhe nenin 77 të KPRK-së,

Andaj gjykata me aplikimin e neneve **7,17, 38, 39,40, 42, 69, 70, 300 par.2** lidhur me nenin **31** dhe nenin **77 të KPRK-së**, dhe nenit **364, 449, 450 dhe 452 të KPRK-së**, të pandehurit i :

G J Y K O N

Të pandehurin **M.M.** i shqipton **Dënim me Burgim** në kohëzgjatje prej **3 (tri) vite** burg, i cili dënim nuk do të ekzekutohet deri sa aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Të pandehurin **F.M.** i shqipton, **Dënim me Burgim** në kohëzgjatje prej **3 (tri) vite** burg, i cili dënim nuk do të ekzekutohet deri sa aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Të pandehurin **G.N.** i shqipton, **Dënim me Burgim** në kohëzgjatje prej **1 (një) viti, e 6 (gjashtë) muaj**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet deri sa aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Obligohet të pandehurit e lartcekur se cili veç e veç ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës, në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej njëqind **(100) €**, ndërsa shumën prej njëqind **(100) €**, për Fondin për Kompensimin të Viktimave të Krimit, të gjitha ti paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të pandehurit F.M. ju konfiskohen aparatet e lojërave të fatit si: tetë (8) aparate të lojërave të fatit të markës Merkur me numra serik 3145400241, 3145400215, 3145400158, 3145400154, 3145400314, 3145400213, 3145400306, 3145400212, katër (4) të markës Kajot me numra serik S.N.103, S.N.545, dy (2) aparate të markës ACT me numra serik 90890210, 90890188, dy

aparate APEX me numër 80790141, 80790127, një (1) DVR me numër serik 2F00966PAPL45YT, ndërsa i pandehuri **G.N.** ju konfiskohen katër (4) aparate të lojërave të fatit si: aparat APEX me nr, serik 8079139, aparat ACT me numër serik 90890216, aparat MERKUR me numër serik 2009401, aparat KAJOT me numër serik 00390103, DVR i kamerave 1GOIE4FPALC05T5, shtëpizë HP (Race) CZC5171CMQ, shtëpizë (Keno) CZC5171DOV, printer të tiketave Keno-Race B85B19C14116, si dhe i konfiskohen katër (4) aparate të lojërave të fatit si: aparat APEX X10 D1 me nr, serik 01907-11759, aparat ACT X10 D2 me numër serik 90890288, aparat MERKUR X10 D3 Lft me numër serik 2009402, aparat APEX X10 D4 me numër serik 11009-14429 DVR i kamerave X10 D5 1GOIE4FPALX36U0, njëmbëdhjetë (11) letra bixhozi dhe gurë për lojëra, pasi që me të njëjtat aparate është kryer vepra penale.

Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar është përgjegjëse të bëjë administrimin e pasurisë së specifikuar, në pajtim me Ligjin përkatës për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar.

II. I pandehuri V.H. në bazë të nenit 364 par 1 të KPP-së,

ËSHTË FAJTORË

I. Sepse deri me datë 23.04.2015, në vazhdimësi me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, ka marrë pjesë në organizimin e lojërave të fatit në mënyrë të kundërligjshme, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për lojërat e fatit nr.04/L-080, ashtu që në lokalin në fshatin ..., Komuna e I., nuk ka pasur leje pune nga organet kompetente për të ushtruar një veprimtari të tillë, gjatë kontrollit nga personat zyrtar, me datën 23.04.2015, janë gjetur dhe konfiskuar dy (2) aparate të lojërave të fatit, një (1) i markës KAJOT me numër serik SN00271, dhe një (1) i markës APEX me nr, serik 8790137, dy (2) shtëpiza të kompjuterëve të lojërave të fatit të markës KENO me numër serik CZC91638MN, dhe CZC92628X3,

II. Sepse deri me datë 23.04.2015, në vazhdimësi me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, ka marrë pjesë në organizimin e lojërave të fatit në mënyrë të kundërligjshme, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për lojërat e fatit nr.04/L-080, ashtu që në lokalin në fshatin ..., Komuna e I., nuk kishte leje të punës nga organet kompetente për të ushtruar një veprimtari të tillë, gjatë kontrollit janë gjetur dhe konfiskuar dy (2) aparate të lojërave të fatit të markës APEX me nr, serik AM 122, AM 013, një (1) i markës KAJOT me numër serik SN 00272, dy (2) shtëpiza të kompjuterëve të lojërave të fatit të markës DELL me numër serik X12-51822 (KENO), dhe Fujitsu – Siemens me numër serik YK3J198214 ,

- Me këtë në vazhdimësi ka kryer veprën penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par. 2 lidhur me nenin 77 të KPRK-së,

Andaj gjykata me aplikimin e neneve **7,17, 38, 39,40, 42,44, 69, 70, 300 par.2 lidhur me nenin 77 të KPRK-së,** dhe nenit **364, 449, 450 dhe 452 të KPP-së,** të pandehurin e :

G J Y K O N

Të pandehurit **V.H.** i shqiptohet dënim me burg prej **6 (gjashtë) muaj**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet deri sa aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Në bazë të nenit 44 par.1 të KPRK-së, me pëlqimin e të pandehurit **V.H.** dënimi me burg prej 6 muaj t'i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumë prej **5000 €**, të cilin dënim do ta paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Obligohet i pandehuri i lartcekur që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës, në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej njëqind **(100) €**, ndërsa shumën prej njëqind **(100) €**, për Fondin për Kompensimin të Viktimave të Krimin, të gjitha ti paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të pandehurit **V.H.** i konfiskohen aparatet e lojërave të fatit si: dy (2) aparate të lojërave të fatit, një (1) i markës KAJOT me numër serik SN00271, dhe një (1) i markës APEX me nr, serik 8790137, dy (2) shtëpiza të kompjuterëve të lojërave të fatit të markës KENO me numër serik CZC91638MN, dhe CZC92628X3, si dhe i konfiskohen dy (2) aparate të lojërave të fatit të markës APEX me nr, serik AM 122, AM 013, një (1) i markës KAJOT me numër serik SN 00272, dy (2) shtëpiza të kompjuterëve të lojërave të fatit të markës DELL me numër serik X12-51822 (KENO), dhe Fujitsu – Siemens me numër serik YK3J198214, , pasi që me të njëjtat aparate është kryer vepra penale, pasi që me të njëjtat aparate është kryer vepra penale.

Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar është përgjegjëse të bëjë administrimin e pasurisë së specifikuar, në pajtim me Ligjin përkatës për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar.

III. I pandehuri Rr.B. në bazë të nenit 364 par 1 të KPP-së,

ËSHTË FAJTORË

Sepse deri me datë 27.01.2016, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, ka marrë pjesë në organizimin e lojërave të fatit në mënyrë të kundërligjshme, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për lojërat e fatit nr.04/L-080, ashtu që në lokalit të lojërave të fatit "...", në rrugën "... " E12, nuk kishte leje të punës nga organet kompetente për të ushtruar një veprimtari të tillë, gjatë kontrollit nga ana e personave zyrtar janë gjetur dhe konfiskuar shtatëmbëdhjetë (17) aparate të lojërave të fatit të markave të ndryshme si Merkur me numër serik 2009401, 2200100, 3139300005, 390111, 2317, 100080221, 100080225, 100080212, 100080211, APEX me numër serik 80790129, 80790147, KAJOT me numër serik 11039128, 0101, aparat ACT me numër serik 0173, aparat APEX me numër serik 807901140, aparat Hot – Spot me numër serik 100080227, një shtëpizë kompjuteri HP me numër serik CZC4160MCM,

një DVR H me numër serik 2008922022, pas verifikimit të tyre të njëjtit ishin paraparë që të vepronin në qytete tjera të Kosovës e jo në vendin ku janë gjetur,

- Me këtë ka kryer veprën penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par. 2 të KPRK-së,

Andaj gjykata me aplikimin e neneve **7,17, 38, 39,40, 42,44, 69, 70, 300 par.2 të KPRK-së,** dhe nenit **364, 449, 450 dhe 452 të KPP-së,** të pandehurin e :

G J Y K O N

Të pandehurit **Rr.B.** i shqiptohet dënim me burg prej **6 (gjashtë) muaj,** i cili dënim nuk do të ekzekutohet deri sa aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Në bazë të nenit 44 par.1 të KPRK-së, me pëlqimin e të pandehurit **Rr.B.** dënimi me burg prej 6 muaj t'i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumë prej 5000 €, të cilin dënim do ta paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Obligohet i pandehuri i lartcekur që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës, në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej njëqind **(100) €,** ndërsa shumën prej njëqind **(100) €,** për Fondin për Kompensimin të Viktimave të Krimit, të gjitha ti paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të pandehurit **Rr.B.** i konfiskohen aparatet e lojërave të fatit si: shtatëmbëdhjetë (17) aparate të lojërave të fatit të markave të ndryshme si Merkur me numër serik 2009401, 2200100, 3139300005, 390111, 2317, 100080221, 100080225, 100080212, 100080211, APEX me numër serik 80790129, 80790147, KAJOT me numër serik 11039128, 0101, aparat ACT me numër serik 0173, aparat APEX me numër serik 807901140, aparat Hot – Spot me numër serik 100080227, një shtëpizë kompjuteri HP me numër serik CZC4160MCM, një DVR H me numër serik 2008922022, pasi që me të njëjtat aparate është kryer vepra penale.

Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar është përgjegjëse të bëjë administrimin e pasurisë së specifikuar, në pajtim me Ligjin përkatës për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar.

IV. I pandehuri F.B. në bazë të nenit 364 par 1 të KPP-së,

ËSHTË FAJTORË

Sepse deri me datë 27.01.2016, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, ka marrë pjesë në organizimin e lojërave të fatit në mënyrë të kundërligjshme, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për lojërat e fatit nr.04/L-080, ashtu që në lokalit në rrugën “...” të “...”, në P., nuk kishte leje të punës nga organet kompetente për të ushtruar një veprimtari të tillë, gjatë kontrollit nga ana e personave zyrtar janë gjetur dhe konfiskuar një (1) DVR e tipit multistar me numër serik 120703-9304, dy (2) shtëpiza të kompjuterit HP me numër serik CZC5321S1P, CZ92434GV,

- Me këtë ka kryer veprën penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par. 2 të KPRK-së,

Andaj gjykata me aplikimin e neneve **7,17, 38, 39,40, 42,44, 69, 70, 300 par.2 të KPRK-së,** dhe nenit **364, 449, 450 dhe 452 të KPP-së,** të pandehurin e :

G J Y K O N

Të pandehurit **F.B.** i shqiptohet dënim me burg prej **6 (gjashtë) muaj,** i cili dënim nuk do të ekzekutohet deri sa aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Në bazë të nenit 44 par.1 të KPRK-së, me pëlqimin e të pandehurit **F.B.** dënimi me burg prej 6 muaj t'i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumë prej **5000 €,** të cilin dënim do ta paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Obligohet i pandehuri i lartcekur që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës, në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej njëqind **(100) €,** ndërsa shumën prej njëqind **(100) €,** për Fondin për Kompensimin të Viktimave të Krimit, të gjitha ti paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të pandehurit **F.B.** i konfiskohen: një (1) DVR e tipit multistar me numër serik120703-9304, dy (2) shtëpiza të kompjuterit HP me numër serik CZC5321S1P, CZ92434GV, pasi që me të njëjtat është kryer vepra penale.

Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar është përgjegjëse të bëjë administrimin e pasurisë së specifikuar, në pajtim me Ligjin përkatës për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar.

V. I pandehuri A.R. në bazë të nenit 364 par 1 të KPP-së,

ËSHTË FAJTORË

I. Sepse deri me datë 18.10.2016, në vazhdimësi me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, ka marrë pjesë në organizimin e lojërave të fatit në mënyrë të kundërligjshme, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për lojërat e fatit nr.04/L-080, ashtu që në lokalin "...", në rrugën "...", në R., nuk kishte leje të punës nga organet kompetente për të ushtruar një veprimtari të tillë, gjatë kontrollit nga ana e personave zyrtar janë gjetur dhe konfiskuar gjashtë (6) aparate të lojërave të fatit të markës KAJOT me numra serik 11039111, 11039136, 11039133, 11039129, 110391127 dhe 89714611, dy (2) aparate të lojërave të fatit të markës APEX me numra 80790126 dhe 80790146, një (1) DVR - video rekorder me numër serik 1G020B4PALA7N7F dhe para në vlerë prej 3770 euro,

II. Sepse deri me datë 18.10.2016, në vazhdimësi me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, ka marrë pjesë në organizimin e lojërave të fatit në mënyrë të kundërligjshme, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për lojërat e fatit nr.04/L-080, ashtu që në lokalin “..., ...”, në fshatin ..., Komuna e R., nuk kishte leje të punës nga organet kompetente për të ushtruar një veprimtari të tillë, gjatë kontrollit janë gjetur dhe konfiskuar nëntë (9) aparate të lojërave të fatit me mbishkrimin Hotspot (Admiral) me numër serik 100080138, Hotspot (Admiral) me numër serik 100080202, Apex me numër serik 80790126, 80790146, Kajot me numra serik S.N.89714813, S.N.11039108, S.N.11039110, S.N.11039129, S.N.11039102, dhe para në vlerë prej njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë (167) euro,

- Me këtë në vazhdimësi ka kryer veprën penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par. 2 lidhur me nenin 77 të KPRK-së,

Andaj gjykata me aplikimin e neneve **7,17, 38, 39,40, 42,44, 69, 70, 300 par.2 lidhur me nenin 77 të KPRK-së,** dhe nenit **364, 449, 450 dhe 452 të KPP-së,** të pandehurin e :

G J Y K O N

Të pandehurit **A.R.** i shqiptohet dënim me burg prej **6 (gjashtë) muaj,** i cili dënim nuk do të ekzekutohet deri sa aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Në bazë të nenit 44 par.1 të KPRK-së, me pëlqimin e të pandehurit **A.R.** dënimi me burg prej 6 muaj t'i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumë prej **5000 €,** të cilin dënim do ta paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Obligohet i pandehuri i lartcekur që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës, në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej njëqind **(100) €,** ndërsa shumën prej njëqind **(100) €,** për Fondin për Kompensimin të Viktimave të Krimin, të gjitha ti paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të pandehurit **A.R.,** i konfiskohen aparatet e lojërave të fatit si: gjashtë (6) aparate të lojërave të fatit të markës KAJOT me numra serik 11039111, 11039136, 11039133, 11039129, 110391127 dhe 89714611, dy (2) aparate të lojërave të fatit të markës APEX me numra 80790126 dhe 80790146, një (1) DVR - video rekorder me numër serik 1G020B4PALA7N7F, si dhe para në vlerë prej 3770 euro, si dhe i konfiskohen nëntë (9) aparate të lojërave të fatit me mbishkrimin Hotspot (Admiral) me numër serik 100080138, Hotspot (Admiral) me numër serik 100080202, Apex me numër serik 80790126, 80790146, Kajot me numra serik S.N.89714813, S.N.11039108, S.N.11039110, S.N.11039129, S.N.11039102, dhe para në vlerë prej njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë (167) euro, pasi që me të njëjtat aparate është kryer vepra penale dhe vlera e parave janë përfitim nga kryerja e veprës penale.

Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar është përgjegjëse të bëjë administrimin e pasurisë së specifikuar, në pajtim me Ligjin përkatës për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar.

VI. I pandehuri A.Q. në bazë të nenit 364 par 1 të KPP-së,

ËSHTË FAJTORË

Sepse deri me datë 18.10.2016, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, ka marrë pjesë në organizimin e lojërave të fatit në mënyrë të kundërligjshme, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për lojërat e fatit nr.04/L-080, ashtu që në lokalin "... ..", në rrugën "... " në P., nuk kishte leje të punës nga organet kompetente për të ushtruar një veprimtari të tillë, gjatë kontrollit nga ana e personave zyrtar, janë gjetur dhe konfiskuar dhjetë (10) aparate të lojërave të fatit të markës Merkur me numër serik 3145400417, 3145400342, Apex me numër serik 80790134, 80790135, Kajot me numra serik 390122, 390121, 390120, 11039114, Hotspot (Admiral) me numër serik 1000802216, Hotspot (Admiral) me numër serik 100080219 dhe para në vlerë prej shtatëqind e gjashtëdhjetë e tre euro e pesëdhjetë cent (763.50),

- Me këtë ka kryer veprën penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par. 2 të KPRK-së,

Andaj gjykata me aplikimin e neneve **7,17, 38, 39,40, 42,44, 69, 70, 300 par.2 të KPRK-së,** dhe nenit **364, 449, 450 dhe 452 të KPP-së,** të pandehurin e :

G J Y K O N

Të pandehurit **A.Q.** i shqiptohet dënim me burg prej **6 (gjashtë) muaj,** i cili dënim nuk do të ekzekutohet deri sa aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Në bazë të nenit 44 par.1 të KPRK-së, me pëlqimin e të pandehurit **A.Q.** dënimi me burg prej 6 muaj t'i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumë prej **5000 €,** të cilin dënim do ta paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Obligohet i pandehuri i lartcekur që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës, në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumë prej njëqind **(100) €,** ndërsa shumë prej njëqind **(100) €,** për Fondin për Kompensimin të Viktimave të Krimin, të gjitha ti paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të pandehurit **A.Q.** i konfiskohen aparatet e lojërave të fatit si: dhjetë (10) aparate të lojërave të fatit të markës Merkur me numër serik 3145400417, 3145400342, Apex me numër serik 80790134, 80790135, Kajot me numra serik 390122, 390121, 390120, 11039114, Hotspot (Admiral) me numër serik 1000802216, Hotspot (Admiral) me numër serik 100080219 dhe para në vlerë prej shtatëqind e gjashtëdhjetë e tre euro e pesëdhjetë cent (763.50), pasi që me të njëjtat aparate është kryer vepra penale dhe vlera e parave janë përfitim nga kryerja e veprës penale.

Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar është përgjegjëse të bëjë administrimin e pasurisë së specifikuar, në pajtim me Ligjin përkatës për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar.

VII. I pandehuri S.B. në bazë të nenit 364 par 1 të KPP-së,

ËSHTË FAJTORË

Sepse deri me datë 21.04.2016, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, ka marrë pjesë në organizimin e lojërave të fatit në mënyrë të kundërligjshme, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për lojërat e fatit nr.04/L-080, ashtu që në lokalin "...", në fshatin ..., Komuna e D., nuk kishte leje të punës nga organet kompetente për të ushtruar një veprimtari të tillë, gjatë kontrollit nga ana e personave zyrtar janë gjetur dhe konfiskuar shtate (7) aparate të lojërave të fatit, Hot Spot me numër serik 100080215, Merkur me numër serik 01907-08358, Hot Stop me numër serik 10080201, MERKUR me numër serik 2009401, KAJOT me numër serik 89715712, APEX me numër serik 8079039, APEX me numër serik 80790125, DIË AR 20141208020, 517 euro si dhe disa dokumente,

- Me këtë ka kryer veprën penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par. 2 të KPRK-së,

Andaj gjykata me aplikimin e neneve **7,17, 38, 39,40, 42,44, 69, 70, 300 par.2 të KPRK-së,** dhe nenit **364, 449, 450 dhe 452 të KPP-së,** të pandehurin e :

G J Y K O N

Të pandehurit **S.B.** i shqiptohet dënim me burg prej **6 (gjashtë) muaj,** i cili dënim nuk do të ekzekutohet deri sa aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Në bazë të nenit 44 par.1 të KPRK-së, me pëlqimin e të pandehurit **S.B.** dënimi me burg prej 6 muaj t'i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumë prej **5000 €**, të cilin dënim do ta paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Obligohet i pandehuri i lartcekur që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës, në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej njëqind (**100**) €, ndërsa shumën prej njëqind (**100**) €, për Fondin për Kompensimin të Viktimave të Krimit, të gjitha ti paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të pandehurit **S.B.** i konfiskohen aparatet e lojërave të fatit si: shtate (7) aparate të lojërave të fatit, Hot Spot me numër serik 100080215, Merkur me numër serik 01907-08358, Hot Stop me numër serik 10080201, MERKUR me numër serik 2009401, KAJOT me numër serik 89715712, APEX me numër serik 8079039, APEX me numër serik 80790125, DIË AR 20141208020, 517 euro, pasi që me të njëjtat aparate është kryer vepra penale dhe vlera e parave janë përfitim nga kryerja e veprës penale.

Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar është përgjegjëse të bëjë administrimin e pasurisë së specifikuar, në pajtim me Ligjin përkatës për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar.

VIII. I pandehuri A.H. në bazë të nenit 364 par 1 të KPP-së,

ËSHTË FAJTORË

Sepse deri me datë 21.04.2016, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, ka marrë pjesë në organizimin e lojërave të fatit në mënyrë të kundërligjshme, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për lojërat e fatit nr.04/L-080, ashtu që në lokalin "...", në rrugën "..." në Gj., nuk kishte leje të punës nga organet kompetente për të ushtruar një veprimtari të tillë, gjatë kontrollimit nga ana e personave zyrtar janë gjetur dhe konfiskuar dhjetë (10) aparate të lojërave të fatit, si: MERKUR me numër serik 2009402, 08500-02817, 2009408, 2009409, KAJOT me numër serik 01907-10408, EGT me numër serik 01907-08131, 01907-08308, 11009-13140, 11009-13008 dhe 11009-13662, dokumentacion mbi barazimin, si: 15.29 copë kartëmonedha nga 20 euro, 14.30 copë kartëmonedha nga 50 euro, 16.55 copë kartëmonedha nga 10 euro, 17.22 copë kartëmonedha nga 5 euro, 18.30 çelësa të aparateve, 19.01 kopje e njoftimit të ATK-së, me numër serik 13/06/39962 dhe 20.01 Shtëpizë kompjuteri DELL me numër serik BMG3K4J,

- Me këtë ka kryer veprën penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par. 2 të KPRK-së,

Andaj gjykata me aplikimin e neneve **7,17, 38, 39,40, 42,44, 69, 70, 300 par.2 të KPRK-së,** dhe nenit **364, 449, 450 dhe 452 të KPP-së,** të pandehurin e :

G J Y K O N

Të pandehurit **A.H.** i shqiptohet dënim me burg prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet deri sa aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Në bazë të nenit 44 par.1 të KPRK-së, me pëlqimin e të pandehurit **A.H.** dënimi me burg prej 6 muaj t'i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumë prej **5000 €**, të cilin dënim do ta paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Obligohet i pandehuri i lartcekur që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës, në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej njëqind **(100) €**, ndërsa shumën prej njëqind **(100) €**, për Fondin për Kompensimin të Viktimave të Krimit, të gjitha ti paguaj në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të pandehurit **A.H.** i konfiskohen aparatet e lojërave të fatit si: dhjetë (10) aparate të lojërave të fatit, si: MERKUR me numër serik 2009402, 08500-02817, 2009408, 2009409, KAJOT me

numër serik 01907-10408, EGT me numër serik 01907-08131, 01907-08308, 11009-13140, 11009-13008 dhe 11009-13662, dokumentacion mbi barazimin, si: 15.29 copë kartëmonedha nga 20 euro, 14.30 copë kartëmonedha nga 50 euro, 16.55 copë kartëmonedha nga 10 euro, 17.22 copë kartëmonedha nga 5 euro, 18.30 çelësa të aparateve, 19.01 kopje e njoftimit të ATK-së, me numër serik 13/06/39962 dhe 20.01 Shtëpizë kompjuteri DELL me numër serik BMG3K4J, pasi që me të njëjtat aparate është kryer vepra penale dhe vlera e parave janë përfitim nga kryerja e veprës penale.

Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar është përgjegjëse të bëjë administrimin e pasurisë së specifikuar, në pajtim me Ligjin përkatës për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar.

IX. I pandehuri Q.M., në bazë të nenit 363 par.1 nen par. 1.3 të KPP-së,

LIROHET NGA AKUZA

I pandehuri G.N. nga koha e pa caktuar deri me datën 29.09.2016, në cilësinë e pronarit të bizneseve "... dhe "... 1", në bashkëpunim me të pandehurit Sh. R., M.M. dhe të pandehurve tjerë ka shpërnda aparate të pa licencuara, aparate të falsifikuara nëpër pika të ndryshme në Kosovë ku kanë vepruar të pandehurit tjerë e gjithashtu i njëjti ka vepruar edhe në lokalin "...", në rrugën "...", pn, në P. bashkë me të pandehurin **Q.M.**, e i cili lokal nuk kishte leje të punës nga organet kompetente për të ushtruar një veprimtari të tillë ashtu që gjatë kontrollit të këtij lokali me datën 21.04.2016, janë gjetur dhe konfiskuar katër (4) aparate të lojërave të fatit si: **aparat APEX me nr, serik 8079139, aparat ACT me numër serik 90890216, aparat MERKUR me numër serik 2009401, aparat KAJOT me numër serik 00390103, DVR i kamerave 1GOIE4FPALC05T5, shtëpizë HP (Race) CZC5171CMQ, shtëpizë (Keno) CZC5171DOV, printer të tiktave Keno-Race B85B19C14116, Kopje Licence nr. 28/2015 dhe Certifikatë e regjistrimit të biznesit me nr. 70591472,**

-Me këtë në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi kishte për të kryer veprën penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par.2 dhe par.1 lidhur me nenin 31, nenin 33 dhe nenin 77 të KPRK-së.

-Pasi që nuk është provuar se në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi ka kryer veprën penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par.2 dhe par.1 lidhur me nenin 31, nenin 33 dhe nenin 77 të KPRK-së.

-Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

X. I pandehuri M.K. në bazë nenit 363 par.1 nen par. 1.3 të KPP-së,

LIROHET NGA AKUZA

Të pandehurit G.N. dhe M.K. nga koha e pa caktuar e deri me datën 21.04.2016, në cilësinë e menaxherëve në një lokal të lojërave të fatit pa mbishkrim në rrugën "...", te ..., në P., i cili nuk kishte leje të punës nga organet kompetente kanë marrë pjesë në organizimin e lojërave të fatit

në mënyrë të kundërligjshme, ashtu që gjatë kontrollit janë gjetur dhe konfiskuar : katër (4) aparate të lojërave të fatit si: aparat APEX X10 D1 me nr, serik 01907-11759, aparat ACT X10 D2 me numër serik 90890288, aparat MERKUR X10 D3 LFt me numër serik 2009402, aparat APEX X10 D4 me numër serik 11009-14429 DVR i kamerave X10 D5 1GO1E4FPALX36U0, njëmbëdhjetë (11) letra bixhozi dhe gurë për lojëra, kontratë me kompaninë e sigurimeve kobra,

-Me këtë në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi kishte për të kryer veprën penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par.2 dhe par.1 lidhur me nenin 31, nenin 33 dhe nenin 77 të KPRK-së.

-Pasi që nuk është provuar se në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi ka kryer veprën penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par.2 dhe par.1 lidhur me nenin 31, nenin 33 dhe nenin 77 të KPRK-së.

-Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

XI. Për të pandehurin O.E. në bazë të nenit 362 par 1 nën par 1.1 të KPP-së,

REFUZOHET AKUZA

Sepse nga koha e pa caktuar e deri me datën 23.04.2015, në cilësinë e menaxherit në një lokal të lojërave të fatit, në fshatin ..., Komuna e P., ka marrë pjesë në organizimin e lojërave të fatit në mënyrë të kundërligjshme, e i cili lokal nuk kishte leje të punës nga organet kompetente për të ushtruar një veprimtari të tillë, ashtu që gjatë kontrollimit të këtij lokali nga personat zyrtar janë gjetur dhe konfiskuar dy (2) aparate të lojërave të fatit, një (1) i markës KAJOT me numër serik S.N 00270, dhe një (1) i markës APEX pa numër serik,

-me këtë kishte me kryer veprën penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par.3 lidhur me par .2 të KPRK-së, lidhur me veprën penale në formë të pjesëmarrjes ose organizimit të grupit kriminal të organizuar nga neni 283 të KPRK-së.

-për shkak se prokurorja e prokurorisë speciale në fjalën përfundimtare ka heq dorë nga aktakuza dhe ndjekja penale për të pandehurin O.E.

-Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

ARSYETIMI

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, ka ngritur aktakuzën PPS.nr.20/17, të datës 23.09.2021, kundër të pandehurve Sh. R., M.M., F.M., G.N., V.H., A.R., O.E., F.B., Rr.B., Q.M., Sh. B., M.K., S.B., F. Sh., A.Q., dhe A.H. për veprën penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par.3 lidhur me par 2 të KPRK-së, lidhur me veprën penale në formë të pjesëmarrjes ose organizimit të grupit kriminal të organizuar nga neni 283 të KPRK-së.

Sipas aktvendimit të Gjykatës Themelore Prishtinë-Departamenti Special, PS.nr.40/21, të datës 14.02.2022, për të pandehurit Sh. R., Sh.B. dhe F. Sh. në bazë të nenit 36 par.1 të KPPRK-së, me pajtimin e palëve në procedurë veçohet procedura, me qëllim të efikasitetit të procedurës në këtë çështje penale.

Gjykata, në kuptim të nenit 246 par.1 të KPPK-së, në seancën e shqyrtimit fillestar i mbajtur me datë 14.02.2022, i ka udhëzuar të akuzuarit për të drejtat e tyre ligjore dhe pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit Special, i ka udhëzuar të njëjtit në vështrimin të nenit 248, mbi të drejtën e deklarimit ose jo të pranimit të fajësisë. Të pandehurit M.M., F.M., G.N., V.H., A.R., O.E., F.B., Rr.B., Q.M., M.K., S.B., A.Q., dhe A.H. nuk e pranuan fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohen, ashtu që të pandehurit dhe mbrojtësi e tyre janë udhëzuar se kanë të drejtë në afat prej 30 ditëve nga dita e shqyrtimit fillestar të paraqesin kërkesën për hedhje të aktakuzës dhe kundërshtimin e provave, ndërsa me pajtimin e palëve në procedurë seancën e shqyrtimit të dytë nuk është mbajtur.

Më datë 20.04.2022, Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, mori Aktvendimin PS.nr.40/2021, me të cilin refuzoi si të pabazuar Kërkesat për hedhje të Aktakuzës dhe Kundërshtimin ndaj Provave, të parashtruar nga Mbrojtësit e të pandehurve M.M., F.M., G.N., A.R., O.E., F.B., Rr.B., Q.M., M.K., S.B., A.Q., dhe A.H..

Me datë 27.06.2022, Gjykata e Apelit e Kosovës-Departamenti Special mori Aktvendim PN.S.nr.26/22, ku ka refuzuar si të pabazuar Ankesën e mbrojtëseve të pandehurve M.M., F.M., G.N., A.R., O.E., F.B., Rr.B., Q.M., M.K., S.B., A.Q., dhe A.H., të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në P. - Departamenti Special, PS.nr.40/2021, të datës 20.04.2022, i njëjti vendim vërtetohet.

Gjykata, ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 17.05.2023, i ka udhëzuar të pandehurit për të drejtat e tyre ligjore, ku palët heqin dorë për leximin e aktakuzës nga prokurori i Prokurorisë Speciale, të pandehurit M.M., F.M., G.N., V.H., A.R., O.E., F.B., Rr.B., Q.M., M.K., S.B., A.Q., dhe A.H., nuk e kanë pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohen, dhe meqenëse të pandehurit e lartcekur nuk e kanë pranuar fajësinë për këto vepra penale, Gjykata duke u bazuar në nenin 327 të KPPRK-së, ka vendosur që seanca e shqyrtimit gjyqësor të vazhdojë me fjalën hyrëse dhe prezantimin e provave.

Gjykata ka vazhduar me mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor me datë 02.03.2023, ku ka qenë prezent i pandehuri O.E., dhe mbrojtësi i tij av.B. B., të njëjtit kanë kërkuar nga gjykata se ndaj të pandehuri O.E., të vazhdoj gjykimi në mungesë në bazë të nenit 303 të KPP-së, pasi që i njëjti jeton dhe vepron në SHBA, andaj pas vlerësimit të propozimit të lartcekur dhe pas marrjes së mendimit të palëve në procedurë, Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, mori Aktvendimin PS.nr. 40/21, të datës 02.03.2023, ku ka aprovuar kërkesën e të pandehurit O.E. për gjykim në mungesë, pasi që janë plotësuar kushtet ligjore të parapara në nenin 303 të KPP-

së, seancat e shqyrtimit gjyqësor në vazhdim në këtë çështjen penale do të mbahen pa praninë të pandehurit O.E. e tij, prezent gjatë gjithë kësaj procedure penale do të jetë av. Bujar Bërdynaj.

Prokurorja e Prokurorisë Speciale në fjalën përfundimtare ka bërë precizimin dhe ndryshimin e aktakuzës ashtu që nga dispozitivi i aktakuzës pas fjalës "*tetor të vitit 2016*" ka hequr fjalinë" duke vepruar si grup i organizuar kriminal e me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo të tjerët kane organizuar dhe kane marre pjese në organizimin e lojërave të fatit të përcaktuara me ligj "dhe ne vend të kësaj fjalie ka shtuar "*në bashkëkryerje kane vepruar*", ndërsa pjesa tjetër e aktakuzës ka mbetur e njëjte. Po ashtu, nga kualifikimi juridik i veprës penale hiqet fjalia nga fjala përfundimtare e shkruar si neni i kodit të ri ku është konstatuar neni 294 par.1 dhe .2 i KPP, vendoset neni i vjetre, i ri cilësuar neni 300 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 31 dhe nenin 77 të KPRK-së ndërsa hiqet par .3 i këtij neni. Ky kualifikim juridik dhe ky përshkrim i veprimeve sipas aktakuzës me ndryshimet e bëra në fjalë përfundimtare u përket të akuzuarve si në vijim: M.M., F.M., G.N., V.H., A.R., F.B., A.H., dhe S.B.. Ndërsa për të akuzuarit Rr.B., Q. M., M.K. dhe A.Q., prokurori bën kualifikimin juridik së veprës së njëjtë të kryer në formë të *ndihmës* që do të thotë se të njëjtit kanë kryer veprën penale: '*Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm*' nga neni 300 nga paragrafi .2 dhe .1 lidhur me nenin 31, nenin 33 dhe nenin 77 të KPRK-së. Ndërsa sa i përket të akuzuarit O.E. prokuroria ka heq dorë nga aktakuza dhe ndjekja penale në kuptim të nenit 52 të KPRK-së. Andaj, nga administrimi i provave gjatë shqyrtimit gjyqësor, prokuroria ka vlerësuar se rezulton qartë se të akuzuarit M.M., F.M. dhe G.N. me dashje dhe paramendim kanë zhvilluar aktivitetin e lojërave të fatit dhe bixhozit të paligjshëm duke u pajisur fillimisht me licenca për aparatet e lojërave të fatit dhe pastaj duke bashkëvepruar me të akuzuarit tjerë kanë hapur pika të tjera në shumë vende të Kosovës në të cilat kanë punuar vetë apo kanë punësuar punëtorë të tjerë. Në të vërtetë, të akuzuarit aparatet e licencuara nga ATK-ja, i kanë zhvendosur në pika tjera për të cilat nuk e kanë njoftuar ATK-në, ndërsa tetëmbëdhjete prej tyre i kanë dyfishuar dhe trefishuar i cili fakt vërtetohet nga raporti i Departamentit Special Anti-korrupsion (DSAK) me nr. të referencës 06/3-145/17 i datës 21.04.2017. Nga ky raport qartë rezulton se pas kontrollit dhe sekuestrimit të aparateve të përshkruara në aktakuzë janë vlerësuar të gjitha këto aparate dhe ka rezultuar gjendja faktike e përshkruar në aktakuzë. Ky fakt pjesërisht është vërtetuar edhe nga mbrojtja e disa të pandehurve si: F.M., A.H. etj., ne njërën anë, e në anën tjetër edhe nga dëshmitë e dëshmitareve të dhëna në Gjykatë dhe Prokurori. Dëshmitari Xh. M. ka dëshmuar se në pikën "... " ne R. e ka punësuar A.R. dhe se ka qenë në dijeni se pronar i kësaj firme është personi me emrin M. Se bëhet fjalë për të akuzuarin M.M. nuk është fare kontestuese sepse shumica e dëshmitareve kanë dëshmuar se aparatet e lojërave kanë qenë të tij në njërën anë, e në anën tjetër edhe vetë të akuzuarit kanë sqaruar se këto aparate kanë qenë nën menaxhimin e tij dhe të akuzuarve F.M. dhe G.N.. Po ashtu, nuk ishte kontestues fakti që nga 83 aparate të sekuestruara, 18 prej tyre siç janë precizuar kanë qenë të dyfishuar dhe trefishuar, ndërsa për pjesën tjetër të tyre ka pasur licence nga ATK-ja, mirëpo, të gjitha këto aparate kanë funksionuar në kundërshtim me Ligjin nr. 04/L-80 për lojërat e fatit i shpallur ne gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës me 9 maj 2012. Bazuar në dispozitat e këtij ligji rezulton që të akuzuarit kanë vepruar ne kundërshtim me të dhe në këtë mënyrë kanë përfituar dobi pasurore të kundërligjshme, nisur nga fakti i vërtetuar se kjo veprimtari është zhvilluar në shumë lokale të pa pajisura me leje pune në

pika përkatëse, pa lidhur kontrata pune me punëtorë dhe pa deklaram për ndryshimin e vendeve të aparateve të obliguar sipas nenit 30 pika 1.2 nenit 44 par. 1, 2 dhe 3 të këtij ligji. Nga lidhshmëria logjike e të gjitha provave, prokuroria konsideron se gjate shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar përtej çdo dyshimi të bazuar se veprimet e të pandehurve i kanë përmbushur të gjitha elementet e veprës penale sipas aktakuzës se precizuar në këtë faze të procedurës për çka gjykatës i ka propozuar që të njëjtit t'i shpallë fajtorë dhe t'i dënojë sipas ligjit.

Mbrojtësi i të pandehurit M.M. av.F. L. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e gjatë shqyrtimit gjyqësorë nuk është vërtetuar me asnjë edhe provë të vetme, fajësia e të mbrojturit tim M.M. për shumë arsyeje, 1. Mungon në aktakuzë individualizimi i çfarëdo veprim të M. në lidhje me aparatet për të cilat behet fjalë, i njëjti akuzohet se ka shpërndarë aparate përderisa nuk precizohet vendi, koha dhe mënyra e shpërndarje së këtyre aparateve, për më tepër kur flasim për aparate ju bej me dije se prokuroria pretendon se këto aparate janë konfiskuar sipas një urdhëresë të përgjimeve të lëshuar nga gjykata dhe urdhëresat për sekuestrim me nr 131 e duhet të jete 121 e vitit 2015 dhe 194 e vitit 2015. Nëse shikohen me kujdes këto urdhëresa nuk kanë të bëjnë me çështjen, të lëshuar për diçka tjetër dhe vetëm kundër një personi, urdhëresa 121/2015 ka të bëjë me përgjimin ligjor ne afat prej 60 ditësh në kompaninë Vala, kundër personit me emrin G., me nr tel 045 321 123 dhe nuk ka fare të bëjë asgjë me konfiskim dhe regjistrim të aparateve, urdhëresa me nr 194/2015 është për të njëjtin person për të njëjtën periudhe për 60 dite, përgjimi i telekomunikimeve, dhe duke ju referuar këtyre urdhëresave, për ta thelluar edhe më shumë kundërligjshmërinë e tyre me të njëjtin nr lëshohet një urdhëresë nga GJPP dhe urdhërohet vetëm kontrollimi i një lokali ne pikën 21 ... Gj., dhe nuk ka urdhëresa të tjera në shkresat e lëndës për kontrolle konfiskimi apo kontrolle të tjera. Urdhëresat e lartpërmendura nga shkresat e lendes nga raportet policor dhe transkriptet e përgjimeve nuk kane të bëjnë me personin për të cilën janë lëshuar G. NN por janë të lëshuara kundër personit M.M. që të dyja, janë lëshuar për G. ndërsa është përgjuar M. Në të dy këto raporte policore mund ta vërtetoni këtë çështje, pra të gjitha aparatet që janë konfiskuar në këtë çështje penale janë të kundërligjshëm sepse nuk ka as urdhëresë për konfiskimin e tyre, dhe tani që po flasim në fjalën përfundimtare të prokurores mungon individualizimi i veprimeve për M.M., cilat aparate kane qenë të tij, cilat pika janë të tij. Sa i përket kontributeve komunale lidhur me aparatet nuk paguajnë kurrfarë tatimi sepse paguhet akcizë për secilin aparat dhe nuk e kanë dëmtuar komunën, sepse i paguhet Doganës. Lëvizja e një aparatati prej një vendi në një vend tjetër nuk përbën vepër penale sepse ai aparat ka hyrë në mënyrë ligjore, është regjistruar në ATK dhe ti mbaje ku të duash, për të njëjtin aparat paguhet akcizë 700 euro në muaj si punoi si jo, nëse në një pikë nuk ka pas punë dhe lëvizja e atij aparati duhet me iu dhënë leja me lëvizë me muaj të tërë, të njëjtit i kanë plotësuar kërkesat dhe nëse i kanë lëvizë vet aparatet duhet ti shqiptohet gjobë administrative dhe jo të akuzohet vepër penale. Në mungese të arsyetimit të aktakuzës për veprimet e M.M.t ju propozoj që të njëjtin ta shpallni të pafajshëm dhe ta lironi nga akuza.

I pandehuri M.M., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështes deklaratën e mbrojtësit tim nuk kam asgjë për të shtuar.

Mbrojtësi i të pandehurit F.M. av.N.R. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se ne do të komentojmë shkurtimit fjalën përfundimtare të PRSK. PRSK në fund të një procesi të stërzgatur

në këtë çështje penale ka bërë një reflektim e që për prokurorinë është jashtëzakonisht i madh por ne e vlerësojmë jo reflektim të duhur sepse në bazë të shkresave që prokuroria ka ofruar në këtë çështje penale do të duhej që tërësisht të tërhiqej nga kjo aktakuzë. Para së gjithash PSRK pretendon se F.M. ka kryer veprën penale nga koha e pacaktuar e deri me datë 29.09.2016. Edhe ose është element bazë që të dihet koha e kryerjes së veprës penale, prokuroria i është referuar një datë përfundimtare e që çuditërisht F. është pronar i biznesit "...", kurse për të njëjtin F.M. ka qenë pronar vetëm nga viti 2016 e tutje. Si do që të jete vlerësojmë se në këtë çështje penale PRSK ka pasur vet mëdyshje që nga fillimi sepse ka përshkruar se deri me datë 29.09.2016 është kryer vepër penale, ka nxjerrë aktvendim për fillimin e hetimeve me datë 25.03.2019, e që ky aktvendim për fillim të hetimeve bie ndesh me një mendim të Gjykatës Supreme që specifikon se prokuroria duhet të filloj dhe përfundoj hetimin brenda dy viteve dhe se prokuroria po ashtu nga aktvendimi për fillimin e hetimeve ka kërkuar afat shtesë për të ngritur aktin akuzues, e që kjo është bërë në mungesë të provave për të përmbledhë një aktakuzë dhe për t'ia servuar gjykatës. Pra tani u deshtë për shumë e shumë vite me radhë që PRSK u desh që ta dinte se nuk kemi të bëjmë me krim të organizuar dhe duke u përqendruar në veprën penale nga neni 300 të KPRK, e para së gjithash kjo vepër penale do të binte në kompetencë të Departament të përgjithshëm. Në këtë çështje penale prokurori ka propozuar që të dëgjohen dëshmitar, e që asnjëri nga ata dëshmitarë nuk ka dëshmuar lidhur me tezën e aktakuzës, asnjëri ska mundur të deklarojë siç pretendon prokuroria se F.M. ka shpërndarë aparate të pa licencuar dhe të falsifikuara, dhe se tani nuk e kemi të njohur faktin se ku e mbështet PRSK aktin akuzues meqenëse nuk e ka asnjë provë të vetme që eventualisht që ti dëshmojë gjykatës përtej dyshimit të bazuar mire dhe pastaj të kërkojë shpallej fajtores të të akuzuarit. Në aktakuzën e cila ishte objekt shqyrtimi, tek barra ngarkuese për F.M., PRSK ka përshkruar disa aparate, që janë gjetur në rrugën "... " në P., por nga shkresat që vete prokuroria na i ka dorëzuar me aktakuzë që të gjitha këto aparate janë të licencuar, siç edhe vete e pohoi PRSK se F.M. është pajisë me licence dhe ka punuar deri ditën kur lojërat e fatit janë ndaluar me ligj. Në seancën e parafundit ne kemi kërkuar nga prokuroria që të specifikojë se cilat aparate janë të falsifikuar apo të dubrifikuara dhe të pa licencuara, ku janë gjetur ato dhe ku është gjetur aparati origjinal dhe ku i dublifikuar. Para kësaj seance ne kemi pranuar një parashtrere nga PRSK, në të cilën janë të evidentuar 84 aparate të ndryshme, në këto 84 aparate të ndryshme 3 nga to janë përmendur ne dispozitivin që e ngarkon M.M., një në fq 7 të kësaj parashtrere aparati i 1 në këtë fq, 2 në fq 9, e që për këto aparate prokuroria përshkruan : “ është i licencuar për ushtrimin e lojërave të fatit në një adresë të caktuar por aparati me nr e njëjtë është gjetë dikund tjetër. Pra i gjithë dyshimi i prokurorisë se kane qene të palicencuar apo të dublifikuar bie ne atë se nuk është gjetë në vendin ku është licencuar ai aparat edhe pse sot prokurori përmendi se nga 84 aparate , vetëm 18 prej tyre janë dyfishuar apo falsifikuar e në fakt prokuroria nuk na ka njoftuar se janë gjetë aparate me të njëjtin numër. Siç e përmendi edhe kolegu L. aparatet kane qene të licencuar dhe pronarit i kushton 700 euro në muaj akcizë për atë aparat dhe ato aparate janë licencuar për një vend të caktuar dhe aty ku nuk ka pas pune janë ndërruar në vendin tjetër. Andaj meqenëse polici, prokuroria, gjykata kanë për obligim që çështjen ta vërtetojnë me saktësi dhe po ashtu gjykata detyrohet që aktgjykimin e saj ta mbështes në nenin 360 të KPP-së, në provat e administruara në këtë shqyrtim gjyqësorë nuk arritëm të vërejmë asnjë provë të vetme që prokuroria shpalosi e që argumenton këtë aktakuzë si të tillë, nëse ka pasur mëdyshje PRSK , neni 3 par 2 i KPRK-së, ato mëdyshje janë specifikuar se duhet të interpretohen në favor të të pandehurit. Meqenëse në përfundim të këtij

procesi gjyqësor nuk është vërtetuar në asnjë formë se F. M. ka kryer veprën penale e cila i vihet në barë nga neni 300 par 2 dhe 1 të KPRK-së, në presim nga gjykata që në këtë rast në mbështetje të nenit 363 par 1 dhe 1.3 të KPRK ndaj F.M. të nxjerrë aktgjykim lirues pasi që nuk është provuar që ka kryer veprën penale që i vihen në barrë dhe ndaj bindjen se Aktgjykimi Lirues është aktgjykimi i vetëm dhe i drejtë në këtë rast.

I pandehuri F.M., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështes deklaratën e mbrojtësit tim nuk kam asgjë për të shtuar.

Mbrojtësi i të pandehurit G.N. av.A. K. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në këtë rast penal PRSK nuk ka arritë të sjellë asnjë provë të vetme e cila do ta inkrimojë të mbrojturin tim për veprën penale sipas aktakuzës. I mbrojturi im është fakt se ka punuar në ... deri në fillim të vitit 2016, dhe kjo dëshkohet edhe në raportin përmbledhës ..., të datës 27.03.2017, në fq 35 të këtij raporti dëshkohet se pagën të cilën e ka pranuar nga “...” me pronar Sh. R. ka qene në mars 2016. Kurse të gjitha sekuestrimet e prokurorisë kanë ndodhë pas kësaj date, i mbrojturi im e ka pranuar se ka pasur një lokal të lojërave të fatit i cili ka qenë personalisht i tij dhe të cilin e ka hapë pikërisht pasi që i është ndërprerë marrëdhënia e punës, pra të gjithë ato aparat kanë qenë personalisht të tij dhe ka funksionuar rreth një jave në lokacionin tek ... në P.. Me asnjë prove nuk dëshkohet se i mbrojturi im të këtë bashkëpunuar apo të këtë shpërndarë aparatet të lojërave të fatit me asnjë prej të akuzuarve tjerë, gjate periudhës që ka punuar deri në fillim të 2016 ka pas kontrate të punës, dhe pagën e ka pranuar përmes bankës, nëse i mbrojturi im e ka pasur një pikë apo një lokal të lojërave të fatit personalisht të tij nuk do të thotë dhe nuk vërtetohet se ka bashkëpunuar apo shpërndarë me asnjë prej të akuzuarve dhe kjo nuk është vërtetuar me asnjë provë të vetëm nga ana e PRSK .Po ashtu i mbrojturi im nuk ka qene përgjegjës për licencimin e asnjë pajisje të lojërave të fatit në “...”, për periudhën ku ka punuar, dhe kërkon nga gjykata që pasi të analizohen të gjitha provat në këtë rast ndaj të mbrojturit tim të shpallë Aktgjykim lirues për veprën penale për të cilën akuzohet ngase me asnjë provë termi bashkëkryerje në mes të mbrojturit tim dhe të bashkëakuzuarve nuk është vërtetuar me asnjë prove të vetme.

I pandehuri G.N., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështes deklaratën e mbrojtësit tim nuk kam asgjë për të shtuar.

Mbrojtësja e të pandehurit V.H., av.L. B. Y., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se aktakuza e prokurorisë është e mangët dhe e paqartë, pasi që nuk janë konkretizuar veprimet inkriminuese të akuzuarave në dispozitiv. Lidhur me akuzën për veprën penale Organizimi i Skemave Piramidale dhe bixhozit të paligjshëm, prokuroria nuk ka arritur të argumentojë se i mbrojturi i saj të këtë vepruar në organizimin e bixhozit, lojërave të llojit të kazinove apo lojërave të fatit, siç përcaktohet me ligj për të cilat nuk është dhënë licenca, leja apo koncesioni i organit kompetent. Tutje, ka shtuar se nga dëgjimi i dëshmitarëve, të dëmtuarve por edhe të akuzuarve, asnjëri nga ta as që e ka përmendur të mbrojturin e tij, me përjashtim të dëshmitarit A. O. i cili ka deklaruar se e ka njohur dhe ka punuar me të mbrojturin e saj, dhe i njëjti ka deklaruar se i mbrojturi i saj është marrë vetëm me shitjen e pijeve dhe se aparatet e gjetur në lokal nuk kanë qenë në funksion, andaj mbrojtja konsideron se deklaratat e konsideruara si të lexuara janë marrë në kundërshtim me dispozitat e

KPP-së pasi që iu është mohuar e drejta e marrjes në pyetje të palëve në procedurë, andaj të njëjtat deklarata nuk mund të administrohen si prove, po ashtu, prova të papranueshme janë edhe deklaratat e të mbrojturit të tij në fazën hetimore pasi që të njëjtat janë marrë pa prezencën e avokatit edhe pse mbrojtja ka qenë e detyrueshme në këtë rast. Mbrojtja ka deklaruar se në këtë rast mungon lidhja shkakësore/kauzale dhe mungesa e këtij elementi i anës objektive sjelle edhe mungesën e përgjegjësisë penale subjektive. Shtoj sa i përket të mbrojturit tim në listën e datës 09.10.2023, të PSRK, nga vet prokuroja e çështje në fq e parë rreshti i dyte prej fundit ashtu siç e kemi thënë në seancën e kaluar e ka përcaktuar edhe në fq.10 të aktakuzës pika 7, ku vërtetohet raporti i kontrollit X7, prandaj besoj se kjo listë e dorëzuar nuk përputhet me listën e provave të listuar në aktakuzë, me theks të veçantë se tani në këtë listë aparate e koduar me X11 nuk janë paraqitë fare, po ashtu PRSK nuk pati konsiderate se akciza është paguar nga pronaret e firmave, dhe i mbrojturi i saj nuk ka qene në dijeni për bartjen e aparateve, lidhur e këtë prokurorja nuk mund ti kërkojë gjykatës duke u mbështetur në një prove të vetme dhe të mbështesë një aktgjykim mbi baze të provave të marra në mënyrë të kundërligjshme, andaj mbi bazën e të lartcekurave, ka kërkuar nga gjykata që ndaj të mbrojturit të saj të nxjerrët aktgjykim lirues pasi që nuk ka prova që vërtetojnë se i njëjti ka kryer veprën penale që i ngarkohet.

I pandehuri V.H., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështes deklaratë mbrojtëses tim nuk kam asgjë për të shtuar.

Mbrojtësja e të pandehurit A.R., av.M. Q., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se me asnjë provë të administruar gjatë shqyrtimit gjyqësore nuk është vërtetuar se i mbrojturi i saj ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, tutje, ka shtuar se i mbrojturi i tij ka punuar në lokalin "...", në ... vetëm si punëtor, kontratë pune nuk ka pasur dhe paga e tij ka qenë 400 Euro, ku detyrat e tij të punës kanë qenë t'i shërbej klientët me pije, dhe në përgjegjësinë e tij nuk ka qenë sigurimi i licencës për lokalin, po ashtu, asnjë nga dëshmitaret e dëgjuar nuk ka dëshmuar me asnjë fakt se i mbrojturi i tij ka kryer veprën penale që i vihet në barrë, pasi që PSRK pretendon se dëshmitari Xh. M. ka deklaruar se ka punësuar A.R. kjo nuk qëndron, sepse i njëjti gjatë dëshmisë së tij dhëne në kete gjykatë me datë 26.05.2023 ka deklaruar se nuk ka qenë fare i punësuar në lokalin "...", por vetëm ka qene lojtare i rregullt aty, sepse ai në atë kohë ka qene i punësuar në ndërmarrjen eko regjion si roje natë, andaj mbi bazën e të lartcekurave, mbrojtja konsideron se ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë penale për të mbrojturin e saj, për faktin se i njëjti ka qenë vetëm punëtor i thjeshtë dhe me asnjë provë nuk është vërtetuar se i njëjti ka qenë menaxher apo ka organizuar lojërat e fatit në mënyrë të kundërligjshme, andaj edhe i ka propozuar gjykatës që ndaj të njëjtit të nxjerrët aktgjykim lirues pasi që nuk ka prova që vërtetojnë se i njëjti ka kryer veprën penale që i ngarkohet.

I pandehuri A.R., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështes deklaratën e mbrojtëses tim nuk kam asgjë për të shtuar.

Mbrojtësi i të pandehurit F.B., av.H. D., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mire se i mbrojturi i tij ka kryer veprën penale që i vihet në barrë. Prokuroria nuk ka dëshmuar se mbi cilat prova ka vërtetuar se i

mbrojturi i tij ka kryer veprën penale që i ngarkohet, pasi që pajisja DVR është pajisje për monitorimin e kamerave dhe nuk është e qartë se çfarë dobie pasurore ka mund të ketë nga sistemi i kamerave apo ato dy shtëpizat HP. Po ashtu, edhe nga dëgjimi i dëshmitarëve, të njëjtit me asnjë rast nuk e kanë përmendur të mbrojturin e tij si pronar të ndonjëres nga pikat në aktakuzë, tutje, ka shtuar se i mbrojturi i tij në gjithë fazat e procedurës ka deklaruar se i njëjti ka qenë i punësuar për 4 muaj si punëtor i thjesht pa asnjë pozitë menaxheriale, as pronar e as qiramarrës i asaj pike, si pronar e ka njohur vetëm I. G. si punëdhënës të tij. Mbi bazën e të lartcekurave, ka kërkuar nga gjykata që ndaj të mbrojturit të tij të nxjerrët aktgjykim lirues pasi që nuk ka prova që vërtetojnë se i njëjti ka kryer veprën penale që i ngarkohet.

I pandehuri F.B., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështes deklaratën e mbrojtësit tim nuk kam asgjë për të shtuar.

Mbrojtësja e të pandehurit Rr.B., av. F. H. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se me asnjë provë nuk është arritur të provohet akuza e prokurorisë lidhur me të mbrojturin e saj, prokuroria nuk ka arritur të tregoj as objektin dhe mjetin e kryerjes se kësaj veprë penale dhe se nuk është specifikuar kontributi i secilit, andaj edhe nuk mund të ketë bashkëkryerje mes të akuzuarve, tutje, ka shtuar se prokuroria me asnjë provë nuk ka arritur se i mbrojturi i saj ka qenë menaxher ndonjëherë, pasi që i njëjti ka qenë vetëm punëtor dhe atë vetëm 3-4 ditë para bastisjes ka filluar punën (punë provuese) si roje dhe se nuk ka pasur ndonjë kontratë. Ka deklaruar se i mbrojturi i saj nuk ka pasur të bëjë fare me ato lojëra, e as me aparatet dhe se nuk ka pasur njohuri eventualisht për licencimin e tyre, ka deklaruar se i mbrojturi i saj nuk e njeh asnjërin prej të akuzuarve dhe se nuk ka pasur raporte asnjëherë lidhur me lokalin. Kurse lidhur me kualifikim e ri juridik dhe atë për veprë penale e njëjtë mirëpo të kryer në formë të ndihmës, të njëjtën tërësisht e kundërshtojmë meqenëse i mbrojturi im Rr.B., nuk ka pas të bëjë fare as me objektin e çështjes ngase i njëjti ka qenë roje, jashtë dhe ka punuar vetëm 3-4 ditë, prandaj si mundet i posa punësuar me përvojë pune tre dite ta di se a janë aparatet e licencuar, a punon me leje apo jo që ti ndihmoje atij në ndonjë mënyrë për ndonjë përfitim, kurse sa i përket bashkëkryerjes i mbrojturi saj kurr në jetën e tij nuk i ka pare, nuk ka përgatitë dhe nuk ka bashkëpunuar me asnjë prej të akuzuarve në aktakuzë, prandaj prokuroria deri më tani lidhur me Rr. B. nuk ka argumentuar asgjë, mbi bazën e të lartcekurave ka kërkuar nga gjykata që ndaj të mbrojturit të saj të nxjerrët aktgjykim lirues pasi që nuk ka prova që vërtetojnë se i njëjti ka kryer veprën penale që i ngarkohet.

I pandehuri Rr.B., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështes deklaratën e mbrojtësit tim nuk kam asgjë për të shtuar.

Mbrojtësi i të pandehurit Q.M., av. F. B. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se aktakuza e prokurorisë është në tërësi e pabazuar dhe në kundërshtim me dispozitat e KPP-së pasi që janë dëgjuar dëshmitarë të propozuar vetëm nga ana e prokurorisë. Nga administrimi i provave në shqyrtim gjyqësor me asnjë provë nuk është vërtetuar se i mbrojturi i tij ka ndërmarr ndonjë veprim në drejtim të kryerjes së veprës penale e cila i ngarkohet. Gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se lokali “...” ka pasur leje për lojëra të fatit, edhe pse në përgjithësi kjo nuk bie në

përgjegjësinë e të mbrojturit të tij i cili ka qenë punëtor me paga mujore dhe në asnjë mënyrë nuk ka menaxhuar me atë pikë dhe një fakti i tillë vërtetohet edhe nga deklaratat e Q. B., i cili ka deklaruar se: “ *që të dy, ai dhe Q.M., kanë punuar me orar të rregullt në lokal dhe nuk kanë pas asnjëri pozitë menaxheriale në lokal* ”. Veprimet me të cilat kryhet vepra penale e Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm, paraqiten në mënyrë alternative dhe atë: “ *organizon, merr pjesë apo ndihmon në organizimin e bixhozit, lojërave të llojit të kazinove apo lojërave të fatit siç përcaktohet me ligj, për të cilat nuk është dhënë licenca, leja apo koncesioni i organit kompetent* ” dhe se në rastin konkret, nuk është plotësuar asnjëra nga to, pasi që kuptimi i shprehjes “ *organizon* ”, është veprimtaria për qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore ku pjesëmarrësit paguajnë shuma të caktuara parash pjesëmarrësve të tjerë të cilët para atyre janë kyçur në veprimtari dhe presin pagesën e shumë s të caktuar të të hollave nga pjesëmarrësit të cilët pas tyre pritët të kyçen në veprimtarinë e tillë, e që në rastin konkret një kusht i tillë nuk është përmbushur pasi që i mbrojturi i tij ka punuar në lokalin i cili ka pasur licence. Mbi bazën e të lartcekurave nuk është provuar as ndihma që e ka kryer, ka kërkuar nga gjykata që ndaj të mbrojturit të tij të nxjerrët aktgjykim lirues pasi që nuk ka prova që vërtetojnë se i njëjti ka kryer veprën penale që i ngarkohet.

I pandehuri Q.M., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështes deklaratën e mbrojtësit tim nuk kam asgjë për të shtuar.

Mbrojtësi i të pandehurit M.K., av. H. K., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, vërtetohet se i mbrojturi i tij është i pafajshëm dhe se me asnjë provë nuk është vërtetuar se i njëjti ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Tutje, ka shtuar se prokuroria akuzën ndaj të mbrojturit të tij e ka mbështetur vetëm në një deklaratë të dhënë nga Q. B., e të cilën deklaratë prokuroria e ka shtrembëruar pasi që ky dëshmitar ka deklaruar se pronari i bastrës ku ai ka punuar (...) ka qenë G. K., ndërsa prokuroria thekson se dëshmitari ka deklaruar se pronari i bastrës ka qenë M.K., ka deklaruar se i mbrojturi i tij nuk ka qenë pronar e as menaxher i lokalit ku janë zhvilluar lojërat e fatit, e as pronar apo bashkëpronar i ndonjë aparati, një fakti i tillë është vërtetuar edhe nga deklaratat e të akuzuarit G.N., i cili ka deklaruar se të mbrojturin e tij (M.K.) e njeh dhe se ai e ka marrë në punë, ka punuar vetëm dy jave dhe se nuk ka pasur pozite menaxhuese dhe se në atë pika kanë qenë 4 aparate që kanë qenë të tij (G.N.). Po ashtu, edhe dëshmitari Q. B. ka deklaruar se menaxher i bastores të ... në P. ka qenë Q.M., ndërsa pronar G. K. dhe se M. K. nuk e njeh. Mbi bazën e të lartcekurave, ka kërkuar nga gjykata që ndaj të mbrojturit të tij të nxjerrët aktgjykim lirues pasi që nuk ka prova që vërtetojnë se i njëjti ka kryer veprën penale që i ngarkohet.

I pandehuri M.K., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështes deklaratën e mbrojtësit tim nuk kam asgjë për të shtuar.

Mbrojtësja e të pandehurit S.B. av. Sh. Sh. G. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se meqenëse sipas aktakuzës se ngritur nga ana e prokurorisë i mbrojturi im S.B., akuzohet për veprat penale nga neni 300 par 1 dhe 2 të KPRK-së, në gjatë gjithë fazës së procedurës mbrojtja e kemi bërë në drejtim të veprës Krim i organizuar, për faktin se sa i përket veprës penale Organizim i skemave

piramidale shkresat e lëndës e posedojmë aktvendimin e datës 17.07.2017 me nr PP.II.nr.117/2017 të cilën e ka marrë Prokuroria Themelore Prishtinë. -Departamenti i përgjithshëm, ku është bërë hudhja e kallëzimit penal në drejtim të veprës së lartcekur. Ndërsa sa i përket pjesës së tjetër ku i mbrojturi im gjatë deklaratës së dhënë në polici, prokurori dhe në gjykatë, i njëjti ka deklaruar se ka punuar në cilësinë e punëtorit përafërsisht dy muaj rresht mirëpo bazuar në ligjin për lojëra të fatit i cili përcakton qartë se dhënia e licencave iu jepet subjekteve ekonomike, i njëjti nuk ka qene subjekt ekonomik e as nuk ka qene punëtor apo pronar ku ka ushtruar punën e tij për çka nuk ka pasur nevojë as të marrë leje nga organet kompetente komunale. Të gjitha provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës e dëshmojnë faktin se i njëjti ka punuar vetëm si punëtorë dhe nisur nga kjo nuk bie barrë e përgjegjësisë as për sigurimin e licencës dhe as për sigurimin e lejes së punës, i njëjti nuk ka qene në dijeni dhe as që ka mundur të dijë se po kryhet një veprë penale, i cili ka deklaruar se bashkëpandehurit nuk i ka njohur dhe në vendin e punës asnjërin nga ta nuk ia ka siguruar dhe në çdo formë dëshmohet se nuk është kryes i veprave penale as si në aktakuzë e as në rikualifikimin e bere nga PRSK. Andaj kërkoj nga gjykata që në mungesë të provave të merr aktgjykim lirues ose mundet edhe Aktgjykim refuzues duke u bazuar ne aktvendimin e lartcekur.

I pandehuri S.B., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështes deklaratën e mbrojtëses time nuk kam asgjë për të shtuar.

Mbrojtësi e të pandehurit A.Q., av.K. F. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se sa i përket të mbrojturit tim i njëjti është ftuar fillimisht si dëshmitarë për deklaratë në polici, dhe i cili nuk ka dëshmuar në prokurori dhe në gjykatë nuk ka mundur të sigurohet prania e tij dhe ky është elementi i vetme qe e lidh me këtë aktakuzë, dhe në deklaratën e dëshmitarit Q. B. krejt çka deklararon është se i mbrojturi im ka qene duke punuar në objektin “...” por se nuk cek se çfarë pozicioni ka pas. E me krejt këto që fillim thirret si dëshmitar e pastaj si i akuzuar në cilësinë e kryerësit të vepra penale, e tash në ri cilësimin e sotëm si ndihmës i veprës penale tregon shumë se i njëjti nuk ka asnjë lidhje me të akuzuarit e tjerë, duke cekur se me shumicën as nuk njihet personalisht e duke pas parasysh se gjatë gjithë shqyrtimit asnjë dëshmitarë i vetëm nuk e ka përmendur, e nuk ka asnjë prove të vetme se i mbrojturi im nuk ka qenë as dëshmitarë, e as kryes e as ndihmës i kësaj vepre penale, kërkojmë nga gjykata që të mbrojturin tim ta lirojë nga kjo akuzë dhe të marrë Aktgjykim Lirues.

I pandehuri A.Q.: në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështes deklaratën e mbrojtësit tim nuk kam asgjë për të shtuar.

Mbrojtësi i të pandehurit A.H., av. Rr. A., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se prokuroria nuk ka ofruar asnjë provë për të vërtetuar se i mbrojturi i tij ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Nga provat e administruara është vërtetuar që i mbrojturi i tij ka qenë punëtor në firmën “...” në Gj., ku ishte punësuar(pa kontratë) nga P. R., me rekomandimin e dy punëtorëve tjerë B. S. dhe G.N., të cilët e kanë rekomanduar për shkak se i mbrojturi tij ka qenë veteran i luftës dhe ishte në gjendje të rëndë ekonomike. I mbrojturi i tij ka deklaruar se ka punuar rreth 6 muaj në këtë market dhe për punën e bërë i ka raportuar pronarit P. R. Fakti i tillë, sipas mbrojtjes është vërtetuar edhe nga deklarimi i vet të mbrojturit të tij në polici dhe prokurori, ku ka deklaruar se ka punuar në

këtë firmë, ku paga ka qenë 15 euro për ditë, e qe me bakshishe qe i janë dhënë nga lojtarët fitues ka arritur pagën 600 euro. Fillimisht, ka punuar si punëtor me çelësa (kur fiton lojtari ia jep paret dhe ia shlyen paret). Detyrat e tij të punës kanë qenë: pagesa e shërbimeve komunale, blerja e pijeve mujore dhe shërbime të ngjashme si material për higjienë etj. Tutje, ka shtuar se në deklaratat e dhëna ne polici dhe prokurori, i mbrojturi i tij ka deklaruar se firmën ku ai ka punuar, e kanë vizituar vazhdimisht zyrtaret e ATK-së, ku edhe i kanë kontrolluar aparatet, por asnjëherë nuk kanë pasur ndonjë vërejtje pasi që aparatet kanë qenë të licencuar. Po ashtu, ka deklaruar se i mbrojturi i tij ka qenë vetëm punëtor në këtë firmë dhe se nuk ka qenë pronar, bashkëpronar apo aksionar i saj, dhe nuk ka pasur detyra që të kujdeset për marrjen e licencave, apo që të marrë leje për ushtrimin e veprimtarisë së biznesit, respektivisht për tu kujdesur që firma të jetë në rregull me dokumentacion. Nga dëshmia e dëshmitarit P.R., vërtetohet se i njëjti ka qenë i autorizuar nga vëllai i tij Sh. R. që të udhëheqë me firmën, dhe se i njëjti ka pasur autorizim për të punësuar punëtoret, ku e ka punësuar edhe të mbrojturin A. Po ashtu, është vërtetuar fakti se i njëjti ka qenë menaxher ne piken e kazinosë në Gj., ku ka punuar edhe A. dhe se detyrat e A. sipas tij kanë qenë të kujdeset për lokalin, për arkën dhe të njëjtën kohe të bëjë furnizimin e për pije dhe kafe për klientët. Nga dëshmia e këtij dëshmitari është vërtetuar edhe fakti që lokali ka pasur leje pune dhe se 10 aparatet sa kanë qenë aty, kanë pasur licencë. Gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar fakti që i mbrojturi i tij nuk njeh asnjë prej të akuzuarve, me përjashtim të G.N., e as këta nuk e njohin A. Mbi bazën e të lartcekurave, ka kërkuar nga gjykata që ndaj të mbrojturit të tij të nxjerrët aktgjykim lirues pasi që nuk ka prova që vërtetojnë se i njëjti ka kryer veprën penale qe i ngarkohet.

I pandehuri A.H., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështes deklaratën e mbrojtësit tim nuk kam asgjë për të shtuar.

I pandehuri M.M., në mbrojtjen e tij gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se mbes pranë deklaratave të dhëna më herët, më pas ka shfrytëzuar të drejtën ligjore të mbrohet në heshtje, ndërsa në deklaratën e dhen në prokurori me datë 19.01.2021 ka deklaruar se i ka pas hapur disa pika të lojërave të fatit si: te ... në L. dhe te ...-ja nën firmën e ‘’...’’, të cilat i ka hapur se bashku me pronarin e ‘’...’’, e që është P.R., i njëjti i ka sjell aparatet, i cili edhe është kujdesur për licencat – dokumentacionin, pasi që puna ka ecur mire, ka deklaruar se e ka blerë licencën e firmës nga P.R. dhe e ka mbajtur nën firmën ‘’...’’, në emër të vëllait të tij F.M., i ka shtuar se në pikat e tij nuk ka pasur asnjë parregullsi dhe se tatimin gjithherë e ka paguar me rregull.

Gjykata vlerëson mbrojtjen e të pandehurit M.M., nga e njëjta gjen se i ka pas hapur disa pika të lojërave të fatit si: te ... në L. dhe te ...-ja nën firmën e ‘’...’’, të cilat i ka hapur se bashku me pronarin e ‘’...’’, P.R., me pas e ka blerë licencën e firmës nga P.R. dhe e ka mbajtur nën firmën ‘’...’’, në emër të vëllait të tij F.M., i ka shtuar disa pika të lojërave të fatit, gjykata gjen se deklarata e të pandehurit M.M., është në pajtim me gjendjen faktike të vërtetuar në këtë çështje penale, pasi që i njëjti pohon se në bash kryerje me të pandehurin F.M. kanë pasur disa pika të lojërave të fatit nën firmën që e drejtonin, kjo mbrojtje gjen mbështetje në mbrojtjen e të pandehurit A.Q. që ka deklaruar se e kam pa në kontratë të punës sime, është konstatuar se punëdhënësi është M.M., si dhe vërtetohet nga mbrojtja e të pandehurit A.R., nga dëshmitë e

dëshmitareve D. B., Sh. J. dhe Xh. M. të ndëgjuar në këtë çështje penale si dhe në provat materiale.

I pandehuri F.M., në mbrojtjen e tij gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se e shfrytëzoi të drejtën ligjore të mbrohet në heshtje, ndërsa në deklaratën e dhënë në prokurori me datë 30.10.2020, ka deklaruar se ka punuar si menaxher i firmës "...", në lokalin në rruga "...", në lagjen ..., P., ndërsa pronar i firmës "...", është Sh. R., po ashtu, ka deklaruar se veprimtaria e lokalit është me lojëra të fatit, me aparate, ku në lokal i ka pasur katërmëdhjetë (14) aparate, ku tetë (8) prej tyre janë "Mercur", dy (2) janë "Kajot", dy (2) janë "Apex", e ku të cilët pas kontrollës janë marrur nga policia, ka sqaruar se lokali nuk ka as leje pune dhe as licencë, ndërsa aparatet të cilët janë gjetur në lokalin e tij, janë pronë e Sh. R., në deklaratën e dhënë në polici me datën 29.09.2016 ka deklaruar se nuk ka pasur kontrata të shkruar me Sh. R. por vetëm marrëveshje gojore, ndërsa i ka pasur dy punëtorë, rrogën e ka marrë kesh në shumën prej 500 euro në muaj, ndërsa Sh. R. e ka njoftuar se aparatet janë të doganuara dhe paguhet akcizë për ta, ndërsa pjesët tjera të deklaratës janë të njëjta nuk ka ndonjë ndryshime me deklaratën e dhënë në prokurori.

Gjykata vlerëson mbrojtjen e të pandehurit F.M., gjatë mbrojtjes së tij pohon se ka kryer veprën penal për të cilën është gjetur fajtorë, nga e njëjta mbrojtje vërtetohet se ka punuar si menaxher i firmës "...", në lokalin në rruga "...", në lagjen ..., P., ndërsa pronar i firmës "...", është Sh. R., ka sqaruar se lokali nuk ka as leje pune dhe as licencë, kjo mbrojtje gjen mbështetje në dëshminë e dëshmitarit P. S. ku vërtetohet se ka punuar në një lokal që kanë qenë gjithsej 14 aparate, menaxher i këtij lokali ka qenë F.M., në dëshminë e dëshmitarit Ç. B., ku vërtetohet ka punuar në një lokal me emrin "...", që si veprimtari e ka pasur lojëra të fatit, menaxher i këtij lokali ka qenë A.Q., kurse pronar i lokalit ka qenë F.M., ka sqaruar se në atë lokal kanë qenë 10 aparate të lojërave të fatit si Kajot, Apex, Mercur, ndërsa mohon se ka qenë pronar i firmës "...", gjykata gjen se deklaratat e të pandehurit F.M., është në kundërshtime me gjendjen faktike të vërtetuar në këtë çështje penale, kjo mbrojtje është e dhënë vetëm me qëllim të ikjes nga përgjegjësia penale, dhe nuk gjen mbështetje në mbrojtjen e të pandehurit M.M. ku ka deklaruar se e ka blerë licencën e firmës nga P.R. dhe e ka mbajtur nën firmën "...", në emër të vëllait të tij F.M., e as mbrojtjen e të pandehurit G.N. që ka deklaruar se vëllazërit M. dhe F.M., i njoh si aksionarë-bashkëpronar të firmës "...". gjykata gjen se mbrojtjen e tij nuk është e sinqertë dhe objektive, nuk gjen mbështetje në mbrojtjen e të pandehurve tjerë, si dhe në prova materiale.

I pandehuri G.N. në mbrojtjen e tij gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se gjatë muajit mars të vitit 2016 kam punuar në "...", si punëtor teknik, kam ndreqë aparatet, i kam mbajtur prej një kazinoje që ska pas pune i kam qu në pikën tjetër, pronar ka qenë Sh.R. por i njëjtit nuk ka qenë asnjëherë pronar fizikisht sepse ka jetuar jashtë vendit, ndërsa P.R. ka qenë i autorizuar deri në 2016 dhe përgjegjës për licencimin e aparateve e ka pas P.R., unë kam pasur kontratë pune dhe pagën e kam pranuar përmes bankës, nuk kam qenë asnjëherë pronar i ndonjë kompanie të lojërave të fatit, ndërsa pas marsit të vitit 2016 nuk kam punuar në ndonjë kompani të lojërave të fatit, ka qenë vetëm një pikë e lojërave të fatit e imja tek objekti ..., kanë qenë katër aparatet e mia personale i kam ble në M., ku i kam ble ka pas shqiptare dhe shkiqe, aparatet janë kon në të

zezës të pa licencuar në kohëzgjatje prej 2 javësh, me pas shton se më kujtohet deklarata që kamë thënë më herët se vetëm dy muaj kam punuar si menaxher, më pas ka deklaruar se M. dhe F.M. i njoh si figura kanë punuar së bashku me dhëndrin tim P. R., duke u bazuar në atë që e kam dëgjuar nga dhëndri P.R. ka thënë se vëllezërit M. i njoh si aksionarë në firmën "...", ku ka qenë pronar P.R., si aksionarë e kam kuptua si bashkëpunëtorë e kanë pas kompaninë përgjysmë, ndërsa sa u përket të pandehurve tjerë V. e njoh se jemi rritë bashkë e kam kojshi, ndërsa M. K. e kam marrë në punë dhe në pune e kam marre vetëm si shok, jo prej anës se kompanisë, pasi që M.K. nuk ka qenë as pronar e as menaxher vetëm ka pas me i fshi paret me u barazua, ndërsa A.H. e njoh dhe jemi njohur kur kemi shkuar me i ndreqë aparatet, ka deklaruar se qëndroj pranë deklaratave të dhënë në fazën e hetimeve, ndërsa në deklaratën e dhënë në prokurori me datë 16.02.2021 ka deklaruar se në vitin 2014 apo 2015 ka filluar të punoj si punëtor në firmën "...", pronar i të cilës ka qenë Sh. R., ku si detyra ka pasur të bëjë bartjen e aparateve nëpër lokale të ndryshme në Kosovë, ku në fillim të vitit 2016 ka shtuar se ka marrë pozitën e menaxherit në firmën "...", por nuk ka qenë i obliguar të kujdeset për lejet e aparateve, ku shton se është penduar që është marrë me lojëra të fatit dhe se ka mbajtur aparate në mënyrë të paligjshme, ndërsa në deklaratën e dhënë në polici me datën 21.04.2016, mbrohet në heshtje.

Gjykata vlerëson mbrojtjen e të pandehurit G.N., nga e njëjta vërtetohet se gjatë muajit mars të vitit 2016 ka punuar në "...", i ka ndreqë aparatet, i ka bajtë prej një kazinoje që ska pas pune i kam qu në pikën tjetër, ka punuar si menaxher, ndërsa pas marsit të viti 2016, e kamë pasur vetëm një pikë e lojërave të fatit tek objekti "...", kanë qenë katër aparatet të mij personal, janë kon në të zezën të pa licencuar në kohëzgjatje prej 2 javësh, sqaron për gjykatën se M. dhe F.M. i njoh pasi që kanë punuar së bashku me dhëndrin P. R., kam dëgjuar nga dhëndri P.R. ka thënë se vëllezërit M. i njoh si aksionarë në firmën "...", ku ka qenë pronar P.R., si aksionarë e kam kuptua si bashkëpunëtorë e kanë pas kompaninë përgjysmë, gjykata gjen se i pandehuri G.N. në bashkëkryerje me të pandehurit M.M. dhe F.M.- që të dy në cilësi të bashkaksionarve kanë shpërnda aparate të pa licencuara, aparate të falsifikuara nëpër pika të ndryshme në Kosovë, po ashtu sqaron për gjykatën se e njeh të pandehurin V. pasi që janë rritë bashkë, si dhe nga mbrojtje e tij vërtetohet se i pandehurit M. K. e ka marrë në punë dhe nuk ka qenë as pronar e as menaxher vetëm ka pas si detyrë me i fshi paret me u barazuar, po ashtu nga mbrojtja e tij vërtetohet se e njeh të pandehurin A.H. pasi që me të janë njohur kur janë shkuar me i ndreqë aparatet, gjykata vlerëson se i pandehuri G.N. në mbrojtjen e tij pohon kryerjen e veprës penale për të cilën është shpallua fajtor dhe është dënuar si në dispoziti I. të këtij Aktgjykimit, pas që i pohon rrethanat se : i ka njohur të pandehurit M.M. dhe F.M.- që të dy në cilësi të bashk-aksionarve në firmën "...", pohon se ka qenë menaxher i lojërave të fatit, i ka shpërndarë aparatet e lojërave të fatit, i ka rregulluar aparatet e lojërave të fatit së bashku me të pandehurin A.H., ka pas në menaxhim një pike të lojërave të fatit tek objekti "...", kanë qenë katër aparatet të tij personale, janë kon në të zezën të pa licencuar, gjykata gjen se mbrojtjen e tij është e sinqertë dhe objektive, gjen mbështetje në mbrojtjen e të pandehurve tjerë, si dhe në prova materiale.

I pandehuri V.H., në mbrojtjen e tij gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se aparatet që i janë marrë tek unë janë të licencuara dhe se të njëjta mu kanë kthyer, më pas e ka shfrytëzuar të drejtën ligjore të mbrohet në heshtje, ndërsa në deklaratën e dhënë në prokurori me datë

28.01.2020, ka deklaruar se në vitin 2011 apo 2012 ka hapur një lokal të cilin e ka marrë me qira në Fshatin ..., Komuna e I., ku ka shërbyer kafë dhe pije të ndryshme, e që pastaj e ka shndërruar në bastore, ku ka rënë në kontakt me pronarin e “...” N. E. dhe punëtorët e tij i kanë sjellur pajisjet për bastore dhe veprimtarinë e kanë zhvilluar pa problem në bazë të licencës që kishte “...”. Pas një kohe e ka zgjeruar veprimtarinë edhe me aparate Apex, për të cilat aparate ka shtuar se nuk ka ditur që nuk kanë licencë, pasi që policia i ka konfiskuar aparatet e Apexit, ka deklaruar se janë paraqitur disa persona nga “...” dhe i kanë propozuar që t’i dërgojnë aparatet e tyre në lokalin e tij në ..., duke i garantuar se aparatet e tyre janë të licencuar, me pas deklaroi se edhe këta aparate janë konfiskuar nga policia dhe vetëm atëherë e ka kuptuar se kjo veprimtari është e kundërligjshme, se përndryshe nuk do të punonte, ndërsa në deklaratën e dhënë në polici me datën 23.04.2015 ka deklaruar se merret me bastore që dy vite dhe për bastore e ka pasur licencën, ndërsa për aparatet ka thënë se janë Kajot, është i firmës “...” dhe se e ka vetëm në shfrytëzim dhe se ky aparat është i licencuar, kurse aparatet 1 dhe 2 janë të firmës Apex, edhe këta i ka në shfrytëzim dhe janë pa licencë.

Gjykata vlerëson mbrojtjen e të pandehurit V.H., nga e njëjta gjen se merret me bastore që dy vite dhe për bastore e ka pasur licencën, ndërsa për aparatet ka thënë se janë Kajot, është i firmës “...” dhe se e ka vetëm në shfrytëzim dhe se ky aparat është i licencuar, kurse aparatet 1 dhe 2 janë të firmës Apex, edhe këta i ka në shfrytëzim dhe janë pa licencë, gjykata vlerëson se i pandehuri V.H. në deklaratat e lartcekura pohon kryerjen e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor dhe është dënuar si në dispozitivit II. të këtij Aktgjykimit, gjykata gjen se deklaratat e të pandehurit gjen mbështetje në dëshminë e dëshmitarit A. O. të ndërgjuar në këtë çështje penale si dhe në prova materiale.

I pandehuri A.R. në mbrojtjen e tij gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se gjatë vitit 2016 kamë punuar në lokal “...”, në ..., si punëtor, kontratë nuk kam pas, rrogën e kam marrë kesh, i kam shërbyer pije klientëve dhe nuk jam marrë me aparate, aparatet i ka sjellë firma “...it”, me ka punësuar në atë lokal një shok A. K. ka qene pronar i 7 apo 8 aparate të lojërave të fatit, kanë pas licence, i ka mbikëqyrë ky A., me pas deklaroi se pronari emrin e ka pas në licence të “...”, smë kujtohet emri kush ka qenë, jeni marrë vesh me dy apo tre punëtor me punua aty dhe me A., punëtorët janë kanë B., G., Sh. J., ndërsa M.M. dhe F.M. i njoh, i kam taku shok mas shoki në P., M. nuk më ka marrë në punë, ka deklaruar se qëndroj pranë deklaratave të dhënë në fazën e hetimeve, në deklaratën e dhen në prokurori me datë 29.01.2020 ka deklaruar se ka punuar si punëtor në lokalin “...” dhe këtë punë ia ka siguruar M.M., duke shtuar se nuk e ka ditur që aparatet nuk kanë licencë dhe këtë e ka kuptuar vetëm kur është kontrolluar lokali, ndërsa në deklaratën e dhen në polici me datën 18.10.2016 ka deklaruar se ka punuar në një lokal në fshatin ..., roli i tij ka qenë rregullimi i dritave, ndërsa si menaxher i biznesit është J. K. e i cili lokal nuk ka licencë dhe as leje pune, i njëjti ka deklaruar në atë lokal janë luajtur vetëm lojëra me aparate dhe se këto aparate i ka sjellë M.M. dhe se ka menduar se aparatet janë të licencuara.

Gjykata vlerëson mbrojtjen e të pandehurit A.R., nga e njëjta vërtetohet se gjatë vitit 2016 kamë punuar në lokal “...”, në ..., si punëtor, cili lokal nuk ka licencë dhe as leje pune, këtë punë ia ka siguruar M.M., aparatet i ka sjellë M.M. dhe nuk e ka ditur që aparatet nuk kanë licencë, gjykata

gjen se deklaratat e të pandehurit A.R. ku deklarohet se ka qenë vetë punëtor në lokalitetin e lartcekur, kjo mbrojtje është e dhënë vetëm me qëllim të ikjes nga përgjegjësia penale, mbrojtja e tij nuk gjen mbështetje në dëshminë e dëshmitarëve Sh. J. dhe Xh. M. të ndërgjegjuar në këtë çështje penale si dhe në prova materiale.

I pandehuri F.B. në mbrojtjen e tij gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se mbështetja pranë deklaratave të dhëna më herët, më pas ka shfrytëzuar të drejtën ligjore të mbrohet në heshtje, në mbrojtjen e tij në Prokurori me datë 19.01.2021 ka deklaruar se mbetet në tersi pranë deklaratës së dhënë në polici duke potencuar se punon në firmën “...” si punëtor me një rrogë prej 230 euro në muaj, dhe këtë vend të punës ja ka gjetur I. G. nga Gj. i cili është pronar dhe menaxher i pikës ku ka punuar, ndërsa sa i përket lokalitetit nuk ka njohuri se a ka licencë apo leje të punës pasi që detyrë e tij ka qenë vetëm pritja e mysafirëve ata të cilët kanë fituar i ka paguar, ka regjistruar hyrjet dhe daljet dhe pastrimin e lokalitetit, ndërsa në mbrojtjen e tij në polici me datën 28.01.2016 ka deklaruar njëjtë si në deklaratën e dhënë në prokurori nuk ka ndonjë ndryshim.

Gjykata vlerëson mbrojtjen e të pandehurit F.B., nga e njëjta gjen se ka punuar në firmën “...” si punëtor me një rrogë prej 230 euro në muaj, dhe këtë vend të punës ja ka gjetur I. G. nga Gj. i cili është pronar dhe menaxher i pikës ku ka punuar, ndërsa sa i përket lokalitetit nuk ka njohuri se a ka licencë apo leje të punës pasi që detyrë e tij ka qenë vetëm pritja e mysafirëve ata të cilët kanë fituar i ka paguar, ka regjistruar hyrjet dhe daljet dhe pastrimin e lokalitetit, gjykata pas vlerësimit të deklaratave të pandehurit F.B., gjen se kjo mbrojtje është e dhënë vetëm me qëllim të ikjes nga përgjegjësia penale, pasi që mbrojtja e tij nuk mbështetjet në prova materiale të administruara në këtë çështje penale.

I pandehuri Rr. B. në mbrojtjen e tij gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se kamë punuar në “...”, si roje nate, nuk kamë qenë menaxher, gjatë vitit 2016 kam punua në një kafe 3-4 ditë, pronar nuk e di kush ka qenë, me ka shti në punë një far djali me emrin F. mirëpo mbiemrin nuk ia di, jo F. që është i akuzuar por dikush tjetër, jemi marrë vesh me punua si roje nate prej 20:00 në mbrëmje deri në 06:00 të mëngjesit, skam pas kontratë me shkrim veç marrëveshje me fjalë, nuk i njoh të akuzuarit pasi që veç këtu që i kam taku, më pas deklarohet se pas konsultimeve me mbrojtësen time tani e tutje dëshiroj të shfrytëzoj të drejtën time të mbrohem në heshtje, ndërsa në deklaratën e dhënë në prokurori me datë 20.10.2020 ka deklaruar se ka punuar si sigurim në njërin nga lokalet e lojërave të fatit në ... në P., dhe këtë punë e ka gjetur përmes F. G. ndërsa M.M., F.M. dhe Sh. R. nuk i njeh, ndërsa në deklaratën e dhënë në polici me datën 29.03.2012 mbrohet në heshtje.

Gjykata vlerëson mbrojtjen e të pandehurit Rr. B., nga e njëjta vërtetohet se gjatë vitit 2016 kam punua në një kafe me lojëra të fatit “...”, 3-4 ditë, pronar nuk e di kush ka qenë, e ka punësuar një far djali me emrin F. mirëpo mbiemrin nuk ia di, nuk është i pandehurit F., gjykata gjen se i pandehuri Rr. B. gjatë mbrojtjes së tij, mohon se ka kryer veprën penal për të cilën është gjetur fajtorë, kjo me qëllim të ikjes nga përgjegjësia penale, pasi që mbrojtja e tij nuk mbështetjet në prova materiale të administruara në këtë çështje penale.

I pandehuri Q.M., në mbrojtjen e tij gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se mbes pranë deklaratave të dhëna më herët, më pas ka shfrytëzuar të drejtën ligjore të mbrohet në heshtje, ndërsa në deklaratën e dhëne në prokurori me datë 31.01.2020, ka deklaruar se ka punuar si punëtor në lokalin "...", këtë punë ja ka gjetur G. K., ndërsa si veprimtari e këtij lokali ka qenë bastore, sa i përket aparateve nuk ka pasur njohuri as nuk është interesuar se a kanë apo jo licencë, ndërsa në deklaratën e dhëne në polici me datën 21.04.2016 ka deklaruar se në këtë lokal ka punuar si punëtor, menaxheri i këtij lokali është një person me emrin B. por mbiemrin nuk ja din, kurse pronar i këtij lokali është G. K., ndërsa si veprimtari e këtij lokali ka qenë bastore.

Gjykata vlerëson mbrojtjen e të pandehurit Q.M., nga e njëjta gjen se ka punuar si punëtor në lokalin "...", këtë punë ja ka gjetur G.K., ndërsa si veprimtari e këtij lokali ka qenë bastore, sa i përket aparateve nuk ka pasur njohuri as nuk është interesuar se a kanë apo jo licencë, gjykata gjen se mbrojtja e tij është reale dhe objektive gjen mbështetje në dëshminë e dëshmitarit Q. B. të ndëgjuar në këtë çështje penale si dhe në prova materiale.

I pandehuri M.K. në mbrojtjen e tij gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se në vitin 2016 kam puno dy tre javë në një pikë bastore, nuk kam pas kontratë pune as rrogë skam marrë asnjë kompensim, mu më ka punësuar G.N. më ka thënë a ke nevojë për punë, unë kam pas nevojë me punua dhe kam shkua, i ka pas tre aparate, unë i kam mbikëqyrë, me i pastrua, me i këqyr numrat kush i ka krye lojëra, pasi që për dy javë skam mujt as me mëso punën, asnjëherë nuk jam kanë menaxher, ndërsa pozitën e Granitit nuk e di në cilën pozitë ka qenë, kur është bërë kontrolli policor me sa më kujtohet nuk kam dhënë deklaratë në vendin e punës, ndërsa në deklaratat e dhëne në prokurori me datë 30.01.2020 ka deklaruar se ka punuar në lokalin e djemve të axhës te ... , në P., e në të cilin lokal e ka njoftuar G.N. i cili pastaj edhe i ka siguruar punën në lokalin e tij për lojëra të fatit, ka shtuar se nuk ka ditur që aparatet nuk kanë pasur licenca, pasi që përndryshe nuk do të punonte, ndërsa në deklaratën e dhënë në polici me datë 21.04.2015, mbrohet në heshtje.

Gjykata vlerëson mbrojtjen e të pandehurit M.K., nga e njëjta vërtetohet se në vitin 2016 ka punua dy- tre javë në një pikë të lojërave të fatit, e ka punësuar G.N. pasi që kamë nevojë për punë, i ka pas tre aparate, i ka mbikëqyrë, me i pastrua, me i këqyr numrat kush i ka krye lojërat, asnjëherë nuk është kanë menaxher, ndërsa pozitën e Granitit nuk e di në cilën pozitë ka qenë, gjykata gjen se mbrojtja e tij është si reale dhe objektive gjen mbështetje në mbrojtjen e të pandehurit G.N. si dhe në prova materiale.

I pandehuri S.B. në mbrojtjen e tij gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se tek firma "... " me seli në K. kam fillua me punua një muaj e gjysmë apo dy, diku kah mesi i vitit të 2016, s më kujtohet saktë, kamë punuar si punëtor, skam pas kontratë, pagat i kemi marrë kesh, më ka punësuar njëfarë F., sja di mbiemrin, e di që ka qenë nga M., mka thënë nëse donë me punua me aparate, me punua naj punë, A. edhe ai është i M., as këtij sja di mbiemrin, e kam thirr A. dhe i kam thënë a po ma ofron punën dhe ai më ka thënë po, dy paga i kam marrë dhe ato mi ka dhënë A., qiranë e lokalit e ka paguar A., dhe i njëjti ka pru edhe aparatet, në punë si detyrë e kamë pas mi fshi lokalin, i kam pastrua aparatet, kur kanë lujt ia kam kthye paret, kur kanë fituar ia kam

dhënë paret që i ka fituar. Kam qenë vetëm në ndërrim, nuk i kam njoh asnjëherë të akuzuarit prezent, në deklaratën në polici nuk kam deklarua se e njoh M. dhe nuk e kam ditur kush ka qenë pronar i biznesit, në bazë të dokumentacionit që ka qenë në tavolinë policia e ka vlerësuar atë dokumentacion, pasi që çdo dy apo tre javë ka ardhe dogana i ka këqyrë, ndërsa në deklaratën e dhëne në prokurori me datë 19.12.2019 ka deklaruar se në vitin 2016 ka filluar këtë veprimtari me bastore, ku aparatet ia ka siguruar një person me emrin A.(me të cilin e ka vendosur në takim F.), ku lokalin e ka siguruar ai, ndërsa 7 aparatet ia ka siguruar A., i cili ka qenë punëtor i firmës “...” dhe se shef i tij ka qenë M., ka shtuar se ka qenë vetëm punëtor dhe se ka punuar për pagë dhe se nuk ka ditur që aparatet duhet me pas licencë, se përndryshe nuk do të punonte, ndërsa në deklaratën e dhëne në polici me datën 29.03.2012 ka deklaruar ngjashëm si në deklarata e lartcekura nuk ka ndonjë ndryshim.

Gjykata vlerëson mbrojtjen e të pandehurit S.B., nga e njëjta vërtetohet se kah mesi i vitit të 2016, ka punuar tek firma “...” me seli në K., kamë punuar si punëtor, e ka punësuar njëfarë F., e ka thirr A. dhe i kam thënë a po ma ofron punën dhe dy paga mi ka dhënë A., i njëjti ka pru edhe aparatet, në punë si detyrë e kamë pas mi fshi lokalin, i kam pastrua aparatet, kur kanë luajt ia kam kthye paret, kur kanë fitua ia kam dhënë paret që i ka fituar, gjykata gjen se deklaratat e të pandehurit S.B. të lartcekura janë dhënë vetëm me qëllim të ikjes nga përgjegjësia penale, dhe nuk gjen mbështetje në dëshminë e dëshmitarit A. M. të lexuar në këtë çështje penale si dhe në prova materiale.

I pandehuri A.Q. në mbrojtjen e tij gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se kamë punuar në “...”, kam shërbye pije, furnizim me pije, kam mbajte higjienën, ndërsa me aparate jo skam punua, unë kam punua me punëtor tjerë, ka qenë Q. B. dhe P. A., mua më ka marrë në punë F. G., letërnjoftimin ia kam dhënë F., e kam pas në posedim dhe e kam pa në kontratë është konstatuar se punëdhënësi është M.M., max dy muaj kam punuar, pazarin e ka marrë F. G. e tjerët i kanë marrë rrogat më pas ka deklaruar se e njoh M.M. është shok i babës dhe njihemi familjarisht edhe F. e kam njoftë si vëlla i M., nuk kam pas njohuri se me çfarë biznesi merren M. dhe F., ndërsa dokumentet kanë qenë të prezantuara në mur, licenca, leja dhe lista e aparateve, ndërsa lidhur me tatimet se di se nuk kam qenë i obliguar por e di që çdo gjë ka qenë në rregull, kanë qenë vetëm inspektorët aty, ndërsa në deklaratën e dhëne në prokurori me datë 31.01.2020 ka deklaruar se ka qenë punëtor në lokalin “...”, ku pronar ka qenë M.M., fillimisht ka punuar si punëtor e pastaj ka biseduar me pronarin M.M. që tia mundësonte menaxhimin e këtij lokali, ndërsa në deklaratën e dhëne në polici me datën 18.10.2016, gjykata gjen se është në dëgjuar në cilësi të dëshmitarit pas që është njoftuar për të drejtat konform nenit 125 par 1 të KPP-së.

Gjykata vlerëson mbrojtjen e të pandehurit A.Q., nga e njëjta vërtetohet se ka punuar në “...”, fillimisht ka punuar si punëtor e pastaj ka biseduar me pronarin M.M. që t’ia mundësonte menaxhimin e këtij lokali, gjykata gjen se i pandehuri A.Q. gjatë mbrojtjes së tij pohon se ka kryer veprën penal për të cilën është gjetur fajtorë, mbrojtja e tij gjen mbështetje në dëshminë e dëshmitarit Ç.B. të lexuar në këtë çështje penale si dhe në prova materiale.

I pandehuri A.H. në mbrojtjen e tij gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se qëndroj pranë deklaratave së dhënë më herët dhe shton se kamë punuar në "...", tek Agmia Center, rruga "...", në Gj., jam punësua përmes Bujar Sogojevës, ai ka qenë me vozitësin e vet G.N., V. R. dhe P.R. me të cilët kam bisedua për punësim, masi u hek B. pastaj më ka punësua P.R., nuk kemi bo kontratë pune, rrogën e kam marrë kesh, kam punua me ndërprerje diku 7 muj ditë pune efektive, paga ka qene nja 300 euro, por me bakshishet ka muajt me shkua tek 500 euro, pagën e kam marrë vet, sa herë kam marrë i kam shkrua dhe çdo fund muaji jemi barazua, kam punua në çelësa, e kam marrë orarin, punëtorët janë ndërruar çdo jave, masë shumti unë kam njëjtë, kur i gjet do punëtorë, unë si ma i vjetër jam avansu amo punëtor i thjeshte kam qenë vetëm i kam majtë çelësat, menaxher i asaj pikë ka qenë P.R., shton se e njoh G.N., të pandehurit tjerët është hera e parë që i shoh në gjykatë, më pas shton se natën që janë konfiskua aparatet në momentin e kontrollit nga policia e kam thirr P. R. dhe më ka thënë që për 5min është aty, dhe për 5 min prej P. në Gj. ska mujt me ardhe shpejt, aty kam qenë si dëshmitar nuk e di çka ka shkrua policia, ndërsa në deklaratën e dhëne në prokurori me datë 31.01.2020 ka deklaruar se ka punuar në lokalin e lojërave të fatit "...", si punëtor për një periudhë prej 1 viti e gjysme por që nuk ka punuar rregullisht, se pasi që kishte rënë në kontakt me B. S., G.N. dhe V. R., ishte marrë vesh me t'a që të i'a mundësonin veprimtarinë e ndonjërën nga pikat e lokaleve në qytetin e Gj., nuk ka qenë në dijeni se aparatet kanë qenë të pa licencuara, ndërsa në polici nuk ka dhënë deklaratë.

Gjykata vlerëson mbrojtjen e të pandehurit A.H., nga e njëjta vërtetohet se ka punuar në "...", tek Agmia Center, rruga "...", në Gj., pasi që kishte rënë në kontakt me B. S., G.N. dhe V.R., ishte marrë vesh me t'a që të i'a mundësonin veprimtarinë e ndonjërën nga pikat e lokaleve në qytetin e Gj., nuk ka qenë në dijeni se aparatet kanë qenë të pa licencuara, gjykata gjen se i pandehuri A.H. gjatë mbrojtjes së tij pohuar se ka kryer veprën penal për të cilën është gjetur fajtorë, pasi që mbrojtja e tij gjen mbështetje në mbrojtjen e të pandehurit G.N., ku ka deklarua se i ka rregulluar aparatet e lojërave të fatit së bashku me të pandehurit A.H., në dëshminë e dëshmitari P.R. të ndërgjuar në këtë çështje penale si dhe në prova materiale.

Gjykata nuk është lëshuar në vlerësimin e deklaratave të pandehurit O.E. për shkak se prokurorja e prokurorisë speciale për të njëjtin është tërheqë nga aktakuza.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka proceduar dhe administruar të gjitha provat e propozuara nga Prokuroria, janë ndërgjuar dëshmitarët: Xh. M., Q.B., D. B., Sh.J., A. O. dhe P.R., në cilësi të provës material janë lexuar deklaratat e dëshmitarëve Q. B., P. S. dhe A. M. të dhëna në fazat e më hershme të kësaj çështje penale, ndërsa sa u përket dëshmitarëve B. G. dhe Sh. Th. të propozuar në aktakuzë, prokurorja e prokurori special në seancën e shqyrtimi gjyqësor ka propozuar se të mos ftohen në këtë shqyrtim gjyqësorë pasi që janë dëshmitarët që i përkasin të pandehurve F. Sh. dhe F. B., për të cilët është veçuar procedura penale, ndërsa në cilësinë e provave materiale janë administruar provat e propozuara në aktakuzës, që ju përkasin të pandehurve të lartë cekur, për veprat penale për të cilat akuzohen.

Gjykata konform nenit 7 të KPP-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje dhe përkushtim maksimal

profesional dhe me përkujdesje të njëjtë vërtetoi faktet kundër të pandehurve, si dhe ato në favor të tyre, duke i mundësuar të pandehurve dhe mbrojtëseve të tyre, shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të mbrojtjes dhe me ndërgjegjeje, i vlerësoi çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera, e në bazë të vlerësimit të tillë, ka nxjerr përfundim lidhur me faktet konkrete të vërtetuara, ashtu që pas administrimit të provave vërtetoi këtë gjendje faktike.

Për të vërtetuar këtë gjendje faktike, gjykata në shqyrtim gjyqësor, ka bërë administrimin e provave të propozuara nga prokurori i shtetit, si me poshtë:

Analiza dhe vlerësimi i provave të administruara,

Dëshmitari A. O. në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 14.06.2023 ka deklaruar më kujtohet deklarata e dhënë në vitin 2015 në polici, kam qenë veç punëtorë me punua në fshatin ..., dhe pronar ka qenë V.H., lokal ka qenë me pije, kafe, atë lokal unë e kam marrë me qira dhe tani kamë punua për V., ka pas lojëra të fatit, dy aparate i ka pru V. nuk kane qenë në funksion dhe jemi marre vesh nëse vijnë myshterinjtë me ju tregu për aparate, unë kam punua me rrogë, jam marrë vesh me V. që rroga ime të jetë 300 euro, për këtë rast më kanë marrë në pyetje në polici, ju kam tregu se kujt të janë aparatet dhe nuk e mbajë në mendje se të njëjtit aparate a kanë qenë në rrymë në momentin kur kanë ardhur policia për kontroll në lokalin e lart cekur, ndërsa në deklaratën në polici me datën 23.04.2015 kishte deklaruar se me datë 21.04.2015, dy aparate Apex dhe Kajot i ka sjellë në lokalin e tij V. H. nga fshati ..., Komuna e I., dhe këta aparate janë vendosur në magazinën e lokalit të tij por nuk janë lëshuar në shfrytëzim asnjëherë, marrëveshjen për aparate e ka bërë vëllai i tij K. i cili është në Gj., kurse ky nuk ka njohuri se si funksionojnë aparatet nuk mban përgjegjësi për ta sepse pronar i tyre është V.H.

Gjykata ka vlerësuar edhe dëshminë e këtij dëshmitari, nga e njëjta dëshmi vërtetohet se ka qenë veç punëtor në lokalin në fshatin Lubozhtë, pronar ka qenë V.H., ka pas lojëra të fatit, dy aparate i ka pru V. në lokal dhe jemi marre vesh nëse vijnë myshterinjtë me ju tregu për aparate, nga kjo dëshmi gjykata gjen se i pandehuri V.H. ka ushtruar veprimtarin e lojërave të fatit në fshatin ..., Komuna e I., për çka nuk ka pasur leje pune nga organet kompetente, e njëjta dëshmi e dëshmitarit gjen mbështetje në prova materiale, andaj gjykata e vlerëson dëshminë e dëshmitarit si objektive, reale dhe të sinqertë.

Dëshmitari Q.B. në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 14.06.2023 ka deklaruar se ka punuar në një lokal, ka qenë bastore, se atëherë kanë qenë të ligjshme në 2016 në dijeninë time, selia ka qenë tek ... rruga "...", kam punua dy –tre muaj, nuk më kujtohet se kush më ka punësua, dikush i lagjes, kam punua si punëtorë, kam shtyp tiketa, aty ka pas edhe aparatet për lojërat, kanë qenë nja tre apo katër aparatet nuk e mbaj mend saktësisht se është kohë e gjatë, orari im zakonisht ka qenë paradite por edhe jemi përshtatë me kolege si na ka konvenu, rroga ime ka qenë 200-250 euro i kam marrë kesh, nuk kam pas kontratë pune, kur është bërë pazari i kam marrë sa më kanë vyt, 20 euro i kam marrë gjatë ditës, i kam shkrua në një letër evidencë se sa parë po i marrë, atë letër e ka këqyrë punëtori tjetër Q.M., deri në rrogë, ku pazari ditor ka njëjtë aty deri ka ardhur punëtori tjetër, e di që pronar ka qenë G.K., aparatet i ka sjellë kompania "...", ka qenë edhe një

punëtor tjetër që ka punua zëvendësim me emrin Liridon ndërsa mbiemrin nuk ia di, me pas ka deklaruar se në deklaratën që e ka dhënë në lokal që më kanë intervistuar policia e datës 21.04.2016, që ka deklaruar „menaxheri i lokalit ka qenë Q.M., dëshmitari është përgjigjur se me dijen time Q.M. nuk ka qenë menaxher por vetëm punëtor, ndërsa në deklaratën e tij të dhënë në polici me datën 21.04.2016 kishte deklaruar se është punëtor në lokalin “...” që gjendet te rruga e P.it, në P., i cili lokal si veprimtari e ka bastoren sportive dhe aparate të lojërave të fatit dhe të cilin e menaxhon Q.M., ndërsa pronar është G. K. Tutje ka deklaruar se nuk ka njohuri nëse lokali ka licencë apo jo, ndërsa ka punuar me dy ndërrime dhe është paguar 250 euro, por nuk ka pasur kontratë dhe pagën e ka marrë kesh. Sa i përket aparateve ka deklaruar se në atë lokal kanë qenë 4 aparate të lojërave të fatit, të firmës “...”, të cilët i kanë rregulluar dhe janë kujdesur për mirëmbajtjen e tyre.

Gjykata ka vlerësuar dëshminë e këtij dëshmitari, nga e njëjta dëshmi vërtetohet se dëshmitari ka punuar në lokalin “...”, i cili lokal si veprimtari e ka bastoren sportive dhe aparate të lojërave të fatit, e di që pronar ka qenë G. K., aparatet i ka sjellë kompania “...”, por pas ballafaqimi me deklaratën e tij të dhënë në polici të cituar, “të cilin e menaxhon Q.M.”, dëshmitari është përgjigjur se me dijen time Q.M. nuk ka qenë menaxher por vetëm punëtor, gjykata vlerëson se dëshmia e këtij dëshmitari është e sinqertë dhe gjen mbështetje në prova materiale.

Dëshmitari P.R., në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 14.06.2023 ka deklaruar se me autorizim me nr.DHRNR2734,/2011, jam i autorizuar nga vëllai im Sh.R., që të ndërmerri veprime juridike për të udhëhequr firmën N.SH.”...”, kam pas të drejtë të punësoi njerëz në ato pika të cilat unë i kam menaxhuar sepse kompania në viti 2013 ka ndërrua status, kam pas të menaxhuar pikë në rrugën “...”, Gj., me pas deklaroi se e njoh personin A.H. ka qenë i punësuar në lokalin në Gj., në qendrën “...”, lokali e ka pas një reklamë që është quajtur”...” por në realitet ka qenë në firmën e “...”, ku ka pasur leje pune, A.H. ka pas përgjegjësi të kujdeset për lokalin, për arkën dhe të njëjtën kohë të bëjë furnizim për pije dhe kafe për klientët, A. nuk mund ta quash as pozitë menaxheriale e as punëtor, dhe një prej obligimeve kryesore ka qenë për ta mbajtur arkën dhe unë si punëdhënës e kam pas problem, menaxhimin e kam bërë unë ndërsa Ardiani është përkujdesë për arkën, deklaroi se në atë lokal ka pas aparate, kanë qenë të licencuara dhe kanë qenë në listën që e lëshon ATK, aparate fillimisht i kemi pas 7 aparate, pas kërkesës se ATK-së, i kemi vendosë 10 aparate, është e çuditshme sesi janë tërheq ato aparate nga ia lokal, për arsyeje se kanë qenë të licencuara dhe të paraqitura në listën e aparateve të licencuara, e vetmja shkelje që është konstatuar nga ATK-ja ka qenë se ne nuk kemi të drejtë të hapin lokal të natyrës së njëjtë 500 metra larg shkollave dhe vendbanimeve, që është e konstatuar në ligjin përkatës.

Gjykata ka vlerësuar dëshminë e këtij dëshmitari, nga e njëjta dëshmi vërtetohet se e njeh personin A.H. ka qenë i punësuar në lokalin në Gj., të quajtur”...” por në realitet ka qenë në firmën e “...”, pas që A.H. ka pas përgjegjësi të kujdeset për lokalin, për arkën dhe të njëjtën kohë të bëjë furnizim për pije dhe kafe për klientët, A. nuk mund ta quash as pozitë menaxheriale e as punëtor pasi që një prej obligimeve kryesore ka qenë për ta mbajtur arkën, e njëjta dëshmi e dëshmitarit gjen mbështetje në prova material, që vërtetohet se i pandehurit A.H. në cilësinë e

menaxherit në lokalën e lojërave të fatit "...", në rrugën "...", në Gj., ka marrë pjesë në organizimin e lojërave të fatit në mënyrë të kundërligjshme e i cili lokal nuk kishte leje të punës nga organet kompetente, andaj gjykata e vlerëson dëshminë e dëshmitarit si objektive dhe të sigurtë.

Dëshmitari D.B., në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 26.05.2023, ka deklaruar se kam punuar në kazino afërsisht as një muaj, kam marrë një gjysmë rroge prej 170 euro, në punë më ka shti një far F., mbiemri i tij s'më kujtohet, detyra ime ka qenë me bo pagesat në kacë që kanë luajtur njerëzit, orari i punës ka qenë tetë orë, kur e kam përfunduar orarin, ato pare ia kam dorëzuar atij F. dhe nuk e kam ditë se kush është menaxher i atij lokali se veç një muaj kam punuar, në polici s'më kujtohet se kam dhënë deklaratë, se i kam pas do operacione të rënda, e shikon nënshkrimin e tij në atë procesverbal deklaron se është nënshkrimi im në të dy fletët, duke shtuar se më shumë atëherë kamë pas njohuri rastin se tani, se për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore nuk më kujtohet, ndërsa në deklaratën e dhënë në polici kishte deklaruar se punon në kazinonë "...", ku pronar është M. por mbiemrin e tij nuk e din, ndërsa si detyrë ka pasur kontrollimin e aparateve të kazinosë, tutje ka deklaruar se ka njohuri se lokali ka pasur licencë dhe ka qenë gjithçka në rregull dhe ka zhvilluar këtë veprimtari prej 3 vitesh, dhe sa ka njohuri ky biznes i ka rreth 100 pika në të gjithë Kosovën, ndërsa sa i përket pagës ka deklaruar se paguhet 350 euro dhe si lokal punon me 2 ndërrime, ndërsa sa i përket aparateve se ku janë blerë i njëjti ka thënë se nuk ka njohuri, ndërsa leximin e tyre e bën një femër me emrin T. por mbiemrin e saj nuk e dinë por me sa ka njohuri e njëjta është nga Sh., por është edhe një person me emrin F. Sh. që bën leximin e aparateve.

Gjykata ka vlerësuar dëshmitë e këtij dëshmitari, nga të njëjtat dëshmi vërtetohet se ka punuar në kazinonë "...", ku pronar është M. i por mbiemrin e tij nuk e din, si detyrë ka pasur kontrollimin e aparateve të kazinosë, ka sqaruar se ka njohuri se lokali ka pasur licencë dhe ka qenë gjithçka në rregull ka zhvilluar këtë veprimtari prej 3 vitesh, dhe se ky biznes i ka rreth 100 pika në të gjithë Kosovën, nga kjo dëshmi gjykata gjen se i pandehuri M.M., në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për lojërat e fatit nr.04/L-080, në atë mënyrë që në bashkëkryerje me të pandehurit si në dispozitiv I. të këtij aktgjykimit, nëpër pika të ndryshme në tërë territorin e Kosovës kanë siguruar dhe shpërndarë aparate të ndryshme të lojërave të fatit, aparate pa numra serik, aparate me numra serik të falsifikuar, te lokalet pa licencë dhe leje pune të organeve kompetente, andaj gjykata gjen se e njëjta dëshmi e dëshmitarit gjen mbështetje në prova materiale, andaj gjykata e vlerëson dëshminë e dëshmitarit si objektive, reale dhe të sigurtë.

Dëshmitari Sh. J., në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 26.05.2023, ka deklaruar se në vitin 2016 kam punuar në një kazino "...", në R., ku rastësisht jam taku me një A. të ... mbiemrin nuk e di dhe kam hy në punë, i njëjti ma ka dhënë rrogën diku 300 euro në muaj, nuk kam pas kontratë të punës, orarin e punës e kam pas prej 07 :00 deri në 19:00, puna ime ka qenë punëtor i thjeshtë kur ka pas lojtarë që kanë lutje, kanë fituar në kazino, unë ju kam dhënë parat e fitimit, në këtë punë kam punuar shumë shkurt afërsisht një muaj, ka qenë fillimi dhe kam punuar veç vet, ska pas tjerë, ndërsa në polici kam dhënë deklaratë, ku në pyetjen në polici keni thënë se A. ju ka shti në punë kurse pronar është A.R., ndërsa pronare kryesore është një person me emrin M., e të cilin nuk e njoh", është përgjigjur se qëndron kjo që e kamë thënë në polici, ndërsa në

deklaratën e tij të dhënë në polici me datë 18.10.2016 kishte deklaruar se ka punuar në një lokal të lojërave të fatit në R., të cilin e ka punësuar A.R., ndërsa si pronar me sa ka dëgjuar ka qenë një person me emrin M., por të njëjtin nuk e ka takuar asnjëherë as nuk e njeh. Tutje ka deklaruar se ka punuar me dy ndërrime, ndërsa si pagën e ka pasur 200-300 euro, si dhe ka deklaruar se në këtë lokal kanë qenë rreth 8 aparate të lojërave të fatit.

Gjykata ka vlerësuar dëshmitë e këtij dëshmitari, nga të njëjtat dëshmi vërtetohet se ka punuar në një kazino “...” në R., është ballafaqua me deklaratën e dhënë në polici “ në pyetjen në polici keni thënë se A. ju ka shti në punë kurse pronar është A.R., ndërsa pronare kryesore është një person me emrin M., e të cilin nuk e njoh”, ka konfirmuar se qëndron kjo që e kamë thënë në polici, ashtu nga kjo dëshmi gjykata gjen se i pandehuri A.R. në cilësinë e menaxherit në lokalin e lojërave të fatit “...”, në rrugën “...”, në R., ka marrë pjesë në organizimin e lojërave të fatit në mënyrë të kundërligjshme , e i cili lokal nuk kishte leje të punës nga organet kompetente për të ushtruar një veprimtari të tillë, po ashtu nga kjo dëshmi gjykata gjen se i pandehuri M.M. në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për lojërat e fatit nr.04/L-080, në atë mënyrë që në bashkëkryerje me të pandehurit si në dispozitiv I. të këtij aktgjykimit, nëpër pika të ndryshme në tërë territorin e Kosovës kanë siguruar dhe shpërndarë aparate të ndryshme të lojërave të fatit, aparate pa numra serik, aparate me numra serik të falsifikuar, te lokalet pa licencë dhe leje pune të organeve kompetente, andaj gjykata gjen se e njëjta dëshmi e dëshmitarit gjen mbështetje në provat materiale, andaj gjykata e vlerëson dëshminë e dëshmitarit si objektive, reale dhe të sinqertë.

Dëshmitari Xh. M., në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 26.05.2023, ka deklaruar se gjatë viti 2016, në R. janë kanë 7-8 kazino, unë kamë punuar roje në ekoregjion, përballë me 2-3 kazino dhe kam shkuar pesë herë në Kajota dhe Apex për të lujtë në kazino, unë kam qenë lojtarë në lojë e kisha dertin tim qysh me fitua pare, sa here me kanë ndalë polici ju kam dhënë letërnjoftimin, ata me thoshin me qenë dëshmitaren në rast, ndërsa se a ka dhënë dëshmi në polici dy faqet e para të procesverbalit të datë 18.10.2016 konfirmon se është nënshkrim i tij ndërsa në fq. e tretë nuk është, ndërsa në deklaratën e dhënë në polici me datën 18.10.2016 kishte deklaruar se ka punuar si roje sigurimi një lokal të lojërave të fatit në Rahovec, e ka punësuar A.R., në rast se ndodh ndonjë vjedhje, ndërsa pronar ka qenë M. po të njëjtin nuk e ka takuar asnjëherë.

Gjykata ka vlerësuar dëshmitë e këtij dëshmitari të dhënë në shqyrtim gjyqësor e njëjta dëshmi nuk gjen ngjashmëri me dëshminë e dhënë në polici pran të cilës qëndron, ku nga të njëjta dëshmi vërtetohet se ka punuar si roje sigurimi një lokal të lojërave të fatit në Rahovec, ku e ka punësuar A.R., ndërsa pronar ka qenë M., nga kjo dëshmi gjykata gjen se i pandehuri A.R. në cilësinë e menaxherit të dy lokaleve të lojërave të fatit “...”, në rrugën “...”, në R., dhe lokalit “Casino ...”, në fshatin ..., Komuna e R., ka marrë pjesë në organizimin e lojërave të fatit në mënyrë të kundërligjshme , e të cilat lokale nuk kishte leje të punës nga organet kompetente për të ushtruar një veprimtari të tillë, po ashtu nga kjo dëshmi gjykata gjen se i pandehuri M.M. në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për lojërat e fatit nr.04/L-080, në atë mënyrë që në bashkëkryerje me të pandehurit si në dispozitiv I. të këtij aktgjykimit, nëpër pika të ndryshme në tërë territorin e Kosovës kanë siguruar dhe shpërndarë aparate të ndryshme të lojërave të fatit,

aparate pa numra serik, aparate me numra serik të falsifikuar, te lokalet pa licencë dhe leje pune të organeve kompetente, andaj gjykata vlerëson dëshminë e dëshmitarit të dhënë në polici si objektive, reale dhe të sinqertë, njëjta dëshmi e dëshmitarit gjen mbështetje në prova material, ndërsa dëshminë e dhënë në shqyrtim gjyqësor nuk ja fal besimin pasi që e njëjta dëshmi është në kundërshtim me dëshminë e dhënë në polici të cilën e konfirmoj se e ka nënshkruar vet në dy faqe.

Dëshmitari P. S. në deklaratën e tij të dhënë në polici me datën 29.09.2016 kishte deklaruar është student dhe ka punuar në një lokal që si veprimtari e ka pasur lojëra të fatit dhe ka vetëm aparate, për të cilin nuk ka qenë në dijeni se ka apo nuk ka leje të punës, kurse menaxher i këtij lokali ka qenë F.M., kurse pronar nuk e di se kush ka qenë. Tutje ka deklaruar se atë kanë punuar dy punëtor ndërsa paga ka qenë 300 euro, por kontratë të rregullt nuk ka pasur sepse ka qenë vetëm praktikant. Sa i përket aparateve të lojërave të fatit ka deklaruar se kanë qenë gjithsej 14 aparate, 8 prej tyre Merkur, 2 Act, 2 Apex dhe 2 Kajot dhe përgjegjës për këto aparate ka qenë e menaxherit.

Gjykata ka vlerësuar dëshminë e këtij dëshmitari, nga të njëjtat dëshmi vërtetohet se ka punuar në një lokal që kanë qenë gjithsej 14 aparate, menaxher i këtij lokali ka qenë F.M. dhe përgjegjës për këto aparate ka qenë e menaxherit, nga kjo dëshmi gjykata gjen se i pandehuri F.M. në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për lojërat e fatit nr.04/L-080, në atë mënyrë që në bashkëkryerje me të pandehurit si në dispozitiv I. të këtij aktgjykimit, nëpër pika të ndryshme në tërë territorin e Kosovës kanë siguruar dhe shpërndarë aparate të ndryshme të lojërave të fatit, aparate pa numra serik, aparate me numra serik të falsifikuar, te lokalet pa licencë dhe leje pune të organeve kompetente, andaj gjykata gjen se e njëjta dëshmi gjen mbështetje në dëshmitë e dëshmitarëve tjerë të ndërgjuar në këtë çështje penale si dhe në provat materiale, andaj gjykata e vlerëson dëshminë e dëshmitarit si objektive, reale dhe të sinqertë.

Dëshmitari A. M. në deklaratën e tij të dhënë në polici me datën 21.04.2016 kishte deklaruar se ka punuar në një lokal i cili gjendet në K. për një periudhe prej 6 muajsh, menaxher i këtij lokali ka qenë S.B., ndërsa si detyra të punës dhe përgjegjësi ka pasur punën me klientë brenda lokalit, ndërsa pazarin ditor ja ka dorëzuar menaxherit të lokalit.

Gjykata ka vlerësuar dëshminë e këtij dëshmitari, nga të njëjtat dëshmi vërtetohet ka punuar në një lokal i cili gjendet në K. për një periudhe prej 6 muajsh, menaxher i këtij lokali ka qenë S.B., ndërsa si detyra të punës dhe përgjegjësi ka pasur punën me klientë brenda lokalit, ndërsa pazarin ditor ja ka dorëzuar menaxherit të lokalit, nga kjo dëshmi gjykata gjen se i pandehuri S.B., në cilësinë e menaxherit në lokalit e lojërave të fatit "...”Apex Kajot, në fshatin ..., komuna D. ka marrë pjesë në organizimin e lojërave të fatit në mënyrë të kundërligjshme e i cili lokal nuk kishte leje të punës nga organet kompetente për të ushtruar një veprimtari të tillë, andaj gjykata gjen se e njëjta dëshmi e dëshmitarit gjen mbështetje në provat materiale, andaj gjykata e vlerëson dëshminë e dëshmitarit si objektive, reale dhe të sinqertë.

Dëshmitari Ç. B. në deklaratën e tij të dhënë në polici me datën 18.10.2016 kishte deklaruar se ka punuar në një lokal me emrin “...” që si veprimtari e ka pasur lojëra të fatit, menaxher i këtij lokali ka qenë A.Q., kurse pronar i lokalit ka qenë F.M. Tutje ka deklaruar se në atë lokal kanë qenë 10 aparate të lojërave të fatit si Kajot, Apex, Merkur.

Gjykata ka vlerësuar dëshminë e këtij dëshmitari, nga të njëjtat dëshmi vërtetohet ka punuar në një lokal me emrin “...” që si veprimtari e ka pasur lojëra të fatit, menaxher i këtij lokali ka qenë A.Q., kurse pronar i lokalit ka qenë F.M., ka sqaruar se në atë lokal kanë qenë 10 aparate të lojërave të fatit si Kajot, Apex, Merkur, nga kjo dëshmi gjykata gjen se i pandehuri A.Q. në cilësinë e menaxherit në lokalin e lojërave të fatit “Casino ...” në rrugën “...” në P., ka marrë pjesë në organizimin e lojërave të fatit në mënyrë të kundërligjshme, e i cili lokal nuk kishte leje të punës nga organet kompetente për të ushtruar një veprimtari të tillë, po ashtu nga kjo dëshmi gjykata gjen se i pandehuri F.M., në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për lojërat e fatit nr.04/L-080, në atë mënyrë që në bashkëkryerje me të pandehurit si në dispozitiv I. të këtij aktgjykimit, nëpër pika të ndryshme në tërë territorin e Kosovës kanë siguruar dhe shpërndarë aparate të ndryshme të lojërave të fatit, aparate pa numra serik, aparate me numra serik të falsifikuar, te lokalet pa licencë dhe leje pune të organeve kompetente, andaj gjykata gjen se e njëjta dëshmi gjen mbështetje në dëshmitë e dëshmitarëve tjerë të ndërgjuar në këtë çështje penale si dhe në prova materiale, andaj gjykata e vlerëson dëshminë e dëshmitarit të lartcekur si dëshmi reale dhe të sinqertë.

Provat Raportet e kontrollit për të gjitha pikat e lokaleve të lojërave të fatit të “...”, “...” dhe “...”, si:

Raporti i Kontrollit të përgjithshëm për të gjeturat dhe sekuestrimet të datës 23.04.2015, ku nga ky raport gjykata ka konstatuar se në bazë të urdhrave të gjykatës se janë bërë kontrole në një lokal kafiteri dhe lojëra të fatit me pronar V. H., në fshatin ..., Komuna e I., që nuk kishte leje të punës nga organet kompetente për të ushtruar një veprimtari të tillë, ku në këtë lokal janë evidentuar parregullsi nga ana e pjesëtarëve doganor dhe janë konfiskuar një aparat i lojërave të fatit Kajo, një aparat Apex dhe dy shtëpiza të kompjuterit të lojërave të fatit KENO, si dhe me datë 23.04.2015, është bërë kontrolli në lokalin në fshatin Vrellë, Komuna e Istogut, që nuk kishte leje të punës nga organet kompetente për të ushtruar një veprimtari të tillë, gjatë kontrollit janë gjetur dhe konfiskuar dy (2) aparate të lojërave të fatit të markës APEX me nr, serik AM 122, AM 013, një (1) i markës KAJOT me numër serik SN 00272, dy (2) shtëpiza të kompjuterëve të lojërave të fatit të markës DELL me numër serik X12-51822 (KENO), dhe Fujitsu – Siemens me numër serik YK3J198214, nga kjo provë vërtetohet se i pandehuri V.H. në vazhdimësi ka marrë pjesë në organizimin e lojërave të fatit në mënyrë të kundërligjshme, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për lojërat e fatit nr.04/L-080, të cilat lokale në adresat të cekura më lartë nuk kishte leje të punës nga organet kompetente për të ushtruar një veprimtari të tillë.

Raporti i Kontrollit të përgjithshëm për të gjeturat dhe sekuestrimet të datës 20.04.2016, ku nga ky raport gjykata ka konstatuar se në bazë të urdhrave të gjykatës se janë bërë kontrole

të lokali i lojërave te fatit "...", i cili gjenden në rrugën "... te ... në P. i koduar me XI. Gjatë kontrollit në lokal janë identifikuar dhe sekuestruar përkohësisht katër (4) aparate te lojërave te fatit, një(1) aparat Apex me nr.serik 80790139, një(1) aparat ACT me nr. 90790216, një(1) aparat Merkur me nr. 2009401, një (1) aparat Kajot me nr. 00390103. Në këtë lokacion janë sekuestruar edhe një (1) shtëpizë kompjuteri HP me nr serik: CZCS171CMQ (race, lojëra me qene), një(1) shtëpizë HP me nr. CZC5171DOV (keno, lotari) dhe një(1) printer për shtypjen e basteve për te dy lojërat e lartcekura. Lokali nuk kishte leje te punës si dhe gjate verifikimit të këtyre aparateve rezultojnë se disa nga ta me po të njëjtin numër serik figurojnë edhe nëpër disa pika të tjera në të cilat është kryer kontrolli, menaxher i kësaj pike është prezantuar Q.M., aparatet e sekuestruar përkohësisht i përkasin kompanisë "...", gjykata gjen se sipas **aktakuzës i pandehuri G.N. ngarkohet me të njëjtin dispozitiv me të pandehurin Q.M.,** se nga koha e pa caktuar deri me datën 29.09.2016, në cilësinë e pronarit të bizneseve "... " dhe " ... 1" ,në bashkëpunim me të pandehurit Sh.R., M.M. dhe të pandehurve tjerë ka shpërnda aparate të palicencuara, aparate të falsifikuara nëpër pika të ndryshme në Kosovë ku kanë vepruar të pandehurit tjerë e gjithashtu i njëjti ka vepruar edhe në lokalin "...", në rrugën "...", pn, në P. bashkë me të pandehurin **Q.M.**, e i cili lokal nuk kishte leje të punës nga organet kompetente për të ushtruar një veprimtari të tillë ashtu që gjatë kontrollit të këtij lokali me datën 21.04.2016, janë gjetur dhe konfiskuar katër (4) aparate të lojërave të fatit si janë cekur më lartë, ku pas shqyrtimit gjyqësor vërtetohet se i pandehuri Q.M. ka qenë vetëm punëtorë në lokalin të lojërave të fatit "...", i cili gjendet në rrugën "... te ... në P., ndërsa pronarë ka qenë G.N., pasi që aparatet e lojërave të fatit në lokalin e lartcekur i ka sjellë i pandehuri G. N. ku në mbrojtjen e tij të dhënë në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se aparatet të lojërave të fatit i ka bartë prej një lokali që nuk ka pas punë i ka vendosur në lokalin tjetër, ndërsa i pandehuri Q.M. në mbrojtjen e tij ka deklaruar se unë kamë qenë vetëm punëtor në lokalin e lartcekur dhe nuk kam pas njohuri a kanë qenë apo nuk kanë qenë aparatet e licencuara, mbrojtja e tij gjen mbështetje në dëshminë e dëshmitarit Q.B. ku ka deklaruar në dëshminë e dhen në gjykatë se në dijeninë time Q.M. ka qenë vetëm punëtor në lokalin e lartcekur, andaj gjykata vlerëson se me të gjitha provat e administruara nuk është vërtetuar se tani i pandehuri Q.M. ka kryer veprën penale për cilën është akuzuar andaj në mungesë të provave u vendos si në dispoziti **IX**, të këtij aktgjykimit.

Me datën 21.04.2016 është kontrolluar lokali i lojërave të fatit "...", i cili gjendet në adresën rruga e ...-se pa numër te ... në P., i koduar si X7, gjatë kontrollit në lokal janë identifikuar dhe sekuestruar përkohësisht gjashtë(6) aparate të lojërave te fatit, një (1) aparat ACT me nr.20010392, një(1) ACT me nr.30010251, një (1) Merkur me nr. 00390111, një(1) Merkur me nr. 2200101, një (1) Kajot me nr. 00273, një(1) Apex me nr. 80790125, dy shtëpiza të kompjuterit dhe një pajisje për lojëra me qen, menaxher i kësaj pike është prezantuar A. B. Lokali nuk kishte leje të punës si dhe gjate verifikimit të këtyre aparateve rezultonte se disa nga aparatet me po të njëjtin numër serik figurojnë edhe në disa pika të tjera në të cilat është kryer kontrolli, në këtë lokal është gjetur dhe sekuestruar edhe lista e aparateve qe i përkasin kompanisë "...". Me datën 21.04.2016 është kontrolluar lokali i lojërave të fatit ... (...) i cili gjendet në adresën rruga e ... pa numër te ... në P., i koduar me X9, gjate kontrollit në lokal janë identifikuar dhe sekuestruar përkohësisht dy(2) aparate të lojërave të fatit, një(1) Apex me nr. serik 11009-14012, një(1) Apex me nr.serik 11009-14429, tri(3) shtëpiza te kompjuterit Siemens dhe një (1) e tipit Dell të cilat

janë përdor për lojëra Keno dhe lojëra me Qen, për te cilat nuk kane licence pune, lokali nuk kishte leje të punës për ushtrimin e veprimtarisë së lojërave të fatit, menaxher i lokalit është prezantuar personi Sh.B., pas verifikimit të aparateve del se të dy aparatet e firmës Apex i përkasin kompanisë "...", gjykata gjen se kjo prove material i përket të pandehurit Sh. B., për të njëjtit është veçuar procedura, ndërsa aparatet e kompanisë "...", me pronar Sh.R. (është në arrati) për të njëjtin është veçuar procedura.

Me datën 21.04.2016 është kontrolluar lokali i lojërave të fatit pa mbishkrim (pa emërtim) i cili gjendet në adresën rruga e ..., pa numër te ... në P., i koduar me X10, gjatë kontrollit në lokal janë identifikuar dhe sekuestruar përkohësisht katër(4) aparate të lojërave të fatit, një(1) aparat Apex me nr.serik 01907-11759, një(1) Apex me nr. 11009-14429, një (1) aparat ACT me nr.90890288 dhe një(1) Merkur me nr.serik 2009402, arsyeja e kontrollit dhe e sekuestrimit të këtyre aparateve ishte sepse lokali nuk posedonte leje pune dhe se pas verifikimit disa nga këta aparate rezultojnë të jene të dublifikuar dhe me të njëjtit numra serik janë sekuestruar edhe në lokacionet e tjera, ndërsa aparati Merkur dhe Apex figurojnë në listën e aparateve të licencuar të kompanisë "...", përveç tyre janë sekuestruar edhe njëmbëdhjetë (11) komplete letra bixhozi, menaxher i këtij lokali është prezantuar personi M.K., ndërsa sipas deklaratave personi qe ka menaxhuar me këta aparate të lojërave të fatit është G.N. i lindur me 18.12.1987, adresa "...", banesat e ...- P., nga kjo provë vërtetohet se i pandehuri G.N. në cilësinë e menaxherit të lokalit të lojërave të fatit pa mbishkrim (pa emërtim) i cili gjendej në adresën rruga e ..., pa numër te ... në P., ka marrë pjesë në organizimin e lojërave të fatit në mënyrë të kundërligjshme i cili lokal nuk kishte leje të punës nga organet kompetente për të ushtruar një veprimtari të tillë, me pas gjykata gjen se i pandehuri M.K. nuk ka menaxhuar me aparatet e lartcekura por ka qenë vetë punëtor i thjeshtë, pasi që këtë e ka pohuar vetë, këtë e ka pohuar edhe i pandehuri G.N. në mbrojtjen e tij të dhënë në shqyrtim gjyqësor duke cituar se aparatet e lartcekur kanë qenë në pronësi të tij, pasi që M.K. nuk ka qenë menaxher, por ka qenë vetë punëtor i thjeshtë sepse ka pasur nevojë për punë.

Me datën 21.04.2016 është kontrolluar lokali i lojërave të fatit ..., Apex, Kajot i cili gjendet në fshati ..., Komuna D. i koduar X14, gjate kontrollit në lokal janë identifikuar dhe sekuestruar përkohësisht shtate (7) aparate të lojërave të fatit për arsye të mungesës së dokumentacionit përkatës dhe lejes së punës, ku pas verifikimit disa nga aparatet rezultojnë të duplifikuar, janë me të njëjtit numra serik me aparatet e tjerë të sekuestruar në lokacione të tjera ku është kryer kontrolli: një(1) Hot Spot me nr. 100080215, një(1) Hot Spot me nr. 100080201, një(1) Merkur me nr. 01907-08358, ne(1) Merkur me nr. 2009401, një(1) Kajot me nr.89715712, një(1) Apex me nr. 80790139, një(1) Apex me nr. 80790125, ku si menaxher është prezantuar personi S.B., bazuar në listën e aparateve të ofruar nga menaxheri i kësaj pike(menaxheri i këtij lokali) aparatet figurojnë të jene të kompanisë se lojërave të fatit "...", nga kjo provë vërtetohet se i pandehuri S.B. në cilësinë e menaxherit në lokalit të lojërave të fatit ..., Apex, Kajot i cili gjendet fshati ..., Komuna D., ka marrë pjesë në organizimin e lojërave të fatit në mënyrë të kundërligjshme, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për lojërat e fatit nr.04/L-080, i cili lokal në adresën e cekur më lartë nuk kishte leje të punës nga organet kompetente për të ushtruar një veprimtari të tillë.

Me datën 21.04.2016 është kontrolluar lokali i lojërave të fatit ..., ne rrugën "...", në F. i koduar me X16, gjate kontrollit ne lokal janë identifikuar dhe sekuestruar përkohësisht katër dhjetë(40) aparate të lojërave të fatit dhe një rulet të cilët janë sekuestruar për arsye se lokacioni i tyre i lejuar (sipas lejes) gjenden në disa qendra të tjera në K., ndërsa pas verifikimit të këtyre aparateve disa nga ta rezultojnë të duplikuar dhe të sekuestruar me po të njëjtën date në disa lokacione të tjera, përkohësisht janë sekuestruar katër dhjetë(40) aparate.

Raporti i Kontrollit të përgjithshëm për të gjeturat dhe sekuestrimet të datës 27.01.2016, ku nga ky raport gjykata ka konstatuar se janë bërë kontrole në lokalin "... Bacardi, rruga "...", E12, në P., e në këtë lokal janë gjetur 17 aparate të lojërave të fatit Merkur, nga to 16 ishin të licencuara për në qytete të tjera dhe adresa tjera, e jo në këtë adresë që janë gjet dhe të cilat janë konfiskuar shtatëmbëdhjetë (17) aparate të lojërave të fatit të markave të ndryshme si Merkur me numër serik 2009401, 2200100, 3139300005, 390111, 2317, 100080221, 100080225, 100080212, 100080211, APEX me numër serik 80790129, 80790147, KAJOT me numër serik 11039128, 0101, aparat ACT me numër serik 0173, aparat APEX me numër serik 807901140, aparat Hot – Spot me numër serik 100080227, një shtëpizë kompjuteri HP me numër serik CZC4160MCM, një DVR H me numër serik 2008922022, gjykata gjen se lokalin e lartcekur e ka menaxhuar i pandehuri Rr.B., ka marrë pjesë në organizimin e lojërave të fatit në mënyrë të kundërligjshme, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për lojërat e fatit nr.04/L-080, i cili lokal në adresën e cekur më lartë nuk kishte leje të punës nga organet kompetente për të ushtruar një veprimtari të tillë.

Me datë 27.01.2016, është bërë kontrollimi i lokalit te ..., me pronar F.B., ku janë gjetur dhe sekuestruar një DVR i tipit multistar, 2 shtëpiza kompjuteri të tipit HP, të holla në shumën prej 560.50 si dhe 6 aparate të bixhozit, nga kjo provë vërtetohet se i pandehuri F.B., në cilësinë e menaxherit në lokalin të lojërave të fatit te ..., ka marrë pjesë në organizimin e lojërave të fatit në mënyrë të kundërligjshme, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për lojërat e fatit nr.04/L-080, i cili lokal në adresën e cekur më lartë nuk kishte leje të punës nga organet kompetente për të ushtruar një veprimtari të tillë.

Raporti i Kontrollit të përgjithshëm për të gjeturat dhe sekuestrimet të datës 18.10.2016, ku nga ky raport gjykata ka konstatuar se janë bërë kontrole në lokalin "... i cili gjendet në rrugën "...", në R., ku janë gjetur dhe sekuestruar 6 aparate të lojërave të fatit KAJOT, 2 aparate të lojërave të fatit APEX si, para në vlerë prej 3770 euro dhe 1 DVR, po ashtu në të njëjtën datë është bërë kontrolli në lokalin "Casino ..."(...) në rrugën kryesore në fshatin ..., Komuna e R., ku janë gjetur dhe sekuestruar nëntë (9) aparate të lojërave të fatit me mbishkrimin Hotspot (Admiral) me numër serik 100080138, Hotspot (Admiral) me numër serik 100080202, Apex me numër serik 80790126, 80790146, Kajot me numra serik S.N.89714813, S.N.11039108, S.N.11039110, S.N.11039129, S.N.11039102, dhe para në vlerë prej njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë (167) euro, gjykata gjen se lokalet e lartcekura janë kanë të menaxhuara nga i pandehuri A.R., ka marrë pjesë në organizimin e lojërave të fatit në mënyrë të kundërligjshme, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për lojërat e fatit nr.04/L-080, të cilat lokale në adresat e

cekura më lartë nuk kishin leje të punës nga organet kompetente për të ushtruar një veprimtari të tillë.

Me datë 18.10.2016, është kontrolluar lokali i lojërave të fatit “Casino ...”, ku janë gjetur dhe konfiskuar dhjetë (10) aparate të lojërave të fatit të markës Merkur me numër serik 3145400417, 3145400342, Apex me numër serik 80790134, 80790135, Kajot me numra serik 390122, 390121, 390120, 11039114, Hotspot (Admiral) me numër serik 1000802216, Hotspot (Admiral) me numër serik 100080219 dhe para në vlerë prej shtatëqind e gjashtëdhjetë e tre, pesëdhjetë e tre cent (763.50) euro, gjykata gjen se lokali i lartcekur është menaxhuar nga i pandehuri A.Q., ka marrë pjesë në organizimin e lojërave të fatit në mënyrë të kundërligjshme, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për lojërat e fatit nr.04/L-080, i cili lokal në adresën e cekur më lartë nuk kishte leje të punës nga organet kompetente për të ushtruar një veprimtari të tillë.

Raporti i Kontrollit të përgjithshëm për të gjeturat dhe sekuestrimet të datës 29.09.2016, ku nga ky raport gjykata ka konstatuar se janë bërë kontrole në lokalin “Merkur” në P., në rrugën “...”, me pronar N. P., i cili ka thënë se nuk posedon dokumente për këtë veprimtari që ushtron, e në këtë lokal janë gjetur dhe konfiskuar dhjetë (10) aparate të lojërave të fatit, ku gjashtë (6) nga ta të markës Merkur, me numër serik 3145400189, 3145400139, 3145400427, 3145400178, 3145400200, dy (2) të markës Kajot me numër serik 8000932515, 8000922414, dhe dy (2) të markës Apex me numër serik 80790133, 80790136 si dhe shumën e parave prej 55 euro.

Nga këto raporte gjykata ka konstatuar se në këto lokacione që ju përkasin të pandehurve në këtë çështje penale janë gjetur dhe sekuestruar:

1. Adresa rruga “...”, pn, te ..., P. (Raporti i kontrollës X1) janë gjetur dhe konfiskuar katër (4) aparate të lojërave të fatit si: aparat APEX me nr, serik 8079139, aparat ACT me numër serik 90890216, aparat Merkur me numër serik 2009401, aparat KAJOT me numër serik 00390103, DVR i kamerave 1GOIE4FPALC05T5, shtëpizë HP (Race) CZC5171CMQ, shtëpizë me numër serik CZC5171DOV, printer të tiketave Keno-Race B85B19C14116, Kopje Licence nr. 28/2015 dhe Certifikate e regjistrimit të biznesit me nr. 70591472.
2. Adresa rruga” ..., kati I, lokalet te ...” P. (Raporti i kontrollës X9) në lokalin e lojërave të fatit “Blu Beting (...)” janë gjetur dhe konfiskuar dy (2) aparate të lojërave të fatit të markës APEX me nr, serik 100009-14012, 11009-14429, dhe katër (4) shtëpiza kompjuteri, si: tre (3) shtëpiza kompjuteri të markës “Siemens”, me numër serik: YKXR090184, YKXR054516 dhe YKXR068408, dhe një (1) shtëpizë kompjuteri të markës “DELL”, me numër serik 557N53J, janë gjetur dhe konfiskuar katër (4) aparate të lojërave të fatit si: aparat APEX X10 D1 me nr, serik 01907-11759, aparat ACT X10 D2 me numër serik 90890288, aparat MERKUR X10 D3 Lft me numër serik 2009402, aparat APEX X10 D4 me numër serik 11009-14429 DVR i kamerave X10 D5 1GO1E4FPALX36U0, njëmbëdhjetë (11) letra bixhozi dhe gurë për lojëra, Kontratë me kompaninë e sigurimeve kobra.

3. Adresa fshati ..., Komuna D. (Raporti i kontrollës X14) në lokalim e lojërave të fatit “...” Apex Kajot, janë gjetur dhe konfiskuar shtatë (7) aparate të lojërave të fatit, Hot Spot me numër serik 100080215, Merkur me numër serik 01907-08358, Hot Stop me numër serik 10080201, MERKUR me numër serik 2009401, KAJOT me numër serik 89715712, APEX me numër serik 8079039, APEX me numër serik 80790125, DIË AR 20141208020, 517 euro si dhe disa dokumente.
4. Adresa rruga “...” F. (Raporti i kontrollës X16) janë gjetur dhe konfiskuar dyzet (40) aparate të ndryshme të lojërave të fatit, si: KAQJOT me numër serik 00390119, 11039130, 11039120, 11039117, 11039100, 11039116, HOTSPOT me numër serik 100080201, 100080220(defekt), MERKUR me numër serik 2200110, 2200105, 2200105, 2200101, 2009408, 100021285101, 100080223, 2009402, 100022286103, 2009409, 100020284101, ACT me numër serik 90890207, 90890203, APEX me numër serik 80790138, MERKUR me numër serik 100080209, 2200109, 313930009, 2200107, 100080201, 2200104, 2200108, 100019283100, 100080224, 00390115, 00390114, 00390113, 00390111, 00390110, KAJOT me numër serik 11039110, 11039123, 11039125, 11039115, një (1) rolet e tipit AIK me numër serik 20895, një (1) shtëpizë kompjuteri HP me numër serik CZC9113JJF, një DVR-8032 me numër serik 354201404120168 dhe një mijë e dyqind e dyzetetë (1248) euro.
për lojëra me qen dhe 11 komplete letra bixhozi si dhe gurë për lojëra. Nga kontrolli në lokacionin në D. janë sekuestruar 7 aparate të lojërave të fatit, si dhe në lokacionin në F. 40 aparate të lojërave të fatit. Gjithashtu, nga kontrolli në lokacionin në Gj. janë sekuestruar 10 aparate të lojërave të fatit. Me urdhrin për kontroll dhe bastisje **PNKR.nr.191/16 të datës 29.09.2016** të lëshuar nga Gjyqtarja e Procedurës Paraprake në P. – Departamenti i Krimeve të Rënda, janë kontrolluar 2 lokacione në P. dhe atë: lokali i lojërave të fatit -... me adresë në rruga "...", në të cilin lokal janë sekuestruar 10 aparate të lojërave të fatit, si dhe lokali ..., me adresë rruga "...", ku janë sekuestruar 13 aparate të lojërave të fatit. Po ashtu, me urdhrin për kontroll dhe bastisje **PNKR.nr.191/16 të datës 18.10.2016** të lëshuar nga Gjyqtarja e Procedurës Paraprake në P. – Departamenti i Krimeve të Rënda, janë kryer kontrole në 2 lokacione në R.: lokali ... me adrese në rruga "...", në të cilin lokal janë sekuestruar 8 aparate të lojërave të fatit si dhe lokali – ..., në fshatin ... ku janë sekuestruar 9 aparate të lojërave të fatit. Mbi bazën e këtij urdhri, është kryer kontroll edhe në 1 lokacion në P. në lokalit – ... me adresë në rrugën "...", ku janë sekuestruar 10 aparate të lojërave të fatit. Lidhur me pretendimin e mbrojtjes se janë kryer kontrolli dhe sekuestrimi pa filluar hetimet dhe se kjo përbën shkelje, gjykata vlerëson se masat e fshehta dhe kontrolli i shtëpisë dhe personit në proceduarën penale janë veprime hetimore të cilat parimisht mund të zbatohen vetëm gjatë hetimeve, përkatësisht, pasi prokuroria të fillojë hetimet me aktvendim ndaj një personi (të pandehuri) të caktuar. Megjithatë, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, nga ky rregull ka *vetëm një përjashtim, që përcaktohet me nenin 84.4 të KPP-ës, i cili e lejon urdhërimin e masave të fshehta teknike të hetimit edhe pa filluar procedura penale, por me kusht që të mos dihet identiteti i të pandehurit. Një situatë e tillë vlen edhe kur kemi të bëjmë me kontroll dhe sekuestrim, meqë në rastin konkret nuk është ditur identiteti i të pandehurve, nuk kanë mundur të fillojnë hetimet, pasi që hetimet mund të fillojnë vetëm kur identifikohet saktë personi ndaj të cilit fillojnë hetimet. Nuk mund të nxjerrët aktvendim për fillim të hetimeve pa u specifikuar personi ndaj të cilit fillohen hetimet pasi që kjo është kërkesë ligjore nga neni 104 i KPP-së ku përcaktohet përmbajtja e aktvendimit për fillim të hetimeve ashtu që thuhet se: ‘Aktvendimi përcakton personin kundër të cilit do të kryhet hetimi, kohën e fillimit të hetimit,’.* Andaj, në rastin konkret, realizimi i kontrollit dhe sekuestrimit pa filluar hetimet, sipas vlerësimit të kësaj gjykate është në përputhje me dispozitat ligjore të lartcekura dhe se nuk paraqet shkelje fakti që nuk ka pasur aktvendim për fillim të hetimeve.

Lidhur me pretendimin e mbrojtjes të pandehurit F.M. Av.N. R. se fillimi i hetimeve është bërë pas 2 viteve nga kryerja e veprës penale, meqë vepra është kryer deri me datë 29.09.2016, ndërsa aktvendimi për fillimin e hetimeve është nxjerr me datë 25.03.2019, sipas vlerësimit të kësaj gjykate një rrethanë e tillë nuk përbën kurrfarë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale. Aktvendimi për fillim të hetimeve është nxjerr me datë 25 Mars 2019 dhe ka përfunduar me 25 Mars 2021, por është vazhduar me aktvendimin e gjykatës PPPS.nr. 129/19 të datës 01.03.2021 edhe për 6 muaj dhe deri me datë 25 shtator 2021. Një gjë e tillë është bërë në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale ku me nenin 159 par.1 përcaktohet se: ‘Kur fillohet hetimi, hetimi përfundon brenda dy (2) viteve’, si dhe në paragrafin 2 ku përcaktohet se: ‘Gjyqtari i procedurës paraprake mund të autorizojë një vazhdim deri në gjashtë (6) muaj të hetimit nga paragrafi 1. të këtij neni, në rastet kur hetimi penal është i ndërlikuar,

përfshirë por pa u kufizuar kur ka katër apo më shumë të pandehur, janë identifikuar disa të dëmtuar, është bërë kërkesa për ndihmë juridike ndërkombëtare, apo ekzistojnë rrethana tjera të jashtëzakonshme”. Mbi bazën e të lartcekurave gjykata vlerëson se hetimet janë kryer brenda afatit ligjor si dhe në pajtim me dispozitat ligjore. Mendimi juridik i Gjykatës Supreme në të cilën thirret mbrojtja, nuk vlen në rastin konkret, pasi që në rastin konkret fillimi i hetimeve nuk është bërë mbi bazën e një kallëzimi penal të policisë, por mbi bazën e raportit informues dhe dihet që prokuroria është e lidhur vetëm me kallëzimin penale sa i përket ndërmarrjes së veprimeve juridik, respektivisht fillimit të hetimeve, hedhjen e kallëzimit penale apo kërkimin e të dhënave plotësuese. Një detyrim i tillë nuk vlen kur kemi të bëjmë me raport informues të policisë.

Gjykata, ka analizuar pretendimet e mbrojtësve të pandehurve, lidhur me atë se nuk është vërtetuar dyshimi i bazuar mirë se të mbrojturit e tyre kanë kryer veprat penale për të cilat akuzohet, respektivisht pretendimin e mbrojtësit të pandehurit *G.N. - Av.A. K.*, i cili pretendon se prokuroria nuk ka arritur të sjellë asnjë provë të vetme e cila do ta inkriminojë të mbrojturin e tij për veprën penale sipas aktakuzës, pra me asnjë prove nuk është dëshmuar se i mbrojturi i tij të këtë bashkëpunuar apo të këtë shpërndarë aparatet të lojërave të fatit me asnjë prej të akuzuarve tjerë dhe se i njëjti ka qenë vetëm si punëtor dhe nuk ka qene përgjegjës për licencimin e asnjë pajisje të lojërave të fatit. Po ashtu, mbrojtësja e të pandehurit *V.H. - Av.L. B. Y.* pretendon se prokuroria nuk ka arritur të argumentojë se i mbrojturi i saj të këtë vepruar në organizimin e bixhozit, lojërave të llojit të kazinove apo lojërave të fatit, siç përcaktohet me ligj për të cilat nuk është dhënë licenca, leja apo koncesioni i organit kompetent dhe se deklaratat e konsideruara si të lexuara janë marrë në kundërshtim me dispozitat e KPP-së pasi që iu është mohuar e drejta e marrjes në pyetje të palëve në procedurë, andaj të njëjtat deklarata nuk mund të administrohen si provë, po ashtu, prova të papranueshme janë edhe deklaratat e të mbrojturit të tij në fazën hetimore pasi që të njëjtat janë marrë pa prezencën e avokatit edhe pse mbrojtja ka qenë e detyrueshme në këtë rast. *Mbrojtësja e të pandehurit A.R. - Av.M. Q.*, ka pretenduar se me asnjë provë të administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është vërtetuar se i mbrojturi i saj ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, pasi i njëjti ka qenë vetëm punëtor në lokal dhe se me asnjë provë nuk është vërtetuar se i njëjti ka qenë menaxher apo ka organizuar lojërat e fatit në mënyrë të kundërligjshme. *Mbrojtësi i të pandehurit F.B. - Av.H. D.*, ka pretenduar se nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mire se i mbrojturi i tij ka kryer veprën penale që i vihet në barrë dhe se prokuroria nuk ka dëshmuar se mbi cilat prova ka vërtetuar se i mbrojturi i tij ka kryer veprën penale që i ngarkohet, e po ashtu edhe nga dëgjimi i dëshmitarëve, të njëjtit me asnjë rast nuk e kanë përmendur të mbrojturin e tij si pronar të ndonjëres nga pikat në aktakuzë. *Mbrojtësja e të pandehurit Rr.B. - Av. F. H.*, ka pretenduar se me asnjë provë nuk është arritur të provohet akuza e prokurorisë lidhur me të mbrojturin e saj, prokuroria nuk ka arritur të tregoj as objektin dhe mjetin e kryerjes së kësaj veprë penale dhe se nuk është specifikuar kontributi i secilit, e po ashtu nuk ka arritur ta provojë se i mbrojturi i saj ka qenë menaxher në lokal. *Mbrojtësi i të pandehurit Q.M., av. F. B.* ka pretenduar se nga administrimi i provave në shqyrtim gjyqësor me asnjë provë nuk është vërtetuar se i mbrojturi i tij ka ndërmarr ndonjë veprim në drejtim të kryerjes së veprës penale e cila i ngarkohet dhe se me asnjë provë nuk është vërtetuar se i njëjti ka pasur pozitë menaxheriale. *Mbrojtësi i të pandehurit M.K. - Av.*

H. K., ka pretenduar se nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, vërtetohet se i mbrojturi i tij është i pafajshëm dhe se me asnjë provë nuk është vërtetuar se i njëjti ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Edhe nga dëgjimi i dëshmitarëve është vërtetuar se i mbrojturi i tij nuk ka qenë pronar e as menaxher i lokalit ku janë zhvilluar lojërat e fatit, e as pronar apo bashkëpronar i ndonjë aparati. *Mbrojtësja e të pandehurit S.B. av.Sh. Sh. G.*, ka pretenduar se prokuroria nuk ka arritur ta provojë që i mbrojturi i tij ka kryer veprën penale e cila i ngarkohet dhe të gjitha provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës e dëshmojnë faktin se i njëjti ka punuar vetëm si punëtorë dhe nisur nga kjo nuk bie barrë e përgjegjësisë as për sigurimin e licencës dhe as për sigurimin e lejes së punës. *Mbrojtësi i të pandehurit A.Q. - Av.K. F.* ka pretenduar se me asnjë provë të vetme apo dëshmitarë nuk është vërtetuar se i mbrojturi i tij nuk ka qenë, as kryes e as ndihmës i kësaj veprë penale. *Mbrojtësi i të pandehurit A.H. - Av.Rr. A.*, ka pretenduar se prokuroria nuk ka ofruar asnjë provë për të vërtetuar se i mbrojturi i tij ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet dhe se nga provat e administruara është vërtetuar që i mbrojturi i tij ka qenë vetëm punëtor në lokal.

Gjykata, pas analizimit të pretendimeve të mbrojtësve të të pandehurve si më lartë, se në rastin konkret nuk është provuar përtej çdo dyshimi që të mbrojturit e tyre kanë kryer veprat penale për të cilat akuzohen, ka konstatuar se, me përjashtime të pretendimit të mbrojtësit të pandehurit M.K. – Av.H. K. të cilin pretendim e ka vlerësuar si të bazuar dhe të mbrojturin e tij e ka liruar nga akuza, dhe të pretendimit të mbrojtësit të pandehurit Q. M., av. F. B. të cilin pretendim e ka vlerësuar si të bazuar dhe të mbrojturin e tij e ka liruar nga akuza, ku mbrojtësit kanë pretenduar se nga administrimi i provave në shqyrtim gjyqësor me asnjë provë nuk është vërtetuar se të mbrojturit e tyre kanë ndërmarr ndonjë veprim në drejtim të kryerjes së veprës penale e cila i ngarkohet dhe se me asnjë provë nuk është vërtetuar se të njëjtit kanë pasur pozitë menaxheriale, për të pandehurit e tjerë gjykata ka ardhur në përfundim se pretendimet e mbrojtësve të tyre janë të pabazuara, pasi që nga administrimi i provave në shqyrtim gjyqësor, e të cilat prova gjykata i ka elaboruar secilën veç e veç si më lartë, është vërtetuar përtej çdo dyshimi gjendja faktike si në këtë aktgjykim dhe veprimet e secilit prej të pandehurve, me çka gjykata ka krijuar bindjen se veprimet e tyre përbëjnë elemente të veprës penale për të cilën akuzohen, andaj janë shpallur fajtor.

Vlerësimi ligjor

Sa i përket dispozitivi I. të këtij aktgjykimi, pas procedimit të të gjitha provave personale dhe materiale e të administruara gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, të vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat tjera, konform nenit 360 par 1 dhe 2 të KPP-së, gjykata vërtetoi gjendjen faktike të precizuar si në dispozitave të këtij aktgjykimi, ashtu që bazuar në një gjendje të tillë faktike, të vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë lidhur me këtë çështje penale, kjo gjykatë vlerëson se në veprimet e të pandehurve M.M., F.M. dhe G.N., manifestohen të gjitha elementet qenësore të figurës së veprës penale se në bashkëkryerje dhe vazhdimësi kanë kryere veprën penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par.2

lidhur me nenin 31 dhe nenin 77 të KPRK-së, e jo par 1 të nenit 300 të KPRK-së, siç pretendon prokuroria, sepse pas mbajtje dhe zhvillimin të shqyrtimi gjyqësor në këtë çështje penale u vërtetuar gjendje faktike e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimit, ku është bërë rikulaifikimi juridik i veprës penale të lartcekur.

Gjykata vëren se për tu gjendur në kushtet e kryerjes së veprës penale se në bashkëkryerje dhe vazhdimësi kanë kryere veprën penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par.2 të KPRK-së, sipas dispozitave ligjore të nenit 300 të KPRK-së, kjo vepër penale ekziston kur kushdo që me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër, organizon, merr pjesë apo ndihmon në organizimin e bixhozit, lojërave të llojit të kazinove apo lojërave të fatit siç përcaktohet me ligj, për të cilat nuk është dhënë licenca, leja apo koncesioni i organit kompetent, (paragrafi 2 i nenit 300). Në rastin konkret lidhur me të pandehurit M.M., F.M. dhe G.N., jemi në kushtet e kryerjes se kësaj vepre penale, në atë mënyrë që në bazë të dëshmimeve të dëshmitarëve, nga mbrojtja e të pandehurve, të administrimit të provave material, raporteve të kontrollit të vlerësuara më lartë, në rastin konkret jemi në përmbushje të elemente qenësore të kësaj vepre penale, për arsyet si në vijim:

Të pandehurit M.M., F.M. dhe G.N., ngarkohet me veprimet inkriminuese, “**I.** Sepse deri në muajin tetor të vitit 2016, të pandehurit M.M., F.M. dhe G.N., në bashkëkryerje dhe vazhdimësi me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo të tjerët kanë marrë pjesë në organizimin e lojërave të fatit në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për lojërat e fatit nr.04/L-080, në atë mënyrë që i pandehuri Sh. R. (*është në arrati*), fillimisht kishte siguruar licencë për ushtrimin e kësaj veprimtarie në gjithë Kosovën, nën firmën “...” e pastaj aksionet ia kishte bartur të pandehurit F.M., i cili të njëjtën firmë e kishte regjistruar në ARBK nën firmën “...” dhe “...”, ashtu që të pandehurit F.M., M.M. dhe G.N., në bashkëkryerje dhe vazhdimësi kanë shpërndarë aparate në lokacionet e lojërave të fatit që nuk kishin licenca dhe leje për ushtrimin e veprimtarisë së tillë, i kanë furnizuar me aparatet me numra serik të falsifikuar të duplikuar dhe treplifikuar (tre aparate të lojërave të fatit me numër të njëjtë serikë në lokacione të ndryshme), aparate pa numra serik, aparate të ndryshme të lojërave të fatit si: “Kajot”, “Apex”, “Merkur”, si dhe aparate të tjera të “lojërave me qen”, “KENO”, roleta, ndërkaq gjatë kontrollit nga ana e policisë, Doganës dhe ATK-së, këto aparate janë konfiskuar, nga e cila veprimtari kanë përfituar dobi pasurore në mënyrë të kundërligjshme në shumë prej 15 337,63 €, **II.** I pandehuri F.M., deri me datën 29.09.2016, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo të tjerët kanë marrë pjesë në organizimin e lojërave të fatit në mënyrë të kundërligjshme, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për lojërat e fatit nr.04/L-080, ashtu që në cilësinë e pronarit të bizneseve “... “ dhe ”... 1”, në bashkëkryerje dhe vazhdimësi me të pandehurit M.M., G.N. kanë vepruar edhe në lokalit “...”, në rrugën “...”, në P., ku nuk kishte leje pune nga organet kompetente, gjatë kontrollit të këtij lokali nga personat zyrtar janë gjetur dhe konfiskuar tetë (8) aparate të lojërave të fatit të markës Merkur me numra serik 3145400241, 3145400215, 3145400158, 3145400154, 3145400314, 3145400213, 3145400306, 3145400212, katër (4) të markës Kajot me numra serik S.N.103, S.N.545, dy (2) aparate të markës ACT me numra serik 90890210, 90890188, dy aparate APEX me numër 80790141, 80790127, një (1) DVR me numër serik 2F00966PAPL45YT, **III.** I pandehuri G.N. deri me datën 29.09.2016, me

qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo të tjerët kanë marrë pjesë në organizimin e lojërave të fatit në mënyrë të kundërligjshme, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për lojërat e fatit nr.04/L-080, ashtu që në cilësinë e menaxherit të bizneseve "... “ dhe ”... 1”, në bashkëkryerje dhe vazhdimësi me të pandehurit e lartcekur ka vepruar në lokalin “...”, në rrugën “...”, pn, në P., nuk kishte leje të punës nga organet kompetente për të ushtruar një veprimtari të tillë, gjatë kontrollit të këtij lokali me datën 21.04.2016, janë gjetur dhe konfiskuar katër (4) aparate të lojërave të fatit si: aparat APEX me nr, serik 8079139, aparat ACT me numër serik 90890216, aparat MERKUR me numër serik 2009401, aparat KAJOT me numër serik 00390103, DVR i kamerave 1GOIE4FPALC05T5, shtëpizë HP (Race) CZC5171CMQ, shtëpizë (Keno) CZC5171DOV, printer të tiketave Keno-Race B85B19C14116, Kopje Licence nr. 28/2015 dhe Certifikatë e regjistrimit të biznesit me nr. 70591472, **IV**. I pandehuri G.N. deri me datën 21.04.2016, në cilësinë e menaxherit me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo të tjerët kanë marrë pjesë në organizimin e lojërave të fatit në mënyrë të kundërligjshme, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për lojërat e fatit nr.04/L-080, ashtu që në lokalin pa mbishkrim në rrugën “...”, te ..., në P., nuk kishte leje të punës nga organet kompetente, gjatë kontrollit janë gjetur dhe konfiskuar: katër (4) aparate të lojërave të fatit si: aparat APEX X10 D1 me nr, serik 01907-11759, aparat ACT X10 D2 me numër serik 90890288, aparat MERKUR X10 D3 LFt me numër serik 2009402, aparat APEX X10 D4 me numër serik 11009-14429 DVR i kamerave X10 D5 1GOIE4FPALX36U0, njëmbëdhjetë (11) letra bixhozi dhe gurë për lojëra, kontratë me kompaninë e sigurimeve kobra, Me këtë në bashkëkryerje dhe vazhdimësi kanë kryere veprën penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par.2 lidhur me nenin 31 dhe nenin 77 të KPRK-së.

I pandehuri M.M., është marrë me organizimin e lojërave të fatit, të përshkruar si më lartë, kjo vërtetohet nga raporti i kontrollit të përgjithshëm për të gjeturat dhe sekuestrimet për të gjitha pikat e lokaleve të lojërave të fatit të “...”, “...” dhe “...”, ku nga këto raporte janë sekuestruar një numër madhe i aparateve të lojërave të fatit në të gjithë pikat në K., ku sipas raportit rezultojnë që aparatet e hijezuara me bold gjithsej tetëmbëdhjetë (18) janë aparate të falsifikuara, ndërsa sa u përket aparateve të cilat nuk janë të hijezuara janë aparate të licencuara sipas Vendimit nr.28/2015 të datës 16.11.2015 nga ana e Administratës Tatimore të Kosovës – ATK për firmën N.SH “...” dhe se të gjitha aparatet që figurojnë në këtë raport janë sekuestruar në pika për të cilat nuk është lëshuar licenca që do të thotë se kanë vepruar jashtë licencës së lartcekur, kanë vepruar në kundërshtim me vendimin e lartpërmendur të Administratës Tatimore të Kosovës – ATK, ku të pandehurit M.M., F.M. dhe G.N. në këto lokale kanë siguruar dhe shpërndarë aparate të ndryshme të lojërave të fatit si: roleta, “Kajot”, “Apex”, “Merkur”, si dhe aparate të tjera të “lojërave me qen”, si: “KENO”, aparate pa numra serik, aparate me numra serik të falsifikuar, ku aparatet e licencuara nga ATK-ja, i kanë zhvendosur në pikat ku nuk kanë pasur leje dhe licencë të ATK-në për ushtrimin e veprimtarisë së tillë, ndërsa tetëmbëdhjete prej tyre i kanë dyfishuar dhe trefishuar duke i shpërndarë në lokalet e lartcekura, i cili fakt vërtetohet nga raporti i Departamentit Special Anti-korrupsion (DSAK) me nr. të referencës 06/3-145/17 i datës 21.04.2017. Me pas gjykata gjen se i pandehuri M.M., gjatë mbrojtjes së tij pohon se ka kryer veprën penal për të cilën është gjetur fajtorë, nga e njëjta mbrojtje vërtetohet se i ka pas disa pika të lojërave të fatit si: te ... në L. dhe te ...-ja nën firmën e ‘...’, të cilat i ka hapur se

bashku me pronarin e "...", P. R., me pas e ka blerë licencën e firmës nga P. R. dhe e ka mbajtur nën firmën "...", në emër të vëllait të tij F.M., i ka shtuar disa pika të lojërave të fatit, ku gjykata gjen se deklaratat e të pandehurit M.M. është në pajtim me gjendjen faktike të vërtetuar në këtë çështje penale, pasi që i njëjti pohon se në bashkëkryerje me të pandehurin F.M. kanë pasur disa pika të lojërave të fatit nën firmën që e drejtonin, kjo mbrojtje gjen mbështetje në mbrojtjen e të pandehurit A.Q. që ka deklaruar se e kam pa në kontratë të punës sime, është konstatuar se punëdhënësi është M.M., si dhe vërtetohet nga dëshmia e dëshmitarit Xhemal Mustafa ka deklaruar se ka punuar si roje sigurimi një lokal të lojërave të fatit në Rahovec, ku e ka punësuar A.R., ndërsa pronar ka qenë M., nga dëshmia e dëshmitarit Sh. J. vërtetohet se ka punuar në një kazino "... në R., është ballafaqua me deklaratën e dhënë në polici " në pyetjen në polici keni thënë se A. ju ka shti në punë kurse pronar është A.R., ndërsa pronare kryesore është një person me emrin M., e të cilin nuk e njoh", ka konfirmuar se qëndron kjo që e kam thënë në polici, nga dëshmitë e dëshmitarit D. B., vërtetohet se ka punuar në kazonë "...", ku pronar është M., detyrë ka pasur kontrollimin e aparateve të kazinosë, ka sqaruar se ka njohuri se lokali ka pasur licencës dhe ka qenë gjithçka në rregull, ka zhvilluar këtë veprimtari prej 3 vitesh, dhe se ky biznes i ka rreth 100 pika në të gjithë K., nga kjo dëshmi gjykata gjen se i pandehuri M.M., në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për lojërat e fatit nr.04/L-080, në atë mënyrë që në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi me të pandehurit si në dispozitiv I. të këtij aktgjykimit, nëpër pika të ndryshme në tërë territorin e Kosovës kanë siguruar dhe shpërndarë aparate të ndryshme të lojërave të fatit, aparate pa numra serik, aparate me numra serik të falsifikuar, i kanë dërguar tek lokalet pa licencë dhe leje pune të organeve kompetente për të ushtruar një veprimtari të tillë, me çka i pandehuri M.M., u shpallë fajtor dhe u dënua si në dispozitivit I. të këtij Aktgjykimi.

I pandehuri F.M., është marrë me organizimin e lojërave të fatit, të përshkruar si më lartë, kjo vërtetohet nga raporti i kontrollit X8, adresa Lagja ..., rruga "...", P., në lokalit të lojërave të fatit "...", janë gjetur dhe konfiskuar tetë (8) aparate të lojërave të fatit të markës Merkur me numëra serik 3145400241, 3145400215, 3145400158, 3145400154, 3145400314, 3145400213, 3145400306, 3145400212, katër (4) të markës Kajot me numër serik S.N.103, S.N.545, dy (2) aparata të markës ACT me numra serik 90890210, 90890188, dy aparate APEX me numër 80790141, 80790127, një (1) DVR me numër serik 2F00966PAPL45YT. Me pas gjykata gjen se i pandehuri F.M., gjatë mbrojtjes së tij pohon se ka kryer veprën penal për të cilën është gjetur fajtorë, nga e njëjta mbrojtje vërtetohet se ka punuar si menaxher i firmës "...", në lokalit në rruga "...", në lagjen ..., P., ndërsa pronar i firmës "...", është Sh. R., ka sqaruar se lokali nuk ka as leje pune dhe as licencë, kjo mbrojtje gjen mbështetje në dëshminë e dëshmitarit P. S. ku vërtetohet se ka punuar në një lokal që kanë qenë gjithsej 14 aparate, menaxher i këtij lokali ka qenë F.M., në dëshminë e dëshmitarit Ç. B., ku vërtetohet ka punuar në një lokal me emrin "...", që si veprimtari e ka pasur lojëra të fatit, menaxher i këtij lokali ka qenë A.Q., kurse pronar i lokalit ka qenë F.M., ka sqaruar se në atë lokal kanë qenë 10 aparate të lojërave të fatit si Kajot, Apex, Merkur, ndërsa i pandehuri i lartcekur mohon se ka qenë pronar i firmës "...", gjykata gjen se deklaratat e të pandehurit F.M., është në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar në këtë çështje penale, kjo mbrojtje është e dhënë vetëm me qëllim të ikjes nga përgjegjësia penale, dhe nuk gjen mbështetje në mbrojtjen e të pandehurit M.M. ku ka deklaruar se e ka blerë licencën

e firmës nga P. R. dhe e ka mbajtur nën firmën ‘...’, në emër të vëllait të tij F.M., e as mbrojtjen e të pandehurit G.N. që ka deklaruar se vëllezërit M. dhe F.M., i njoh si aksionarë-bashkëpronar të firmën ‘...’, andaj gjykata gjen se i pandehuri F.M., në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për lojërat e fatit nr.04/L-080, në atë mënyrë që në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi me të pandehurit si në dispozitiv I. të këtij aktgjykimit, nëpër pika të ndryshme në tërë territorin e Kosovës kanë siguruar dhe shpërndarë aparate të ndryshme të lojërave të fatit, aparate pa numra serik, aparate me numra serik të falsifikuar, i kanë dërguar te lokalet pa licencë dhe leje pune të organeve kompetente për të ushtruar një veprimtari të tillë, me çka i pandehuri F.M., u shpallë fajtor dhe u dënua si në dispozitivit **I.** të këtij Aktgjykimi.

I pandehuri G.N., është marrë me organizimin e lojërave të fatit, të përshkruar si më lartë, kjo vërtetohet nga raporti i kontrollit të përgjithshëm për të gjeturat dhe sekuestrimet të datës 20.04.2016, ku nga ky raport gjykata ka konstatuar se në bazë të urdhrave të gjykatës se janë bërë kontrole të lokali i lojërave të fatit ‘...’, i cili gjendej në rrugën ‘...’ te ... në P. i koduar me XI. Gjatë kontrollit në lokal janë identifikuar dhe sekuestruar përkohësisht katër (4) aparate të lojërave të fatit, një(1) aparat Apex me nr.serik 80790139, një(1) aparat ACT me nr. 90790216, një(1) aparat Merkur me nr. 2009401, një (1) aparat Kajot me nr. 00390103. Në këtë lokacion janë sekuestruar edhe një (1) shtëpizë kompjuteri HP me nr serik: CZCS171CMQ (race, lojëra me qene), një(1) shtëpizë HP me nr. CZC5171DOV (keno, lotari) dhe një(1) printer për shtypjen e basteve për të dy lojërat e lartcekura. Lokali nuk kishte leje të punës si dhe gjate verifikimit të këtyre aparateve rezultojnë se disa nga ta me po të njëjtin numër serik figurojnë edhe nëpër disa pika të tjera në të cilat është kryer kontrolli, si dhe kjo vërtetohet nga raporti i kontrollit të përgjithshëm për të gjeturat dhe sekuestrimet, me datë 21.04.2016 është kontrolluar lokali i lojërave të fatit pa mbishkrim (pa emërtim) i cili gjendej në adresën rruga e ...-se, pa numër të ... në P., i koduar me X10, gjatë kontrollit në lokal janë identifikuar dhe sekuestruar përkohësisht katër(4) aparate të lojërave të fatit, një(1) aparat Apex me nr.serik 01907-11759, një(1) Apex me nr. 11009-14429, një (1) aparat ACT me nr.90890288 dhe një(1) Merkur me nr.serik 2009402, arsyeja e kontrollit dhe e sekuestrimit të këtyre aparateve ishte sepse lokali nuk posedonte leje pune dhe se pas verifikimit disa nga këta aparate rezultojnë të jene të dublikuar dhe me të njëjtit numra serik janë sekuestruar edhe në lokacionet e tjera, ndërsa aparati Merkur dhe Apex figurojnë në listën e aparateve të licencuar të kompanisë ‘...’, përveç tyre janë sekuestruar edhe njëmbëdhjetë (11) komplete letra bixhozi, menaxher i këtij lokali është prezantuar personi M.K., ndërsa sipas deklaratave personi që ka menaxhuar me këta aparate të lojërave të fatit është G. N. i lindur me ..., adresa ‘...’, banesat e ... nr. ...- P., nga kjo provë vërtetohet se i pandehuri G. N. në cilësinë e menaxherit të lokalit të lojërave të fatit pa mbishkrim (pa emërtim) i cili gjendej në adresën rruga e ...se, pa numër të ... në P., ka marrë pjesë në organizimin e lojërave të fatit në mënyrë të kundërligjshme i cili lokal nuk kishte leje të punës nga organet kompetente për të ushtruar një veprimtari të tillë, me pas gjykata gjen se i pandehuri M.K. nuk ka menaxhuar me aparatet, por ka qenë vetëm punëtor i thjeshtë, pasi që këtë e ka pohuar vetë, dhe e ka pohuar edhe i pandehuri G.N. në mbrojtjen e tij të dhënë në shqyrtim gjyqësor duke cituar se aparatet e lartcekur kanë qenë në pronësi të tij, pasi që M.K. nuk ka qenë menaxher, por ka qenë vetë punëtor i thjeshtë sepse ka pasur nevojë për punë. Me pas gjykata gjen se i pandehuri G.N., gjatë mbrojtjes së tij pohon se ka kryer veprën penal për të cilën është gjetur fajtorë, nga e njëjta

vërtetohet se gjatë muajit mars të vitit 2016 ka punuar në "...", i ka ndreqë aparatet, i ka bajtë prej një kazinoje që ska pas pune i kam qu në pikën tjetër, ka punuar si menaxher, ndërsa pas marsit të viti 2016, e ka pasur vetëm një pikë e lojërave të fatit tek objekti "...", kanë qenë katër aparatet të mij personal, janë kon në të zezën të pa licencuar në kohëzgjatje prej 2 javësh, sqaron për gjykatën se M. dhe F.M. i njoh pasi që kanë punuar së bashku me dhëndrin P. R., kam dëgjuar nga dhëndri P. R. ka thënë se vëllezërit M. i njoh si aksionarë në firmën "...", ku ka qenë pronar P. R., si aksionarë e kam kuptua si bashkëpunëtorë e kanë pas kompaninë përgjysmë, gjykata gjen se i pandehuri G.N. në bashkëkryerje dhe vazhdimësi me të pandehurit M.M. dhe F.M.- që të dy në cilësi të bashkaksionarve kanë shpërnda aparate të pa licencuara, aparate të falsifikuara nëpër pika të ndryshme në Kosovë, po ashtu sqaron për gjykatën se e njeh të pandehurin V. pasi që janë rritë bashkë, si dhe nga mbrojtje e tij vërtetohet se i pandehurit M. K. e ka marrë në punë dhe nuk ka qenë as pronar e as menaxher vetëm ka pas si detyrë me i fshi paret me u barazuar, po ashtu nga mbrojtja e tij vërtetohet se e njeh të pandehurin A.H. pasi që me të janë njohur kur janë shkuar me i ndreqë aparatet, gjykata vlerëson se i pandehuri G.N. në mbrojtjen e tij pohon kryerjen e veprës penale për të cilën është shpallua fajtor dhe është dënua si në dispozitiv I. të këtij Aktgjykimit, pas që i pohon rrethanat se : i ka njohur të pandehurit M.M. dhe F.M.- që të dy në cilësi të bashkaksionarve në firmën "...", pohon se ka qenë menaxher i lojërave të fatit ku i ka shpërndarë aparatet e lojërave të fatit, i ka rregulluar aparatet e lojërave të fatit së bashku me të pandehurin A.H., ka pas në menaxhim një pike të lojërave të fatit tek objekti "...", kanë qenë katër aparatet të tij personal, janë kon në të zezën të pa licencuar, gjykata gjen se mbrojtjen e tij është e sinqerte dhe objektive, gjen mbështetje në mbrojtjen e të pandehurve tjerë, si dhe në prova materiale, nga kjo gjykata gjen se i pandehuri G.N. në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për lojërat e fatit nr.04/L-080, në atë mënyrë që në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi me të pandehurit si në dispozitiv I. të këtij aktgjykimit, nëpër pika të ndryshme në tërë territorin e Kosovës kanë siguruar dhe shpërndarë aparate të ndryshme të lojërave të fatit, aparate pa numra serik, aparate me numra serik të falsifikuara, i kanë dërguar te lokalet pa licencë dhe leje pune të organeve kompetente për të ushtruar një veprimtari të tillë, me çka i pandehuri G.N., u shpallë fajtor dhe u dënua si në dispozitivit I. të këtij Aktgjykimi.

Të pandehurit e lartcekur në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi janë marrë me organizimin e lojërave të fatit, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për lojërat e fatit nr.04/L-080. Neni 30 Aktivitete të kundërligjshme 1. Është e kundërligjshme nëse një person, pa siguruar më parë licencat dhe lejet e kërkuara sipas ligjeve në fuqi: 1.1. ofron ose zbaton ndonjë aktivitet të lidhur me ndonjë lojë fati, ose lojëra tjera të ngjashme me anë të mediave duke përfshirë mediat virtuale (internet, telefonat mobilë, interaktive, TV, etj) oferta, drejton apo ekspozon për lojë, ndonjë lojë fati, mjete të lojërave të fatit, brenda territorit të Republikës së Kosovës; 1.2. merr direkt ose indirekt, një kompensim, shpërblim, përqindje ose pjesë në para ose pasuri të luajtshme, për të mbajtur, vazhduar ose furnizuar lojërat e fatit, automatët, ose lokacionet e basteve sportive, në bazë të kësaj gjykata gjen se të pandehurit M.M., F.M. dhe G.N., në bashkëkryerje dhe vazhdimësi kanë shpërndarë aparate në lokacionet e lojërave e fatit që nuk kishin licenca dhe leje për ushtrimin e veprimtarisë të tillë i kanë furnizuar me aparate me numra serik të falsifikuara të duplifikuara dhe treplifikuara, kjo vërtetohet nga raportet ku janë sekuestruar një numër madhe i aparateve të lojërave të fatit në të gjithë pikat në Kosovës, ku

sipas raportit rezulton që aparatet e hijezuara me bold gjithsej tetëmbëdhjetë (18) janë aparate të falsifikuara gjate verifikimit të këtyre aparateve rezultojnë se disa nga ta me po të njëjtin numër serik figurojnë edhe nëpër disa pika të tjera në të cilat është kryer kontrolli, ndërsa sa u përket aparateve të cilat nuk janë të hijezuara janë aparate të licencuara sipas Vendimit nr.28/2015 të datës 16.11.2015 nga ana e Administratës Tatimore të Kosovës – ATK për firmën N.SH “...” dhe se të gjitha aparatet që figurojnë në këtë raport janë sekuestruar në pika për të cilat nuk është lëshuar licenca, që do të thotë se kanë vepruar jashtë licencës së lartcekur, kanë vepruar në kundërshtim me vendimin e lartpërmendur të Administratës Tatimore të Kosovës – ATK, kjo gjen mbështetje në neni 25 Licencat e nevojshme 12. 1. ATK-ja lëshon këto lloje licencash: 1.3. Licenca për operatorë të automatëve kërkohet për të gjithë personat që përfshihen në biznesin e vendosjes dhe të shfrytëzimit të automatëve në lokalet ku ka automat me pakicë. Si dhe në nenin Neni 44 . 3. Çdo automat i miratuar për t’u përdorur në Kosovë sipas këtij neni do të regjistrohet për një vendndodhje të përcaktuar, dhe lëvizja e atij automati nga kjo vendndodhje do t’i raportohet ATK-së në përputhje me aktet nënligjore. 4. Çdo person që shkel ndonjë dispozitë të këtij neni kryen shkelje ligjore. 5. Çdo automat ose program kompjuterik i lidhur me të që nuk është në përputhje me këtë nen, deklarohet kontrabandë dhe mund të bllokohet plotësisht dhe konfiskohet, si ka ndodhur në rastin konkret që është bërë lëvizja e aparateve nga një vend që ka qenë i caktuar sipas vendimit të ATK-së, të pandehurit e lartcekur i kanë dërguar në lokacionet e lojërave e fatit që nuk kishin licencë dhe leje për ushtrimin e veprimtarisë të tillë. Gjithashtu gjykata vlerëson edhe neni 66. Pika 1. Aktivitetet e lojërave të fatit në automate ushtrohen nga subjektet ekonomike, të cilat i kanë selitë e veta në Kosovë që i plotësojnë kushtet ligjore dhe kanë licencë të ATK-së. Pika 4. *Vetëm një licencë lejohet për të operuar me automatë në një lokacion afaristë*, nga kjo vërtetohet se në lokalet e lojërave të fatit të cekur nga dispozitivi I. deri tek dispozitivi VIII, i këtij aktgjykimit, të gjithë të pandehurit e lartcekur me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo tjetrin, kanë marrë pjesë në organizimin e lojërave të fatit në mënyrë të kundërligjshme, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për lojërat e fatit nr.04/L-080, pa siguruar më parë licencat dhe lejet e kërkuara sipas ligjeve në fuqi nga organet kompetent për të ushtruar një veprimtari të tillë, andaj në mungesë të dokumentacion të pandehurit janë shpallur fajtorë dhe janë dënuar si në dispozitiva të këtij aktgjykimit.

Sa i përket dispozitivit **II**. të këtij aktgjykimi, pas procedimit të të gjitha provave personale dhe materiale e të administruara gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, të vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat tjera, konform nenit 360 par 1 dhe 2 të KPP-së, gjykata vërtetoi gjendjen faktike të precizuar si në dispozitave të këtij aktgjykimi, ashtu që bazuar në një gjendje të tillë faktike, të vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë lidhur me këtë çështje penale, kjo gjykatë vlerëson se në veprimet e të pandehurit V.H. manifestohen të gjitha elementet qenësore të figurës së në vazhdimësi ka kryer veprës penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par.2 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, e jo të veprës penale nga par 1 të nenit 300 lidhur me neni 31 të KPRK-së, siç pretendon prokuroria, sepse pas mbajtje dhe zhvillimin të shqyrtimi gjyqësor në këtë çështje penale u vërtetuar gjendje faktike e përshtuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimit, ku është bërë ri-kulaifikimi juridik i veprës penale të lartcekur.

Gjykata vëren se për tu gjendur në kushtet e kryerjes se në vazhdimësi ka kryere veprën penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par.2 lidhur me neni 77 të KPRK-së, sipas dispozitave ligjore të nenit 300 të KPRK-së, kjo veprë penale ekziston kur kushdo që me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër, organizon, merr pjesë apo ndihmon në organizimin e bixhozit, lojërave të llojit të kazinove apo lojërave të fatit siç përcaktohet me ligj, për të cilat nuk është dhënë licenca, leja apo koncesioni i organit kompetent, (paragrafi 2 i nenit 300). Në rastin konkret lidhur me të pandehurin V.H., jemi në kushtet e kryerjes se kësaj veprë penale në atë mënyrë që në bazë të dëshmive të dëshmitarëve, nga mbrojtja e të pandehurve, të administrimit të provave material, raporteve të kontrollit të vlerësuar më lartë, në rastin konkret jemi në përmbushje të elemente qenësore të kësaj veprë penale, konsumimi i të cilave është i domosdoshëm për t'u shpallur fajtor për kryerjen e të njëjtës dhe atë për arsyet si në vijim:

I pandehuri V.H. ngarkohet me veprimet inkriminuese, "I. Sepse deri me datë 23.04.2015, në vazhdimësi me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, ka marrë pjesë në organizimin e lojërave të fatit në mënyrë të kundërligjshme, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për lojërat e fatit nr.04/L-080, ashtu që në lokalin në fshatin ..., Komuna e I., nuk ka pasur leje pune nga organet kompetente për të ushtruar një veprimtari të tillë, gjatë kontrollit nga personat zyrtar, me datën 23.04.2015, janë gjetur dhe konfiskuar dy (2) aparate të lojërave të fatit, një (1) i markës KAJOT me numër serik SN00271, dhe një (1) i markës APEX me nr, serik 8790137, dy (2) shtëpiza të kompjuterëve të lojërave të fatit të markës KENO me numër serik CZC91638MN, dhe CZC92628X3, II. Sepse deri me datë 23.04.2015, në vazhdimësi me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, ka marrë pjesë në organizimin e lojërave të fatit në mënyrë të kundërligjshme, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për lojërat e fatit nr.04/L-080, ashtu që në lokalin në fshatin ..., Komuna e I., nuk kishte leje të punës nga organet kompetente për të ushtruar një veprimtari të tillë, gjatë kontrollit janë gjetur dhe konfiskuar dy (2) aparate të lojërave të fatit të markës APEX me nr, serik AM 122, AM 013, një (1) i markës KAJOT me numër serik SN 00272, dy (2) shtëpiza të kompjuterëve të lojërave të fatit të markës DELL me numër serik X12-51822 (KENO), dhe Fujitsu – Siemens me numër serik YK3J198214, Me këtë në vazhdimësi ka kryer veprën penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par. 2 lidhur me nenin 77 të KPRK-së,

I pandehuri V.H., është marrë me organizimin e lojërave të fatit, të përshkruar si më lartë, kjo vërtetohet nga raporti i kontrollit të përgjithshëm për të gjeturat dhe sekuestrimet të datës 23.04.2015, ku nga ky raport gjykata ka konstatuar se në bazë të urdhrave të gjykatës se janë bërë kontrole në një lokal kafiteri dhe lojëra të fatit me pronar V. H., në fshatin ..., komuna e I., ku në këtë lokal janë evidentuar parregullsi nga ana e pjesëtarëve doganor dhe janë konfiskuar një aparat i lojërave të fatit Kajo, një aparat Apex dhe dy shtëpiza të kompjuterit të lojërave të fatit KENO, si dhe nga raporti i kontrollës X7, në lokal të lojërave të fatit adresa fshati ..., Komuna I., janë gjetur dhe konfiskuar dy (2) aparate të lojërave të fatit të markës APEX me nr, serik AM 122, AM 013, një (1) i markës KAJOT me numër serik SN 00272, dy (2) shtëpiza të kompjuterëve të lojërave të fatit të markës DELL me numër serik X12-51822 (KENO), dhe Fujitsu – Siemens me numër serik YK3J198214 (lojë me qen).Me pas gjykata gjen se i pandehuri

V.H., gjatë mbrojtjes së tij në fazën e hetimeve ka pohuar kryerjen e veprës penale, mbrojtja e tij gjen mbështetje në dëshminë e dëshmitarit A. O., nga e njëjta dëshmi vërtetohet se ka qenë veç punëtor në lokal në fshatin ..., ndërsa pronar ka qenë V.H., ka pas lojëra të fatit, dy aparate i ka pru V. në lokal dhe jemi marre vesh nëse vijnë myshterinjtë me ju tregu për aparate, andaj gjykata nga të lartcekurat vërtetohet se i pandehuri V.H., në vazhdimësi me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, ka marrë pjesë në organizimin e lojërave të fatit në mënyrë të kundërligjshme, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për lojërat e fatit nr.04/L-080, ashtu që në lokalet e lartcekura, ku të njëjtat lokale nuk kishte leje të punës nga organet kompetente për të ushtruar një veprimtari të tillë, me çka i pandehuri V.H., u shpallë fajtor dhe u dënua si në dispozitivit **II.** të këtij Aktgjykimi.

Sa i përket dispozitivit **III.** të këtij aktgjykimi, pas procedimit të të gjitha provave personale dhe materiale e të administruara gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, të vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat tjera, konform nenit 360 par 1 dhe 2 të KPP-së, gjykata vërtetoi gjendjen faktike të precizuar si në dispozitave të këtij aktgjykimi, ashtu që bazuar në një gjendje të tillë faktike, të vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë lidhur me këtë çështje penale, kjo gjykatë vlerëson se në veprimet e të pandehurit Rr.B. manifestohen të gjitha elementet qenësore të figurës së veprës penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par.2 të KPRK-së, e jo të paragrafi 1 të nenit 300, lidhur me nenin 31, nenin 33 dhe nenin 77 të KPRK-së, siç pretendon prokuroria, sepse pas mbajtje dhe zhvillimit të shqyrtimi gjyqësor në këtë çështje penale u vërtetuar gjendje faktike e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimit, ku është bërë ri-kulafikimi juridik i veprës penale të lartcekur.

Gjykata vëren se për tu gjendur në kushtet e kryerjes së veprës penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par.2 të KPRK-së, sipas dispozitave ligjore të nenit 300 të KPRK-së, kjo vepër penale ekziston kur kushdo që me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër, organizon, merr pjesë apo ndihmon në organizimin e bixhozit, lojërave të llojit të kazinove apo lojërave të fatit siç përcaktohet me ligj, për të cilat nuk është dhënë licenca, leja apo koncesioni i organit kompetent, (paragrafi 2 i nenit 300). Në rastin konkret lidhur me të pandehurin Rr.B., jemi në kushtet e kryerjes se kësaj vepre penale në atë mënyrë që në bazë të dëshmive të dëshmitarëve, nga mbrojtja e të pandehurve, të administrimit të provave material, raporteve të kontrollit të vlerësuara më lartë, në rastin konkret jemi në përmbushje të elemente qenësore të kësaj vepre penale, konsumimi i të cilave është i domosdoshëm për t'u shpallur fajtor për kryerjen e të njëjtës dhe atë për arsyet si në vijim:

I pandehuri Rr.B. ngarkohet me veprimet inkriminuese, “ Sepse deri me datë 27.01.2016, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, ka marrë pjesë në organizimin e lojërave të fatit në mënyrë të kundërligjshme, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për lojërat e fatit nr.04/L-080, ashtu që në lokal në lojërave të fatit ”...”, në rrugën “...” E12, nuk kishte leje të punës nga organet kompetente për të ushtruar një veprimtari të tillë, gjatë kontrollit nga ana e personave zyrtar janë gjetur dhe konfiskuar shtatëmbëdhjetë (17) aparate të lojërave të fatit të markave të ndryshme si Merkur me numër serik 2009401, 2200100, 3139300005, 390111,

2317, 100080221, 100080225, 100080212, 100080211, APEX me numër serik 80790129, 80790147, KAJOT me numër serik 11039128, 0101, aparat ACT me numër serik 0173, aparat APEX me numër serik 807901140, aparat Hot – Spot me numër serik 100080227, një shtëpizë kompjuteri HP me numër serik CZC4160MCM, një DVR H me numër serik 2008922022, pas verifikimit të tyre të njëjtit ish-in paraparë që të vepronin në qytete tjera të K. e jo në vendin ku janë gjetur, me këtë ka kryer veprën penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par. 2 të KPRK-së.

I pandehuri Rr.B., është marrë me organizimin e lojërave të fatit, të përshkruar si më lartë, kjo vërtetohet nga raporti i kontrollit të përgjithshëm për të gjeturat dhe sekuestrimet të 27.01.2016, ku nga ky raport gjykata ka konstatuar se janë bërë kontrolle në lokalin “...” ..., rruga “...”, E12, në P., e në këtë lokal janë gjetur 17 aparate të lojërave të fatit Merkur, nga to 16 ish-in të licencuara por të gjitha ish-in në qytete të tjera ku e kishin edhe lejen, e jo në lokalin e lartcekur ku janë konfiskuar shtatëmbëdhjetë (17) aparate të lojërave të fatit të markave të ndryshme si Merkur me numër serik 2009401, 2200100, 3139300005, 390111, 2317, 100080221, 100080225, 100080212, 100080211, APEX me numër serik 80790129, 80790147, KAJOT me numër serik 11039128, 0101, aparat ACT me numër serik 0173, aparat APEX me numër serik 807901140, aparat Hot – Spot me numër serik 100080227, një shtëpizë kompjuteri HP me numër serik CZC4160MCM, një DVR H me numër serik 2008922022, gjithashtu lokali nuk kishte licencë për të ushtruar veprimtarinë me të cilën ishte duke punuar lokali. Me pas gjykata gjen se i pandehuri Rr.B., gjatë mbrojtjes së tij, mohon se ka kryer veprën penal për të cilën është gjetur fajtorë, kjo me qellim të ikjes nga përgjegjësia penale, pasi që mbrojtja e tij nuk mbështetje në prova materiale të administruara në këtë çështje penale, andaj gjykata nga të lartcekurat vërtetohet se i pandehuri Rr.B., me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, ka marrë pjesë në organizimin e lojërave të fatit në mënyrë të kundërligjshme, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për lojërat e fatit nr.04/L-080, ashtu që në lokalin e lartcekura nuk kishte leje të punës nga organet kompetente për të ushtruar një veprimtari të tillë, me qka i pandehuri Rr.B., u shpallë fajtor dhe u dënua si në dispozitivit **III.** të këtij Aktgjykimi.

Sa i përket dispozitivit **IV.** të këtij aktgjykimi, pas procedimit të të gjitha provave personale dhe materiale e të administruara gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, të vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat tjera, konform nenit 360 par 1 dhe 2 të KPP-së, gjykata vërtetoi gjendjen faktike të precizuar si në dispozitave të këtij aktgjykimi, ashtu që bazuar në një gjendje të tillë faktike, të vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë lidhur me këtë çështje penale, kjo gjykatë vlerëson se në veprimet e të pandehurit F.B. manifestohen të gjitha elementet qenësore të figurës së veprës penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par.2 të KPRK-së, e jo të paragrafit 1 nga neni 300, lidhur me nenin 31 dhe nenin 77 të KPRK-së, siç pretendon prokuroria, sepse pas mbajtje dhe zhvillimin të shqyrtimi gjyqësor në këtë çështje penale u vërtetuar gjendje faktike e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimit, ku është bërë ri-kualifikimi juridik i veprës penale të lartcekur.

Gjykata vëren se për tu gjendur në kushtet e kryerjes së veprës penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par.2 të KPRK-së, sipas dispozitave ligjore

të nenit 300 të KPRK-së, kjo veprë penale ekziston kur kushdo që me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër, organizon, merr pjesë apo ndihmon në organizimin e bixhozit, lojërave të llojit të kazinove apo lojërave të fatit siç përcaktohet me ligj, për të cilat nuk është dhënë licenca, leja apo koncesioni i organit kompetent, (paragrafi 2 i nenit 300). Në rastin konkret lidhur me të pandehurin F.B., jemi në kushtet e kryerjes se kësaj veprë penale në atë mënyrë që në bazë të dëshmive të dëshmitarëve, nga mbrojtjen e të pandehurve, të administrimit të provave material, raporteve të kontrollit të vlerësuar më lartë, në rastin konkret jemi në përmbushje të elemente qenësore të kësaj veprë penale, konsumimi i të cilave është i domosdoshëm për t'u shpallur fajtor për kryerjen e të njëjtës dhe atë për arsyet si në vijim:

I pandehuri F.B. ngarkohet me veprimet inkriminuese, “Sepse deri me datë 27.01.2016, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, ka marrë pjesë në organizimin e lojërave të fatit në mënyrë të kundërligjshme, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për lojërat e fatit nr.04/L-080, ashtu që në lokalin në rrugën “...” të “...”, në P., nuk kishte leje të punës nga organet kompetente për të ushtruar një veprimtari të tillë, gjatë kontrollit nga ana e personave zyrtar janë gjetur dhe konfiskuar një (1) DVR e tipit multistar me numër serik120703-9304, dy (2) shtëpiza të kompjuterit HP me numër serik CZC5321S1P, CZ92434GV, me këtë ka kryer veprën penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par. 2 të KPRK-së.

I pandehuri F.B. është marrë me organizimin e lojërave të fatit, të përshkruar si më lartë, kjo vërtetohet nga raporti i kontrollit të përgjithshëm për të gjeturat dhe sekuestrimet të datës 27.01.2016, është bërë kontrollimi i lokalit të ..., me pronar F.B., ku janë gjetur dhe sekuestruar, një DVR i tipit multistar, 2 shtëpiza kompjuteri të tipit HP, të holla në shumën prej 560.50 si dhe 6 aparate të bixhozit. Me pas gjykata gjen se i pandehuri F.B., gjatë mbrojtjes së tij ka mohuar kryerjen e veprës penale, kjo mbrojtje është e dhënë vetëm me qëllim të ikjes nga përgjegjësia penale, pasi që mbrojtja e tij nuk mbështetje në provat materiale të administruara në këtë çështje penale, andaj gjykata nga të lartcekurat vërtetohet se i pandehuri F.B., me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, ka marrë pjesë në organizimin e lojërave të fatit në mënyrë të kundërligjshme, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për lojërat e fatit nr.04/L-080, ashtu që në lokalin e lartcekura nuk kishte leje të punës nga organet kompetente për të ushtruar një veprimtari të tillë, me çka i pandehuri F.B., u shpallë fajtor dhe u dënua si në dispozitivit **IV**. të këtij Aktgjykimi.

Sa i përket dispozitivit **V**. të këtij aktgjykimi, pas procedimit të të gjitha provave personale dhe materiale e të administruara gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, të vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat tjera, konform nenit 360 par 1 dhe 2 të KPP-së, gjykata vërtetoi gjendjen faktike të precizuar si në dispozitave të këtij aktgjykimi, ashtu që bazuar në një gjendje të tillë faktike, të vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë lidhur me këtë çështje penale, kjo gjykatë vlerëson se në veprimet e të pandehurit A.R. manifestohen të gjitha elementet qenësore të figurës të veprës penale me këtë në vazhdimësi ka kryer veprën penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par. 2 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, e jo

të paragrafi 1 të nenit 300, lidhur me nenin 31, të KPRK-së, siç pretendon prokuroria, sepse pas mbajtje dhe zhvillimit të shqyrtimi gjyqësor në këtë çështje penale u vërtetuar gjendje faktike e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimit, ku është bërë ri-kualifikimi juridik i veprës penale të lartcekur.

Gjykata vëren se për tu gjendur në kushtet e kryerjes së veprës penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par.2 të KPRK-së, sipas dispozitave ligjore të nenit 300 të KPRK-së, kjo veprë penale ekziston kur kushdo që me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër, organizon, merr pjesë apo ndihmon në organizimin e bixhozit, lojërave të llojit të kazinove apo lojërave të fatit siç përcaktohet me ligj, për të cilat nuk është dhënë licenca, leja apo koncesioni i organit kompetent, (paragrafi 2 i nenit 300). Në rastin konkret lidhur me të pandehurin A.R., jemi në kushtet e kryerjes se kësaj veprë penale në atë mënyrë që në bazë të dëshmive të dëshmitarëve, nga mbrojtjen e të pandehurve, të administrimit të provave material, raporteve të kontrollit të vlerësuar më lartë, në rastin konkret jemi në përmbushje të elemente qenësore të kësaj veprë penale, konsumimi i të cilave është i domosdoshëm për t'u shpallur fajtor për kryerjen e të njëjtës dhe atë për arsyet si në vijim:

I pandehuri A.R. ngarkohet me veprimet inkriminuese, **I.** Sepse deri me datë 18.10.2016, në vazhdimësi me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, ka marrë pjesë në organizimin e lojërave të fatit në mënyrë të kundërligjshme, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për lojërat e fatit nr.04/L-080, ashtu që në lokalin "...", në rrugën "...", në R., nuk kishte leje të punës nga organet kompetente për të ushtruar një veprimtari të tillë, gjatë kontrollit nga ana e personave zyrtar janë gjetur dhe konfiskuar gjashtë (6) aparate të lojërave të fatit të markës KAJOT me numra serik 11039111, 11039136, 11039133, 11039129, 110391127 dhe 89714611, dy (2) aparate të lojërave të fatit të markës APEX me numra 80790126 dhe 80790146, një (1) DVR - video rekorder me numër serik 1G020B4PALA7N7F dhe para në vlerë prej 3770 euro, **II.** Sepse deri me datë 18.10.2016, në vazhdimësi me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, ka marrë pjesë në organizimin e lojërave të fatit në mënyrë të kundërligjshme, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për lojërat e fatit nr.04/L-080, ashtu që në lokalin "...", në fshatin ..., Komuna e R., nuk kishte leje të punës nga organet kompetente për të ushtruar një veprimtari të tillë, gjatë kontrollit janë gjetur dhe konfiskuar nëntë (9) aparate të lojërave të fatit me mbishkrimin Hotspot (Admiral) me numër serik 100080138, Hotspot (Admiral) me numër serik 100080202, Apex me numër serik 80790126, 80790146, Kajot me numra serik S.N.89714813, S.N.11039108, S.N.11039110, S.N.11039129, S.N.11039102, dhe para në vlerë prej njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë (167) euro, me këtë në vazhdimësi ka kryer veprën penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par. 2 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

I pandehuri A.R., është marrë me organizimin e lojërave të fatit, të përshkruar si më lartë, kjo vërtetohet nga raporti i kontrollit të përgjithshëm për të gjeturat dhe sekuestrimet të datës 18.10.2016, ku nga ky raport gjykata ka konstatuar se janë bërë kontrole në lokalin "...", i cili gjendet në rrugën "...", në R., ku janë gjetur dhe sekuestruar 6 aparate të lojërave të fatit KAJOT, 2 aparate të lojërave të fatit APEX si, para në vlerë prej 3770 euro dhe 1 DVR, po ashtu në të

njëjtën datë është bërë kontrolli në lokalitetin “...”(...) në rrugën kryesore në fshatin ..., Komuna e R., ku janë gjetur dhe sekuestruar nëntë (9) aparate të lojërave të fatit me mbishkrimin Hotspot (Admiral) me numër serik 100080138, Hotspot (Admiral) me numër serik 100080202, Apex me numër serik 80790126, 80790146, Kajot me numra serik S.N.89714813, S.N.11039108, S.N.11039110, S.N.11039129, S.N.11039102, dhe para në vlerë prej njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë (167) euro. Me pas gjykata gjen se i pandehuri A.R., gjatë mbrojtjes së tij ka mohuar kryerjen e veprës penale, pasi që mbrojtja e tij nuk gjen mbështetje në dëshminë e dëshmitarit Shpetim Janqishta, nga e njëjta dëshmi vërtetohet se ka punuar në një kazino “...” në R., është ballafaquar me deklaratën e dhënë në polici “ në pyetjen në polici keni thënë se A. ju ka shti në punë kurse pronar është A.R., ndërsa pronar kryesor është një person me emrin M., e të cilin nuk e njoh”, ka konfirmuar se qëndron kjo që e kamë thënë në polici, si dhe mbrojtja e tij nuk gjen mbështetje në dëshminë e dëshmitarit Xh. M., të dhënë në polici pran të cilës qëndron, ku nga të njëjta dëshmi vërtetohet se ka punuar si roje sigurimi një lokalitet të lojërave të fatit në R., ku e ka punësuar A. R., ndërsa pronar ka qenë M., andaj nga të lartcekurat gjykata gjen se i pandehuri i lartcekur në vazhdimësi me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, ka marrë pjesë në organizimin e lojërave të fatit në mënyrë të kundërligjshme, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për lojërat e fatit nr.04/L-080, ashtu që në lokalet e lartcekura, ku të njëjtat lokale nuk kishte leje të punës nga organet kompetente për të ushtruar një veprimtari të tillë, me çka i pandehuri A. R., u shpallë fajtor dhe u dënua si në dispozitivin V. të këtij Aktgjykimi.

Sa i përket dispozitivin VI. të këtij aktgjykimi, pas procedimit të të gjitha provave personale dhe materiale e të administruara gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, të vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat tjera, konform nenit 360 par 1 dhe 2 të KPP-së, gjykata vërtetoi gjendjen faktike të precizuar si në dispozitave të këtij aktgjykimi, ashtu që bazuar në një gjendje të tillë faktike, të vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë lidhur me këtë çështje penale, kjo gjykatë vlerëson se në veprimet e të pandehurit A.Q. manifestohen të gjitha elementet qenësore të figurës së veprës penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par.2 të KPRK-së, e jo të paragrafi 1 të nenit 300, lidhur me nenin 31, nenin 33 dhe nenin 77 të KPRK-së, siç pretendon prokuroria, sepse pas mbajtje dhe zhvillimit të shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale u vërtetuar gjendje faktike e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimit, ku është bërë ri-kualifikimi juridik i veprës penale të lartcekur.

Gjykata vëren se për tu gjendur në kushtet e kryerjes së veprës penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par.2 të KPRK-së, sipas dispozitave ligjore të nenit 300 të KPRK-së, kjo veprë penale ekziston kur kushdo që me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër, organizon, merr pjesë apo ndihmon në organizimin e bixhozit, lojërave të llojit të kazinove apo lojërave të fatit siç përcaktohet me ligj, për të cilat nuk është dhënë licenca, leja apo koncesioni i organit kompetent, (paragrafi 2 i nenit 300). Në rastin konkret lidhur me të pandehurin A.Q., jemi në kushtet e kryerjes së kësaj veprë penale në atë mënyrë në bazë të dëshmimeve të dëshmitarëve, nga mbrojtjen e të pandehurve, të administrimit të provave material, raporteve të kontrollit të vlerësuar më lartë, në rastin konkret jemi në përmbushje të elemente qenësore të kësaj veprë penale,

konsumimi i të cilave është i domosdoshëm për t'u shpallur fajtor për kryerjen e të njëjtës dhe atë për arsyet si në vijim:

I pandehuri A.Q. ngarkohet me veprimet inkriminuese, "Sepse me datë 18.10.2016, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, ka marrë pjesë në organizimin e lojërave të fatit në mënyrë të kundërligjshme, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për lojërat e fatit nr.04/L-080, ashtu që në lokalin "...", në rrugën "... " në P., nuk kishte leje të punës nga organet kompetente për të ushtruar një veprimtari të tillë, gjatë kontrollit nga ana e personave zyrtar, janë gjetur dhe konfiskuar dhjetë (10) aparate të lojërave të fatit të markës Merkur me numër serik 3145400417, 3145400342, Apex me numër serik 80790134, 80790135, Kajot me numra serik 390122, 390121, 390120, 11039114, Hotspot (Admiral) me numër serik 1000802216, Hotspot (Admiral) me numër serik 100080219 dhe para në vlerë prej shtatëqind e gjashtëdhjetë e tre euro e pesëdhjetë cent (763.50), me këtë ka kryer veprën penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par. 2 të KPRK-së,

I pandehuri A.Q., është marrë me organizimin e lojërave të fatit, të përshkruar si më lartë, kjo vërtetohet nga raporti i kontrollit të përgjithshëm për të gjeturat dhe sekuestrimet të datës 18.10.2016, ku nga ky raport gjykata ka konstatuar se në bazë të urdhrave të gjykatës se janë bërë kontrole në një lokal "...", janë gjetur dhe konfiskuar dhjetë (10) aparate të lojërave të fatit të markës Merkur me numër serik 3145400417, 3145400342, Apex me numër serik 80790134, 80790135, Kajot me numra serik 390122, 390121, 390120, 11039114, Hotspot (Admiral) me numër serik 1000802216, Hotspot (Admiral) me numër serik 100080219 dhe para në vlerë prej shtatëqind e gjashtëdhjetë e tre, pesëdhjetë e tre cent (763.50) euro, me pronar A.Q. Me pas gjykata gjen se i pandehuri A.Q., gjatë mbrojtjes së tij ka pohuar kryerjen e veprës penale, ka deklaruar se ka punuar në "...", fillimisht ka punuar si punëtor e pastaj ka biseduar me pronarin F.M. që t'ia mundësonte menaxhimin e këtij lokali, mbrojtja e tij gjen mbështetje në dëshminë e dëshmitarit Ç. B., nga e njëjtat dëshmi vërtetohet ka punuar në një lokal me emrin "... " që si veprimtari e ka pasur lojëra të fatit, menaxher i këtij lokali ka qenë A. Q., kurse pronar i lokalit ka qenë F.M., si dhe gjen mbështetje në prova materiale, andaj gjykata nga të lartcekurat vërtetohet se i pandehuri A.Q., me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo tjetrin, ka marrë pjesë në organizimin e lojërave të fatit në mënyrë të kundërligjshme, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për lojërat e fatit nr.04/L-080, ashtu që në lokalin e lartcekur nuk kishte leje të punës nga organet kompetente për të ushtruar një veprimtari të tillë, me çka i pandehuri A.Q., u shpallë fajtor dhe u dënua si në dispozitivit **VI**. të këtij Aktgjykimi.

Sa i përket dispozitivi **VII**. të këtij aktgjykimi, pas procedimit të të gjitha provave personale dhe materiale e të administruara gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, të vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat tjera, konform nenit 360 par 1 dhe 2 të KPP-së, gjykata vërtetoi gjendjen faktike të precizuar si në dispozitave të këtij aktgjykimi, ashtu që bazuar në një gjendje të tillë faktike, të vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë lidhur me këtë çështje penale, kjo gjykatë vlerëson se në veprimet e të pandehurit S.B. manifestohen të gjitha elementet qenësore të figurës së veprës penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par.2 të KPRK-së, e jo të nga paragrafi 1 të nenit 300 lidhur me nenin 31 dhe nenin 77 të

KPRK-së, siç pretendon prokuroria, sepse pas mbajtje dhe zhvillimin të shqyrtimi gjyqësor në këtë çështje penale u vërtetuar gjendje faktike e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimit, ku është bërë ri-kualifikimi juridik i veprës penale të lartcekur.

Gjykata vëren se për tu gjendur në kushtet e kryerjes së veprës penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par.2 të KPRK-së, sipas dispozitave ligjore të nenit 300 të KPRK-së, kjo veprë penale ekziston kur kushdo që me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër, organizon, merr pjesë apo ndihmon në organizimin e bixhozit, lojërave të llojit të kazinove apo lojërave të fatit siç përcaktohet me ligj, për të cilat nuk është dhënë licenca, leja apo koncesioni i organit kompetent, (paragrafi 2 i nenit 300). Në rastin konkret lidhur me të pandehurin S.B., jemi në kushtet e kryerjes se kësaj veprë penale në atë mënyrë që në bazë të dëshmive të dëshmitarëve, nga mbrojtjen e të pandehurve, të administrimit të provave material, raporteve të kontrollit të vlerësuar më lartë, në rastin konkret jemi në përmbushje të elemente qenësore të kësaj veprë penale, konsumimi i të cilave është i domosdoshëm për t'u shpallur fajtor për kryerjen e të njëjtës dhe atë për arsyet si në vijim:

I pandehuri S.B. ngarkohet me veprimet inkriminuese, “Sepse deri me datë 21.04.2016, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, ka marrë pjesë në organizimin e lojërave të fatit në mënyrë të kundërligjshme, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për lojërat e fatit nr.04/L-080, ashtu që në lokalin “...”..., në fshatin ..., Komuna e D., nuk kishte leje të punës nga organet kompetente për të ushtruar një veprimtari të tillë, gjatë kontrollit nga ana e personave zyrtar janë gjetur dhe konfiskuar shtate (7) aparate të lojërave të fatit, Hot Spot me numër serik 100080215, Merkur me numër serik 01907-08358, Hot Stop me numër serik 10080201, MERKUR me numër serik 2009401, KAJOT me numër serik 89715712, APEX me numër serik 8079039, APEX me numër serik 80790125, DIË AR 20141208020, 517 euro si dhe disa dokumente, me këtë ka kryer veprën penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par. 2 të KPRK-së.

I pandehuri S.B., është marrë me organizimin e lojërave të fatit, të përshkruar si më lartë, kjo vërtetohet nga raporti i kontrollit të përgjithshëm për të gjeturat dhe sekuestrimet të datës 21.04.2016 është kontrolluar lokali i lojërave të fatit ..., ..., ... i cili gjendet në ... -... i koduar X14, gjatë kontrollit në lokal janë identifikuar dhe sekuestruar përkohësisht shtate (7) aparate të lojërave të fatit për arsye të mungesës së dokumentacionit përkatës dhe lejes së punës, ku pas verifikimit disa nga aparatet rezultojnë të duplikuar, janë me të njëjtit numra serik me aparatet e tjerë të sekuestruar në lokacione të tjera ku është kryer kontrolli: një(1) Hot Spot me nr. 100080215, një(1) Hot Spot me nr. 100080201, një(1) Merkur me nr. 01907-08358, ne(1) Merkur me nr. 2009401, një(1) Kajot me nr.89715712, një(1) Apex me nr. 80790139, një(1) Apex me nr. 80790125, ku si menaxher është prezantuar personi S.B., bazuar në listën e aparateve të ofruar nga menaxheri i kësaj pike(menaxheri i këtij lokali) aparatet figurojnë të jene të kompanisë se lojërave të fatit “...”.Me pas gjykata gjen se i pandehuri S.B., gjatë mbrojtjes së tij ka mohuar kryerjen e veprës penale, si dhe deklaratat e dhëna në prokurori dhe polici janë kundërthënëse njëra me tjetrën, kjo mbrojtje është e dhënë vetëm me qëllim të ikjes nga

përgjegjësia penale, dhe nuk gjen mbështetje në dëshminë e dëshmitarit A. M. të lexuar në këtë çështje penale, nga e njëjtat dëshmi vërtetohet ka punuar në një lokal i cili gjendet në ... për një periudhë prej 6 muajsh, menaxher i këtij lokali ka qenë S.B., si dhe nuk gjen mbështetje në prova materiale, andaj gjykata nga të lartcekurat vërtetohet se i pandehuri S.B., me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, ka marrë pjesë në organizimin e lojërave të fatit në mënyrë të kundërligjshme, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për lojërat e fatit nr.04/L-080, ashtu që në lokalin e lartcekur nuk kishte leje të punës nga organet kompetente për të ushtruar një veprimtari të tillë, me çka i pandehuri S.B., u shpallë fajtor dhe u dënua si në dispozitivit **VII.** të këtij Aktgjykimi.

Sa i përket dispozitivi **VIII.** të këtij aktgjykimi, pas procedimit të të gjitha provave personale dhe materiale e të administruara gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, të vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat tjera, konform nenit 360 par 1 dhe 2 të KPP-së, gjykata vërtetoi gjendjen faktike të precizuar si në dispozitave të këtij aktgjykimi, ashtu që bazuar në një gjendje të tillë faktike, të vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë lidhur me këtë çështje penale, kjo gjykatë vlerëson se në veprimet e të pandehurit A.H. manifestohen të gjitha elementet qenësore të figurës së veprës penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par.2 të KPRK-së, e jo të nga paragrafi 1 të nenit 300 lidhur me nenin 31 dhe nenin 77 të KPRK-së, siç pretendon prokuroria, sepse pas mbajtje dhe zhvillimit të shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale u vërtetuar gjendje faktike e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimit, ku është bërë ri-kualifikimi juridik i veprës penale të lartcekur.

Gjykata vëren se për tu gjendur në kushtet e kryerjes së veprës penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par.2 të KPRK-së, sipas dispozitave ligjore të nenit 300 të KPRK-së, kjo veprë penale ekziston kur kushdo që me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër, organizon, merr pjesë apo ndihmon në organizimin e bixhozit, lojërave të llojit të kazinove apo lojërave të fatit siç përcaktohet me ligj, për të cilat nuk është dhënë licenca, leja apo koncesioni i organit kompetent, (paragrafi 2 i nenit 300). Në rastin konkret lidhur me të pandehurin A.H., jemi në kushtet e kryerjes se kësaj veprë penale në atë mënyrë që në bazë të dëshmive të dëshmitarëve, nga mbrojtjen e të pandehurve, të administrimit të provave material, raporteve të kontrollit të vlerësuar më lartë, në rastin konkret jemi në përmbushje të elemente qenësore të kësaj veprë penale, konsumimi i të cilave është i domosdoshëm për t'u shpallur fajtor për kryerjen e të njëjtës dhe atë për arsyet si në vijim:

I pandehuri A.H. ngarkohet me veprimet inkriminuese, “Sepse deri me datë 21.04.2016, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, ka marrë pjesë në organizimin e lojërave të fatit në mënyrë të kundërligjshme, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për lojërat e fatit nr.04/L-080, ashtu që në lokalin “...”, në rrugën “...” në Gj., nuk kishte leje të punës nga organet kompetente për të ushtruar një veprimtari të tillë, gjatë kontrollimit nga ana e personave zyrtar janë gjetur dhe konfiskuar dhjetë (10) aparate të lojërave të fatit, si: MERKUR me numër serik 2009402, 08500-02817, 2009408, 2009409, KAJOT me numër serik 01907-10408, EGT me numër serik 01907-08131, 01907-08308, 11009-13140, 11009-13008 dhe 11009-13662,

dokumentacion mbi barazimin, si: 15.29 copë kartëmonedha nga 20 euro, 14.30 copë kartëmonedha nga 50 euro, 16.55 copë kartëmonedha nga 10 euro, 17.22 copë kartëmonedha nga 5 euro, 18.30 çelësa të aparateve, 19.01 kopje e njoftimit të ATK-së, me numër serik 13/06/39962 dhe 20.01 Shtëpizë kompjuteri DELL me numër serik BMG3K4J, me këtë ka kryer veprën penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par. 2 të KPRK-së. I pandehuri A.H., është marrë me organizimin e lojërave të fatit, të përshkruar si më lartë, kjo vërtetohet nga raporti i kontrollit X21, në adresa rruga "...", tek qendra tregtare ..., Gj. në lokalin e lojërave të fatit "...", janë gjetur dhe konfiskuar dhjetë (10) aparate të lojërave të fatit, si: MERKUR me numër serik 2009402, 08500-02817, 2009408, 2009409, KAJOT me numër serik 01907-10408, EGT me numër serik 01907-08131, 01907-08308, 11009-13140, 11009-13008 dhe 11009-13662, dokumentacion mbi barazimin, si: 15.29 cope kartëmonedha nga 20 euro, 14.30 copë kartëmonedha nga 50 euro, 16.55 copë kartëmonedha nga 10 euro, 17.22 copë kartëmonedha nga 5 euro, 18.30 çelësa të aparateve, 19.01 kopje e njoftimit të ATK-së, me numër serik 13/06/39962 dhe 20.01 shtëpizë kompjuteri DELL me numër serik BMG3K4J. Me pas gjykata gjen se i pandehuri A.H., gjatë mbrojtjes së tij ka pohuar kryerjen e veprës penale, nga e njëjta vërtetohet se ka punuar në "...", tek ... Center, rruga "...", në Gj., pasi që kishte rënë në kontakt me B. S., G. N. dhe V. R., ishte marrë vesh me t'a që të i'a mundësonin veprimtarinë e ndonjëren nga pikat e lokaleve në qytetin e Gj., mbrojtja e tij gjen mbështetje në mbrojtjen e të pandehurit G.N., ku ka deklarua se i ka rregulluar aparatet e lojërave të fatit së bashku me të pandehurin A.H., gjen mbështetje në dëshminë e dëshmitari P.R. nga e njëjtat dëshmi vërtetohet se A. ka punuar në "...", nuk mund ta quash as pozitë menaxheriale e as punëtor pasi që një prej obligimeve kryesore ka qenë për ta mbajtur arkën, si dhe gjen mbështetje në prova materiale, andaj gjykata nga të lartcekurat vërtetohet se i pandehuri A.H., me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, ka marrë pjesë në organizimin e lojërave të fatit në mënyrë të kundërligjshme, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për lojërat e fatit nr.04/L-080, ashtu që në lokalin e lartcekur nuk kishte leje të punës nga organet kompetente për të ushtruar një veprimtari të tillë, me çka i pandehuri A.H., u shpallë fajtor dhe u dënua si në dispozitivit **VIII.** të këtij Aktgjykimi.

Sa i përket pjesës lirues të dispozitivit **IX.** të këtij aktgjykimi për të pandehurin Q.M., pas procedimit të gjitha provave personale dhe materiale e të administruara gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, të vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat tjera, gjykata vlerëson se në veprimet e të pandehurit Q.M., nuk manifestohen elementet qenësore të figurës së veprës penale se në bashkëkryerje dhe vazhdimësi kishte për të kryer veprën penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 paragrafi .2 dhe .1 lidhur me nenin 31, nenin 33 dhe nenin 77 të KPRK-së, gjykata vlerëson se nga provat e administruara nuk është vërtetuar se tani i pandehuri ka kryer këtë veprë penale për të cilën është akuzuar.

Vështruar nga cilësimi juridik i veprës penale, me këtë në bashkëkryerje dhe vazhdimësi kishte për të kryer veprën penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 paragrafi .2 dhe .1 lidhur me nenin 31, nenin 33 dhe nenin 77 të KPRK-së, për tu gjetur në kushtet e konsumimit të elementeve qenësore të kësaj veprë penale, ekziston kjo veprë penale

ekziston kur kushdo që me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër, organizon, merr pjesë apo ndihmon në organizimin e bixhozit, lojërave të llojit të kazinove apo lojërave të fatit siç përcaktohet me ligj, për të cilat nuk është dhënë licenca, leja apo koncesioni i organit kompetent, (paragrafi 2 i nenit 300). Në rastin konkret nuk jemi në përmbushje të asnjërit nga këto elemente qenësore të kësaj vepre penale, konsumimi i të cilave është i domosdoshëm për t'u shpallur fajtor për kryerjen e të njëjtës, dhe atë për arsyet si në vijim:

I pandehuri Q.M., ngarkohet me veprimet inkriminuese, “ Sepse i pandehuri G.N. nga koha e pa caktuar deri me datën 29.09.2016, në cilësinë e pronarit të bizneseve “... “ dhe ”...” ,në bashkëpunim me të pandehurit Sh. R., M.M. dhe të pandehurve tjerë ka shpërnda aparate të pa licencuara, aparate të falsifikuara nëpër pika të ndryshme në Kosovë ku kanë vepruar të pandehurit tjerë e gjithashtu i njëjti ka vepruar edhe në lokalin “...”, në rrugën “...”, pn, në P. bashkë me të pandehurin Q.M., e i cili lokal nuk kishte leje të punës nga organet kompetente për të ushtruar një veprimtari të tillë ashtu që gjatë kontrollit të këtij lokali me datën 21.04.2016, janë gjetur dhe konfiskuar katër (4) aparate të lojërave të fatit si: **aparat APEX me nr, serik 8079139, aparat ACT me numër serik 90890216, aparat MERKUR me numër serik 2009401, aparat KAJOT me numër serik 00390103**, DVR i kamerave 1GOIE4FPALC05T5, shtëpizë HP (Race) CZC5171CMQ, shtëpizë (Keno) CZC5171DOV, printer të tiketave Keno-Race B85B19C14116, Kopje Licence nr. 28/2015 dhe Certifikatë e regjistrimit të biznesit me nr. 70591472, me këtë në bashkëkryerje kishte për të kryer veprën penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 paragrafi .2 dhe .1 lidhur me nenin 31,nenin 33 dhe nenin 77 të KPRK-së.

Gjykata fillimisht vëren se duke u nisur nga përshkrimi faktik për veprimet e lartcekura që ngarkohet i pandehuri Q.M., gjykata gjen se nga ana e prokurorisë nuk janë ofruar prova të mjaftueshme që mbështetin dyshimin e bazuar se i njëjti e ka kryer veprën penale si me lartë për këto arsye se i pandehuri Q.M. nuk ka menaxhuar me aparatet e lojërave të fatit në lokalin “...”, në rrugën “...”, pn, në P., gjykata gjen se sipas **aktakuzës i pandehuri G.N. ngarkohet se** nga koha e pa caktuar deri me datën 29.09.2016, në cilësinë e pronarit të bizneseve “... “ dhe ”...” ,në bashkëpunim me të pandehurit Sh. R., M.M. dhe të pandehurve tjerë ka shpërnda aparate të pa licencuara, aparate të falsifikuara nëpër pika të ndryshme në Kosovë ku kanë vepruar të pandehurit tjerë e gjithashtu i njëjti ka vepruar edhe në lokalin “...”, në rrugën “...”, pn, në P. bashkë me të pandehurin Q.M., e i cili lokal nuk kishte leje të punës nga organet kompetente për të ushtruar një veprimtari të tillë ashtu që gjatë kontrollit të këtij lokali me datën 21.04.2016, janë gjetur dhe konfiskuar katër (4) aparate të lojërave të fatit si janë cekur më lartë, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor vërtetohet se i pandehuri Q.M. ka qenë vetëm punëtorë në lokalin të lojërave të fatit “...”, i cili gjendet në rrugën “...” te ... në Prishtinë, ndërsa pronarë ka qenë G.N., pasi që aparatet e lojërave të fatit ja ka sjellë i pandehuri G. N. ku ka deklaruar në mbrojtjen e tij i ka bartë aparatet e lojërave të fatit nga një pikë që nuk ka pas punë i ka vendosur në pikën tjetër, ndërsa i pandehuri Q.M. në mbrojtjen e tij ka deklaruar se unë kamë qenë vetëm punëtor në lokalin e lartcekur dhe nuk kam pas njohuri a kanë qenë apo nuk kanë qenë aparatet e licencuara, mbrojtja e tij gjen mbështetje në dëshminë e dëshmitarit Q. B. ku ka deklaruar në

dëshminë e dhen në gjykatë se në dijeninë time Q. M. ka qenë vetëm punëtor në lokalitë e lartcekur, andaj gjykata vlerëson se me të gjitha provat e administruara nuk është vërtetuar se tani i pandehuri Q.M. ka kryer veprën penale për cilën është akuzuar andaj në mungesë të provave u vendos si në dispozitiv **IX**, të këtij aktgjykimit, ndërsa sa i përket të pandehurit G.N., ku me të njëjtin dispozitiv është ngarkuar me aktakuzë, gjykata pas shqyrtimit gjyqësor, për të njëjtin ka bërë përshkrimi faktikë dhe juridik të vërtetuar si në dispozitivin **I**. të këtij aktgjykimit.

Sa i përket pjesës lirues të dispozitivit **X**. të këtij aktgjykimi për të pandehurin M.K., pas procedimit të gjitha provave personale dhe materiale e të administruara gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, të vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat tjera, gjykata vlerëson se në veprimet e të pandehurit M.K., nuk manifestohen elementet qenësore të figurës së veprës penale se në bashkëkryerje dhe vazhdimësi kishin për të kryer veprën penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 paragrafi .2 dhe .1 lidhur me nenin 31, nenin 33 dhe nenin 77 të KPRK-së, gjykata vlerëson se nga provat e administruara nuk është vërtetuar se tani i pandehuri ka kryer këtë veprë penale për të cilën është akuzuar.

Vështruar nga cilësimi juridik i veprës penale, me këtë në bashkëkryerje dhe vazhdimësi kishte për të kryer veprën penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 paragrafi .2 dhe .1 lidhur me nenin 31, nenin 33 dhe nenin 77 të KPRK-së, për tu gjetur në kushtet e konsumimit të elementeve qenësore të kësaj veprë penale, ekziston kjo veprë penale ekziston kur kushdo që me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër, organizon, merr pjesë apo ndihmon në organizimin e bixhozit, lojërave të llojit të kazinove apo lojërave të fatit siç përcaktohet me ligj, për të cilat nuk është dhënë licenca, leja apo koncesioni i organit kompetent, (paragrafi 2 i nenit 300). Në rastin konkret nuk jemi në përmbushje të asnjërit nga këto elemente qenësore të kësaj veprë penale, konsumimi i të cilave është i domosdoshëm për t'u shpallur fajtor për kryerjen e të njëjtës, dhe atë për arsyet si në vijim:

I pandehuri M.K. ngarkohet me veprimet inkriminuese, “ Të pandehurit M.K. dhe G.N. nga koha e pa caktuar e deri me datën 21.04.2016, në cilësinë e menaxherëve në një lokal të lojërave të fatit pa mbishkrim në rrugën “...”, në P., te ..., i cili nuk kishte leje të punës nga organet kompetente kanë marrë pjesë në organizimin e lojërave të fatit në mënyrë të kundërligjshme , ashtu që gjatë kontrollit janë gjetur dhe konfiskuar : katër (4) aparate të lojërave të fatit si: aparat APEX X10 D1 me nr, serik 01907-11759, aparat ACT X10 D2 me numër serik 90890288, aparat MERKUR X10 D3 Lft me numër serik 2009402, aparat APEX X10 D4 me numër serik 11009-14429 DVR i kamerave X10 D5 1GO1E4FPALX36U0, njëmbëdhjetë (11) letra bixhozi dhe gurë për lojëra, kontratë me kompaninë e sigurimeve kobra, me këtë se në bashkëkryerje dhe vazhdimësi kishte për të kryer veprën penale Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 paragrafi .2 dhe .1 lidhur me nenin 31, nenin 33 dhe nenin 77 të KPRK-së.

Gjykata fillimisht vëren se duke u nisur nga përshkrimi faktik për veprimet e lartcekura që ngarkohet i pandehuri M.K., gjykata gjen se nga ana e prokurorisë nuk janë ofruar prova të mjaftueshme që mbështetin dyshimin e bazuar se i njëjti e ka kryer veprën penale si me lartë për këto arsye se i pandehuri M.K. nuk ka menaxhuar me aparatet e lojërave të fatit në lokalit pa mbishkrim në rrugën "...", te ..., në P., por ka qenë vetë punëtor i thjeshtë, pasi që këtë e ka pohuar edhe i pandehuri G.N. në mbrojtjen e tij të dhënë në shqyrtim gjyqësor duke cituar se aparatet në një lokal të lojërave të fatit pa mbishkrim në rrugën "...", te ... në P., kanë qenë në pronësi të tij, pasi që M.K. nuk ka qenë menaxher, por ka qenë vetë punëtor i thjeshtë sepse ka pasur nevojë për punë dhe e kamë punësuar, po ashtu gjykata gjen se nuk qëndron pretendimi i prokurorisë se në dëshminë e dëshmitarit Q. B., *të konstatuar në aktakuzë rezulton që i njëjti ka punuar në bastoren "...", e cila gjendet në rrugën "...", e të cilën bastore e menaxhon Q. M., ndërsa pronar i bastores është M.K.*, gjykata gjen se dëshmitari i lartcekur ka deklaruar ndryshe nga ajo që është konstatuar nga prokuroria, si "*se është punëtor në lokalit "...", që gjendet te rruga e "...", në P., i cili lokal si veprimtari e ka bastoren sportive dhe aparate të lojërave të fatit dhe të cilin e menaxhon Q.M., ndërsa pronar është G. K.*", andaj gjykata vlerëson se me të gjitha provat e administruara nuk është vërtetuar se tani i pandehuri M.K., ka kryer veprën penale për cilën është akuzuar, andaj në mungesë të provave u vendos si në dispozitivin **X**, të këtij aktgjykimit, ndërsa sa i përket të pandehurit G.N., ku me të njëjtin dispozitiv është ngarkuar me aktakuzë, gjykata pas shqyrtimit gjyqësor, për të njëjtin ka bërë përshkrimi faktik dhe juridik të vërtetuar si në dispozitivin **I** të këtij aktgjykimit.

Sa i përket të dispozitivit **XI** të këtij aktgjykimi për të pandehurin O.E. konfom nenit 362 par 1 të KPP-së, Refuzohet akuza, pasi që prokurorja e prokurorisë speciale në fjalën përfundimtare ka heq dorë nga aktakuza dhe ndjekja penale për të pandehurin O.E.

Gjykata vlerëson se sa i përket se të pandehurit M.M., F.M., G.N., në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi kanë kryere veprat penale me të pandehurit A.R., F.B., Rr.B., S.B., A.Q., dhe A.H. siç pretendon prokuroria, nuk qëndron pasi që gjykata gjen pas mbajtje dhe zhvillimit të shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale u vërtetuar gjendje faktike e përshkruar si në dispozitiv **I** deri në dispozitivin **VIII** të këtij aktgjykimit, ku është bërë përshkrimi faktik i vërtetuar në shqyrtim gjyqësor dhe është bërë ri-kualifikimi juridik i veprave penale të lartcekur për të pandehurit të lartcekur. Gjykata gjen se është vërtetuar dyshimi i bazuar mirë se të pandehurit M.M., F.M., G.N., A.R., F.B., Rr.B., S.B., A.Q., dhe A.H. me dashje me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër, kanë bërë organizimin e lojërave të fatit në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për lojërat e fatit nr.04/L-080, për të cilat nuk është dhënë licenca, leja apo koncesioni i organit kompetent, (paragrafi 2 i nenit 300), me çka janë shpallur fajtor dhe janë dënuar si në dispozitivin **I** e deri në dispozitivin **VIII**, të këtij aktgjykimi.

Gjykata gjatë shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurve M.M., F.M. dhe G.N., si në dispozitiv **I** të këtij aktgjykimi, mori në konsideratë dhe vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave nga neni 69 të KPRK-së, të cilat rrethana ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Gjatë vendosje për dënim gjykata si rrethanë lehtësues mori se kanë pasur sjellje korrekte ndaj

gjykatës dhe gjithë procesit penale, ndërsa që rrethana rënduese gjykata gjeti të pandehurit M.M. dhe F.M. në cilësi të pronarëve - bashkaksionarve të lokaleve të lojërave të fatit me të pandehurin G.N. në cilësi të menaxherit, në bashkëkryerje dhe vazhdimësi me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo të tjerët kanë marrë pjesë në organizimin e lojërave të fatit në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për lojërat e fatit nr.04/L-080, kanë shpërndarë aparate të pa licencuara, aparate të falsifikuara të duplifikuara dhe treplifikuara, aparate me numra serik, aparate pa numra serik nëpër pika të ndryshme në Kosovë, i kanë furnizuar me aparate lokalet pa licencë dhe leje pune të organeve kompetente për ushtrimin e veprimtari së tillë, ku gjykata ka të dhëna se të pandehurit M.M. dhe F.M., nga koha e kryerjes së veprës penale kanë kryer edhe vepra penale të natyrës të ngjashme, andaj bazuar në këto rrethana gjykata të pandehurve M.M. dhe F.M., i ka shqiptuar dënimin si në dispozitiva I. të këtij aktgjykimi, duke vlerësuar se dënimet e shqiptuar është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale, intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, dhe në këtë mënyrë do të ndikojë në parandalimin e të pandehurve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen të natyrës së ngjashëm, ku do të bëjë rehA.timin e të njëjtit si dhe do të ndikojë në vetëdijesimin dhe përmbajtjen e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, çka është edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPK-së, si dhe të pandehurit G.N. i ka shqiptuar dënimin si në dispozitiva I. të këtij aktgjykimi, duke vlerësuar se dënimi i shqiptuar është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale që ka qenë me e ultë në raport me të pandehurit e lartcekur dhe në këtë mënyrë do të ndikojë në parandalimin e të pandehurit G.N. nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëjë rehA.timin e të njëjtëve si dhe do të ndikojë në vetëdijesimin dhe përmbajtjen e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, çka është edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së.

Gjykata gjatë shqiptimi të dënimit ndaj të pandehurve V.H., A.R., F.B., Rr.B., S.B., A.Q., dhe A.H., mori në konsideratë dhe vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave nga neni 69 të KPRK-së, të cilat rrethana ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Gjatë vendosje për dënim gjykata si rrethanë lehtësues mori gjendjen e tyre mesatare- materiale, janë mbajtës të familjes, kanë pasur sjellje korrekte ndaj gjykatës dhe gjithë procesit penale dhe se nga koha e kryerje së këtyre veprave penale nuk kanë kryer ndonjë vepër të re penale, ndërsa që rrethana rënduese për të pandehurit e lartcekur nuk ka gjetur, andaj bazuar në këto rrethana gjykata ju ka shqiptuar minimumin e dënime të paraparë për këto vepra penale si në dispozitiva të lartcekur të këtij aktgjykimi që ju përkasin të pandehurve të lartcekur, me përshkrime faktike dhe juridike të vërtetuar gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor, duke vlerësuar se dënimet e shqiptuar janë në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurve të lartcekur, intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, dhe në këtë mënyrë do të ndikojë në parandalimin e të pandehurve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëjë rehA.timin e të njëjtëve si dhe do të ndikojë në vetëdijesimin dhe përmbajtjen e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, çka është edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së.

Gjykata ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar si në dispozitiva fajësues të këtij aktgjykimit, është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurve, me sjelljet dhe rrethanat e kryesit, shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e tyre, me bindje se dënimet e tillë

do të ndikojë në risocializimin dhe riedukimin e kryesve, si dhe në vetëdijesimin dhe përmbajtjen e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit sipas nenit 38 të KPRK-së.

Vendimi për konfiskim e aparateve dhe të parave është marr bazuar në nenin 115 par. 2 të KPP-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale sa i përket pjesës dënuese të këtij aktgjykimi, do të merret në bazë të llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, ndërkaq shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor janë marrë, duke pasur për bazë ndërlikueshmërinë e veprës penale, kohëzgjatjen e zhvillimit të procedurës penale, si dhe gjendjen pasurore e të pandehurit, konform nenit 450 par 2 nënpar 2.6 të KPP-së, ndërsa vendimi për Fondin për Kompensimin të Viktimave të Krimit është marr sipas Ligjit nr. 05/L-036, për Kompensimin e Viktimave të Krimit, ndërsa që lidhur me pjesën refuzues dhe pjesën liruesi të dispozitivave të këtij aktgjykimit, u vendos bazuar në nenin 453 par 1 të KPP-së.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 362, 363, dhe 364 të KPP-së, u vendos si në dispozitiva të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti Special

PS.nr.40/21, datë 16.11.2023

Zyrtare Ligjore
Ardita Mustafa

Kryetarja e trupit gjykues– gjyqtarja
Violeta Namani-Hajra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në P. në afat prej 30 ditëve nga dita e marrjes së të njëjtit, e përmes kësaj gjykate.